



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Ministria e Punëve të Jashtme - Ministarstvo Inostranih Poslova - Ministry of Foreign Affairs

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Raporti nga vizitat e Zëvendëskryeministrit të parë dhe

Ministrit të Punëve të Jashtme z.Behqjet Pacolli

Janar – Dhjetor 2019



AKTIVITETET

Gjatë angazhimit dhe punës time për vitin 2019 si Zëvendëskryeministër i Parë dhe Ministër i Punëve të Jashtme, kam zhvilluar aktivitete të shumta, dhe atë si vijon:

- **Gjashtëdhjetë e shtatë vizita (67)** jashtë shtetit, në vende të ndryshme në mbarë botën.
- **Mbi dhjetë (45)** vende të ndryshme të vizituara në mbarë botën. Në disa vende, kam realizuar vizita më shumë se një (1) herë.
- **Nëntë (34)** takime i kam zhvilluar me President të shteteve të ndryshme.
- **Tridhjetë e tetë (147)** takime i kam realizuar me homologë të mi nga mbarë bota.
- **Njëqind e një takime (101)** takime bilaterale me personalitete të larta botërore.
- **Njëqind e njëzet e katër (124)** takime brenda dhe jashtë shtetit me personalitete të larta.
- **Pesë (17)** homologë të mi e kanë vizituar Prishtinën.
- **Nëntë (9)** konferenca, forume dhe aktivitete të tjera multilaterale, në të cilat kam marrë pjesë. Në kuadër të tyre kam zhvilluar qindra takime me president të shteteve, homologë të mi dhe personalitete të tjera dhe përfaqësues nga shtete të ndryshme të botës.
- **Një (1)** herë kam marrë pjesë në Konferencën e Frankofonisë.
- **Një (1)** herë kam marrë pjesë në Konferencën e vendeve Islamike (OIC).



INTERVISTË PËR GAZETËN “EPOKA E RE” PRISHTINË, 8 JANAR 2019

Në intervistën për gazetën e përditshme kosovare, “Epoka e Re”, kam folur për shumë çështje të rëndësishme që e presin Republikën e Kosovës në arenën politike ndërkombëtare. Me theks të vçantë jam fokusuar tek procesi i dialogut me Serbinë, ku kam potencuar se nuk duhet të ndalet dialogu. Kam bërë me dije se Republika e Kosovës nuk ka alternativë tjetër pos dialogut dhe marrveshjes historike me Serbinë. Po ashtu, thash se Kosovës në këtë proces i duhet unitet politik dhe jo përçarje, dhe kam ftuar edhe dy partitë e mëdha opozitare që t’i bashkohen ekipit negociator të Kosovës në dialog.





RRUGËS PËR BERLIN FRANKFURT, 9 JANAR 2019

Nga Frankfurti zgjedha trenin për të udhëtuar drejt Berlinit, ku do të zhvillojë vizitën zyrtare në Republikën Federale të Gjermanisë. Me homologun tim Heiko Mass do të diskutojmë shumë çështje të interesit të përbashkët. Mbështetja gjermane për vendin tonë është kryesore në konsolidimin e shtetit dhe mbylljen e procesit të normalizimit të raporteve me Serbinë.



Frankfurt, 9 janar 2019 - Në tren duke udhëtuar në drejtim të Berlinit.



NË TAKIM ME HOMOLOGUN GJERMAN HEIKO MASS BERLIN, 10 JANAR 2019

Nder, respekt dhe mikëpritje e pashembullt nga homologu im gjerman, Heiko Maas, i cili më priti në vizitë shtetërore sot në Berlin. Takim shumë miqësor, konstruktiv dhe pëmbajtësor. Gjermania është dëshmuar si partner strategjik dhe aleat i palëkundur i Kosovës nëpër të gjitha fazat e shtet-ndërtimit. Është partneri i fuqishëm tregtar me vendin tonë, por ne presim dhe thërrasim për investime edhe më të mëdha gjermane në Kosovë, që do të ndihmonin në zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për shtetasit tanë. Gjermania mbështet fuqishëm normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi, proces i cili nënkupton epilog të njohjes reciproke dhe anëtarësim të Kosovës në OKB.



Berlin, 10 janar 2019 – *Shtërëngim duarsh me homologun tim gjerman, Heiko Mass*



Berlin, 10 janar 2019–Takim me homologun gjerman, Heiko Maas, gjatë vizitës zyrtare në Gjermani.



HAPJA E AMBASADËS SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË PORTUGALI LISBONË, 11 JANAR 2019

Republika e Kosovës po fuqizohet në botë. Jashtëzakonisht i lumtur dhe krenar për shtrirjen graduale të përfaqësimit të Republikës së Kosovës në botë. Hapja dhe zyrtarizimi i ambasadës tonë në Portugali u kurorëzua me prezentimin e letrave kredenciale nga ambasadori ynë Ylber Kryeziu. Portugalia është shtet i rëndësishëm dhe me histori të pasur ndikimi në pjesë të ndryshme të botës. Mbështetja e shtetit portugez në vazhdimësi ka qenë e fuqishme për vendin tonë, andaj këtë partneritet tash e tutje do ta thellojmë edhe më shumë.



Lisbonë, 11 janar 2019–Hapja e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Portugali.



Lisbonë, 11 janar 2019–Hapja e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Portugali.



TAKIM ME PRESIDENTIN E FORUMIT CRANS MONTANA

PRISHTINË, 15 JANAR 2019

Crans Montana Forum do të mbahet në Kosovë. Takim produktiv me Presidentin e Forumit Crans Montana, z. Pierre Emmanuel Quirin. Sipas idesë dhe propozimit tim jemi dakorduar për organizimin e Forumit prestigjioz botëror Crans Montana në Kosovë gjatë këtij viti. Kosova do të jetë nikoqire e kësaj ngjarje të madhe të nivelit ndërkombëtar.



Prishtinë, 15 janar 2019–*Takim me Presidentin e Forumit Crans Montana, z.Pierre Emannuele Quirin.*



TAKIM ME MAJLINDA BREGU

15 JANAR 2019, PRISHTINË

Unë e mirëprita në Prishtinë Majlinda Bregu në vizitën e saj të parë që nga marrja e detyrës. Ne biseduam për përparësitë e RCC dhe rëndësinë që ajo të përdoret si një mekanizëm kryesor për bashkëpunimin rajonal në Western Balkans. Kosova gjatë kryesisë së ardhshme të SEECP do ta mbështesë këtë qëllim.



Prishtinë, 15 janar 2019 – Takim me Majlinda Bregun në zyrat e MPJ-së në Prishtinë



TAKIM ME Z.REXHEP SALIU – I NGARKUAR ME PUNË I AMBASADËS SË MAQEDONISË NË KOSOVË

PRISHTINË, 21 JANAR 2019

Kosova dhe Maqedonia gëzojnë marrëdhënie të shkëlqyeshme, dhe ballafaqohen me sfidat e njëjta në rrugëtimin e tyre në integrimet euro-atlantike. Me të ngarkuarin me punë të Maqedonisë diskutuam për thellimin e mëtejme të marrëdhënieve tona në të gjitha fushat e interesit të përbashët.



Prishtinë, 21 janar 2019- Takim me z.Rexhep Saliu, i ngarkuar me punë i Ambasadës së Maqedonisë në Kosovë.



TAKIM ME AMBASADORËN KROATE, NË PRISHTINË, ZNJ. MARIJA KAPITANOVIĆ

PRISHTINË, 21 JANAR 2019

Në takim me Ambasadorën Kroate, në Prishtinë, Znj. Marija Kapitanović, biseduam rreth kërkesave të MPJ-së, drejtuar shtetit Kroat të cilat do të realizohen në vitin 2019. Më pas diskutuam edhe për vizitën time në Kroaci, përmbushja e kërkesave relevante dhe dergimi i Ambasadorëve Kroatë. Temë diskutimi ishte edhe gjetja e një zgjidhjeje të përbashkët, në lidhje me çështjen e INA-së, ku në ditët në vijim do të presim përfaqësuesin e INA-së, për të sqaruar këtë çështje. Në fund fare diskutuam edhe për krijimin e një Forumi ekonomik mes Kosovës dhe Kroacisë gjatë këtij viti, u diskutua për projekte konkrete sidomos në fushën e Bujqësisë.



Prishtinë, 21 janar 2019 - Takim me Ambasadorën e Kroacisë në Kosovë, Znj. Marija Kapitanović.



TAKIMIT ME DREJTORIN EKZEKUTIV TË WESTERN BALKANS FUND, Z. GJERGJ MURRA

PRISHTINË, 21 JANAR 2019

Gjatë këtij takimi është diskutuar për mënyrat e prezencës sa më të madhe mediale edhe në kuadër të proceseve të ndryshme të WBF. Po ashtu, u theksua rëndësia e rritjes së bashkëpunimit rajonal në Fondin e Ballkanit Perëndimorë, përmes mbështetjes së projekteve të përbashkëta. Është vlerësuar fakti që është dyfishuar kontributi vjetor prej 30.000 në 60.000 €, dhe si kryesues Kosova zotohet për vazhdimin e trendit të rritjes së kontributit. Gjithashtu është diskutuar për hapjen e WBF për financim të jashtëm. Pikë diskutimi ka qenë edhe takimi në nivel ministrorë që duhet të mbajtur në Kosovë.



Prishtinë, 21 janar 2019- Takim me z.Gjergj Murra, Drejtor Ekzekutiv në Western Balkans Fund.



TAKIM ME KËSHILLTARIN E PËRZGJEDHUR PËR DIALOG, Z.MARK WELLER

PRISHTINË, 21 JANAR 2019

Mark Weller u shpreh i interesuar të përkrahë Ekipin e Dialogut në Zhvillimin e një platforme të Përbashkët, platformë e cila do të promovojë gjithandëj në botë, platformë e cila do t'i komunikonte Parime e Forta të saj; Procesi është dinamik, përderisa mos shfrytëzimi i këtij rasti nga Kosova, do të mund të rezultonte me largimin e presionit ndërkombëtar mbi Serbi. Parimet e Platformes do të ishin, në njëren anë fleksibile mjaftueshëm për dialoguesit, por në anën tjetër të forta dhe të qarta në aspektin e llogaridhënies dhe pronësisë së Parlamentit të Kosovës në lidhje me këtë proces. Në fillim të procesit Kosova do të duhej të promovonte një qasje të fortë negociuese; Në mesin e kësaj jave do të ndajë Platformën në fjalë, një dokument që mund të ketë 15 faqe, me anëtarët e Ekipit Dialogues, e cila pastaj do të pranojë komentet e secilit.



Prishtinë, 21 janar 2019- Takim me mikun tim Mark Weller, kënaqësi takimet me të



Prishtinë, 21 janar 2019-Takim me z.Mark Weller, Këshilltar i përzgjedhur për Dialog



TAKIM NË REZIDENCËN TIME ME KOMANDANTIN E KFOR-IT GJENERAL-MAJOR LORENZO D'ADDARIO

PRISHTINË, 30 JANAR 2019

Zhvilluam një takim shumë miqësor, përderisa diskutuam mbi zhvillimet e gjithëmbarshme , që po kalon vendi ynë nga ana politike, të sigurisë dhe bashkëpunim me KFOR-in. Kosova dhe qytetarët e saj i janë mirënjohës kontributit, që kanë ofruar, po ofrojnë dhe do të ofrojnë edhe në të ardhmen shtetet aleate, partnere dhe mike në forcimin e sigurisë dhe stabilitetit nacional dhe atij rajonal.



Prishtinë/Hajvali, 30 janar 2019- *Takim me Komandantin e KFOR-it në Kosovë, Gjeneral-Major Lorenzo D'Addario.*



I NDERUAR QË PRITA NË VIZITË KRYETARIN E QYTETIT TË LINZ-IT Z. KLAUS LUGER DHE DELEGACIONIN E TIJ

PRISHTINË, 31 JANAR 2019

Me Kryetarin e Linzi-it, ne diskutuam për mundësinë e bashkëpunimit institucional në mes Shtetit të Austrisë dhe Republikës së Kosovës. Kryetari i Linzit Z.Luger premtoi mbështetjen e gjithëanshme në të gjitha fushat ku ka mundësi bashkia e Linzit. Në këtë takim u cekën tema të ndryshme të bashkëpunimit, ndër to: Arsimi, Shëndetësia, Industria e Rëndë, Agrokultura, Turizmi, Sporti, por gjithashtu Kryetari i Linzit ofroj edhe gatishmërinë e tij për Binjakëzimin e Linzit me ndonjë nga qytetet e Kosovës.






TAKIME JO FORMALE TË ZHVILLUARA NË BUKURESHT ME HOMOLOGË NGA SHTETE TË NDRYSHME

BUKURESHT, 1 SHKURT 2019

Me ftesë të homologut tim nga Rumania, Teodor Malescanu, qëndrova në Bukuresht të Rumanisë. Në takimet e zhvilluara ishte një mundësi për shkëmbim jo-formal të pikëpamjeve mbi të ardhmen e rajonit, ndërsa qëllimi i diskutimeve, që të forcohet dialogu dhe bashkëpunimi rajonal në pikëpamje të sfidave globale. Zhvillova takime bilaterale edhe me homologun çek, z.Tomas Petricek atë slloven z. Miro Cerar, sllovak z.Miroslav Lajcak dhe polak z.Jacek Czaputowicz. Kosova gëzon një mbështetje të qëndrueshme dhe të palëkundur në të gjitha proceset e rëndësishme që na presin përpara.





TAKIM BILATERAL ME HOMOLOGUN ÇEK, Z.TOMAS PETRICEK

BUKURESHT, 1 SHKURT 2019

Diskutim i shkëlqyeshëm me Ministrin e Jashtëm të Çekisë Tomas Petricek për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm dypalësh që dy vendet tona gëzojnë dhe mbështetja e përhershme shteti Çek i ka dhënë integritet euro-atlantik. Ne do të eksplorojmë fusha më konkrete se si ta zgjerojmë partneritetin tonë më tej.





TAKIM BILATERAL ME HOMOLOGUN POLAK Z. JACEK CZAPUTOWICZ

BUKURESHT, 1 SHKURT 2019

Mirë për të parë përsëri Poloninë dhe Jacek Czaputowicz në takimin e Gymnich në Bukuresht për të shkëmbyer mendime mbi bashkëpunimin dypalësh, gjendjen e punëve në BB dhe procesin e integritit evropian të Kosovës dhe rajonit. Ne mezi presim udhëheqjen polake në Procesin e Berlinit këtë vit.





TAKIM BILATERAL ME HOMOLOGUN SLOVAK, Z.MIROSLAV LAJČAK

BUKURESHT, 1 SHKURT 2019

Diskutim i shkëlqyeshëm me Ministrin Sllovak dhe Kryetarin e OSCE Miroslav Lajčak mbi bashkëpunimin dypalësh midis Kosovës dhe Sllovakisë dhe përkrahjen e tij për të ardhmen e Kosovës në BE. Liberalizimi i vizave është një çështje thelbësore për Kosovën. Ne do t'i mbështesim aktivitetet e OSBE-së gjatë kryesisë së Sllovakisë.





RRUGËS PËR SHBA

WASHINGTON, 4 SHKURT 2019

Me ftesë të Sekretarit të shtetit Mike Pompeo do të marrë pjesë në ministerialin e koalicionit kundër ISIS-it. Kosova është e rreshtuar fuqishëm në krah të SHBA, në secilin angazhim ndërkombëtar. Gjithashtu gjatë qëndrimit në Washington do të marr pjesë në një nga ngjarjet unike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në lutjet e mëngjesit, në vendin që inspiron botën me vlerat e lirisë dhe tolerancës, e ku për këto qëllime bëhen bashke me mijëra personalitete nga bota mbarë.



Washington, 4 shkurt 2019-Rrugës për pjesëmarrje në Ministerialin e Koalicionit kundër ISIS-it, me ftesë të Sekretarit amerikan të Shtetit, Mike Pompeo



NË FORUMIN MBI SFIDAT E EVROPËS JUGLINDORE

WASHINGTON 5 SHKURT 2019

Mëngjesin në Washington e fillova me pjesëmarrjen në Forumin mbi sfidat në Evropën Juglindore, I organizuar nga Senatori Paul Inhofe, në Senatin Amerikan. Në adresimin tim para kongresmenëve dhe pjesëmarrësve të tjerë, potencova rëndësinë jetike të prezencës amerikane në rajon si garantuese e paqes dhe demokracisë. Në anën tjetër denoncova lojën e pistë që Serbia në vazhdimësi zhvillon duke vazhduar me minimin e paqes nëpërmjet prezencës ruse. Rajoni i Ballkanit I takon NATOS-s dhe kjo gjë nuk ka alternativë.





VIZITË NË KOMPANINË BOEING NË SHBA

WASHINGTON, 6 SHKURT 2019

Gjatë vizitës në Washington, së bashku me Presidentin Thaçi, Ambasadorën Çitaku dhe përfaqësuesin e FSK-së në kompaninë Boeing.



Washington, 6 shkurt 2019- Bashkë me Presidentin Thaçi, Ambasadoren Çitaku dhe përfaqësuesin e FSK-së në kompaninë Boeing.



TAKIM ME ISH-KRYEBASHKIAKUN E NEW YORK-UT, RUDY GUILIANI

WASHINGTON, 6 SHKURT 2019

Takimi me Guilianin, që është njeri jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe me peshë në politikinën amerikane, u zhvillua në frymë shumë miqësore. SHBA janë garant i shtetësisë dhe lirisë së Kosovës andaj bashkëpunimi i ngushtë me këtë vend është jetim për të ardhmen tonë. Kënaqësi e jashtëzakonshëm që kryebashkiakun legjendar të Nju Jorkut gjatë periudhës së sulmeve terrorite, ta mirëpresim në Prishtinë, ftesë të cilën pa asnjë hezitim pranoi.



Washington, 6 shkurt 2019- Takim me ish-kryebashkiakun e New York-ut, Rudy Guiliani.



NË HAPJE TË PUNIMEVE TË MINISTERIALIT

WASHINGTON, 6 SHKURT 2019

Në hapje të punimeve të ministerialit të shteteve anëtare të Koalicionit Global kundër ISIS-it, vlerësova se Republika e Kosovës qëndron fuqishëm në krah të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në luftën kundër ISIS-it, e cila i ka shkaktuar dëme edhe vendit tonë.




Washington, 6 shkurt 2019 – *Në hapje të punimeve të ministerialit të shteteve anëtare të Koalicionit Global kundër ISIS-it*



TAKIM ME FITUESEN E ÇMIMIT NOBEL PËR PAQE, NADIA MURAD

WASHINGTON, 6 SHKURT 2019

Gjatë drekës në Departamentin Amerikan të Shtetit, kisha nderin të takohem dhe të bashkëbisedoj me fituesen e çmimit nobel për paqe Nadia Murad. Nadia është mbajtur peng nga ISIS dhe është dhunuar seksualisht. Bashkëbiseduam për fatin e njejtë të mbi 20 mijë grave të Kosovës të cilat u dhunuan nga forcat serbe në Kosovë. Nadia do të vizitojë Kosovën me ftesë të qeverisë tonë, për të senzibilizuar botën për fatin e femrave të Kosovës që vazhdojnë të vuajnë edhe sot e kësaj dite.



Washington, 6 shkurt 2019 – I nderuar të takohem dhe të bashkëbisedoj me fituesen e çmimit nobel për paqe, Nadia Murad.



MINISTERIALI I KOALICIONIT GLOBAL KUNDËR ISIS-IT

WASHINGTON, 6 SHKURT 2019

Në adresimin tim para rreth shtatëdhjetë ministrave të jashtëm nga e gjitha bota, që përfaqësonin vendet e tyre në ministerialin e Koalicionit Global kundër ISIS-it, kam potencuar se krijimi i Ushtrisë së Kosovës në koordinim të plotë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ngrit ndjeshëm kapacitetet e vendit tonë në ndërtimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt.



Washington, 6 shkurt 2019-Ministeriali i Koalicionit Global Kundër ISIS-it.



TAKIM ME HOMOLOGUN NGA KOLUMBIA, CARLOS HOLMES TRUJILLO

WASHINGTON, 8 SHKURT, 2019

Në vazhden e qëndrimit në ShBA me ftesë të Sekretarit Amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, kam takuar edhe homologun tim nga Kolumbia, Carlos Holmes Trujillo. Me këtë rast, jam informuar zyrtarisht se Presidenti i Kolumbia-s ka nominuar zyrtarisht Ambasador jo-rezident në Republikën e Kosovës. Kosova vazhdon konsolidimin e vet ndërkombëtar, duke vendosur marrëdhënie me secilin shtet të botës. Kolumbia është vend jashtëzakonisht i fuqishëm në Amerikën e Jugut, andaj edhe Republika e Kosovës shumë shpejt do të ketë Ambasadën e vet atje, që do të mbulojë shumë vende të kontinentit latin”.



Washington, 8 shkurt 2019- *Takim me homologun nga Kolumbia, Carlos Holmes Trujillo.*



TAKIM ME AMBASADORIN E MBRETËRISË SË JORDANISË, SH.T. ISMAIL RIFAIE

PRISHTINË, 12 SHKURT 2019

Gjatë takimit që e kishim me Ambasadorin e Mbretërisë së Jordanisë, SH.T. Ismail Rifaie njekohejisht ambasador i parë i Jordanisë për Kosovën, ripërsëriti se Jordania është ndër vendet e para të atij rajoni e cila e ka njohur pavarësinë e Kosovës. Një nga ofertat e tij kryesore ishte bashkëpunimi në fushën e ekonomisë me theks të veçantë tek bashkëpunimi i kompanive private. Ambasadori Rifaie ofroj bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë, në veçanti lavdëroj prodhimet medicinale të cilat gjejnë hapësirë në tregjet e SHBA-së dhe gjetiu. Një nga temat me rëndësi të cilat i vuri në pah është shkëmbimi i studentëve, posaçërisht tek Universitetet Islamike udhëhequr nga kushëriri i mbretit, duke vënë theksin se në Jordani kultivohet islami i moderuar.





TAKIM ME PËRFAQËSUESN E UNDP, ZNJ.ALESSANDRA ROCCASALVO

PRISHTINË, 12 SHKURT 2019

Gjatë këtij takimit biseduam për tema të ndryshme me rëndësi për Kosovën si dhe bashkëpunimin e ndërsjellët në mes të UNDP-së dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, duke përfshirë edhe bashkëpunimin në të ardhmen. Me këtë rast e falënderova znj. Roccasalvo për mbështetjen që i ka dhënë UNDP-ja Ministrisë së Punëve të Jashtme, në çështje të ndryshme, përmes ofrimit të mbështetjes konsulente.





TAKIM PUNE ME SHEFIN E RI TË ZYRËS SË SLLOVAKISË NË PRISHTINË, Z.RASTISLAV KOSTILNIK

PRISHTINË, 13 SHKURT 2019

Në një takim pune me Shefin e ri të Zyrës së Sllovakisë në Prishtinë, z. Rastislav Kostilnik, diskutuam mbi çështje të interesit të përbashkët në mes dy shteteve. Vazhdimi i mbështetjes së mëtutjeshme sllovaqe në rrugëtimin e integritit euro-atlantik dhe ndërkombëtar të shtetit të ri, si dhe nevoja për përkrahjen e Sllovakisë për liberalizimin e vizave për shtetasit e Kosovës kanë zënë vend të veçantë gjatë diskutimeve të takimit. Hapja e Zyrës Ndërlidhëse të Kosovës në Bratislavë ka qenë një kërkesë tjetër nga ana jonë, gjë për të cilën do të zhvillohen konsultimet e afërta në mes dy vendeve për gjetjen e mundësisë.





TAKIM ME AMBASADORIN E KANADËS PËR KOSOVËN DANIEL MAKSIMIUK

PRISHTINË, 13 SHKURT 2019

Gjatë takimit me Ambasadorin e Kanadës për Kosovën Sh.T.Z. Daniel Maksimiuk biseduam rreth zhvillimeve të fundit në Kosovë, përfshi edhe dialogun Kosovë-Serbi. Ambasadorin rreth potencialeve investuese në Kosovë dhe mundësinë që kompanitë kanadeze të jenë edhe më prezente në Kosovë. Në takim biseduam edhe rreth çështjes së ndjeshme të refuzimit të vizave për gjithë ish pjesetaret e UCK-së dhe sidomos rreth arsyetimit të lëshuar nga autoritete konsullore kanadeze në Vjene. Ambasadori siguroi se as në Ligjin për Migrim të Kanadasë, e as në asnjë institucion tjetër nuk është e listuar UCK si organizate ose entitet terrorist.



-Takim me Ambasadorin e Kanadasë në Kosovë, Sh.T.Z. Daniel

Maksimiuk.



PRANIMI I KOPJEVE TË LETRAVE KREDENCIALE NGA AMBASADORI I RI I TURQISË NË KOSOVË, SAKAR

PRISHTINË, 13 SHKURT 2019

Kam pritur në takim Ambasadorin e ri të Republikës së Turqisë në Republikën e Kosovës, Çağrı Sakar, nga i cili kam pranuar edhe kopjet e Letrave Kredenciale. I shpreha mirëseardhje diplomatit turk në vendin tonë dhe i urova suksese në detyrën e re, duke theksuar që Republika e Kosovës vazhdimisht ka ndier përkrahjen e Republikës së Turqisë, si në procesin e shtet-ndërtimit, ashtu edhe në shumë procese tjera, dhe i ka vlerësuar marrëdhëniet bilaterale me shtetin mik të Turqisë. Ambasadori Sakar, shprehi falënderimet për mikpritjen dhe ka përcjellur gatishmërinë personale për të kontribuar për vazhdimin e marrëdhënieve shumë të mira ndërmjet dy vendeve.





TAKIM ME KOORDINATOREN E RE TË EKIPIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA NË KOSOVË, ZNJ ULRIKA RICHARDSON

PRISHTINË, 14 SHKURT 2019

Në takim njohës me Koordinatorën e re të Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, znj Ulrika Richardson, ne diskutuam mbi bashkëpunimin në mes Republikës së Kosovës dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara, nëpërmjet programeve zhvillimore në nivelin nacional, të cilat janë në përputhje me objektivat e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.





DHJETËRA TAKIME ME BURRËSHTETAS NGA SHTETE TË NDRYSHME TË BOTËS NË KUADËR TË KONFERENCËS SË SIGURISË NË MYNIH

MYNIH 15-16 SHKURT 2019

Në kuadër të pjesëmarrjes së në njëjërën nga konferencat më të rëndësishme dhe më prestigjioze në nivelin ndërkombëtar mbi çështjet e sigurisë, në Mynih të Gjermanisë, bashkë me Kryeministrin Haradinaj zhvilluam një takim me Komisionerin e BE-së për Zgjerimin, z.Johanes Hahn. Biseda u fokusua mbi perspektivën evropiane të Kosovës dhe nevojën që vendet anëtare të BE-së të aprovojnë rekomandimin e komisionit të BE-së për liberalizimin e vizave.






BASHKË ME KRYEMINISTRIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS RAMUSH HARADINAJ DHE SENATORIN RON JOHNSON

MYNIH 15-16 SHKURT 2019

Takim tjetër së bashku me Kryeministrin Haradinaj kemi pasur në Konferencën e Sigurisë së Mynihut edhe me senatorin z.Ron Johnson për marrëdhëniet strategjike midis Kosovës dhe SHBA dhe angazhimin amerikan drejt një Ballkani Perëndimor demokratik, të lirë dhe prosperues. Roli Amerikan është thelbësor për Kosovën në të gjitha nivelet.



Gjermani, 15 shkurt 2019- *Bashkë me kryeministrin e Republikës së Kosovës Ramush Haradinaj dhe senatorin Ron Johnson.*



TAKIM ME HOMOLOGUN GJERMAN, HEIKO MASS

MYNIH 15 SHKURT 2019

Me ministrin e jashtëm gjerman z.Heiko Mass biseduam për raportet që duhet ti intensifikojmë ndërmjet dyja vendeve tona. Gjermania si njëri ndër përkrahësit më të fuqishëm të Kosovës vazhdon mbështetjen e madhe për vendin tonë. I inkurajuar jashtëzakonisht shumë me mbështetjen e madhe gjermane për heqjen e merituar të vizave për vendin tonë, do të vazhdoj koordinimin me ministrin Mass për përmbylljen e shpejtë të këtij procesi.





TAKIM ME ISH-SEKRETARIN, JOHN KERRY

MYNIH 16 SHKURT 2019

Takim tjetër së bashku me Kryeministrin Haradinaj kemi pasur në Konferencën e Sigurisë së Mynihut edhe me Ish Sekretarin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), z. John Kerry, i cili gjithmonë është i vëmendshëm dhe i interesuar për zhvillimet në Kosovë.





TAKIM ME ISH SEKRETAREN AMERIKANE TË SHTETIT ZNJ. MADELEINE ALBRIGHT

MYNIH-GJERMANI, 16 SHKURT 2019

Takimi me ish Sekretaren Amerikane të shtetit znj. Madeleine Albright gjithmonë emocional dhe i frytshëm. Vendosmëria dhe këmbëngulja e sekretares Albright për ti dalë në krah popullit të Kosovës e bën atë pjesë të rëndësishme të historisë së Kosovës.





TAKIM ME KRYEMINISTRIN E KORACISË Z.ANDREJ PLENKOVIC

MYNIH-GJERMANI, 16 SHKURT 2019

Në margjinat e Konferencës së Sigurisë në Mynih, bashkë me Kryeministrin Haradinaj takuam Kryeministrin e Koracisë z.Andrej Plenkovic. Republika e Kosovës dhe shteti kroat do ti avansojnë raportet politike dhe ekonomike si dy partner strategjikë në Ballkan. Raportet me Kroacinë do ti avansojmë edhe më tej duke hapur edhe konsullatën e përgjithshme në Zarë.





DISA NGA TAKIMET NË DITËN MBYLLËSE TË KONFERENCËS SË SIGURISË SË MYNIHUT

MYNIH-GJERMANI, 16 SHKURT 2019

Konferencës së Sigurisë së Mynihut i erdhi fundi. Ishte një ngjarje e rëndësishme për të treguar praninë e Kosovës dhe për të takuar dhe diskutuar me udhëheqësit botërorë rreth mundësive dhe sfidave tona. Kemi përdorur prezencën për të lobuar për liberalizimin e vizave për Kosovën si pikë kthese të marrëdhënieve midis Kosovës dhe BE-së dhe gjithashtu të takohem me miqtë dhe partnerët e Kosovës. Sfidat me të cilat ballafaqohet Evropa dhe bota po na ndikojnë gjithashtu, por së bashku jemi të fortë dhe vetëm përmes bashkëpunimit dhe afrimit me Shtetet e Bashkuara dhe Evropën mund t'i kapërcejmë këto sfida.



Mynih – Gjermani, 16 shkurt 2019- Disa nga takime nga Konferenca e Sigurisë në Mynih



Mynih – Gjermani, 16 shkurt 2019- Bashkë me kryeministrin Haradinaj në disa nga takimet.



NGA CEREMONIA E FESTIMIT TË 11 VJETORIT TË PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PRISHTINË, 17 SHKURT 2019

Kolazh fotosh nga ceremonia e 11 vjetorit të Ditës së Pavarësisë

Republika e Kosovës është shtet i ndërtuar si rezultat i sakrificës së shumë gjeneratave që lirinë dhe vlerat humane i kishin bazament. Shteti ynë do të forcohet dhe do ti shërbejë paqes dhe sigurisë së qytetarëve të vet dhe botës përgjithësisht.

Lavdi të Rënëve.





Prishtinë, 17 shkurt 2019- Gjatë Mbledhjes së Qeverisë, me rastin e ceremonisë së 11 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.



Prishtinë, 17 shkurt 2019 - Së bashku me Presidentin Thaçi dhe kryeministrin Haradinaj me rastin e ceremonisë së 11 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.



Prishtinë, 17 shkurt 2019 – Mbledhja e Qeverisë së Kosovës me rastin e ceremonisë së 11 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.



Prishtinë, 17 shkurt 2019 – Mbledhja e Qeverisë së Kosovës me rastin e ceremonisë së 11 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.



Prishtinë, 17 shkurt 2019 – Gjatë intonimit të himnit në Kuvendin e Kosovës me rastin e ceremonisë së 11 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.



Prishtinë, 17 shkurt 2019 – Gjatë intonimit të himnit në Kuvendin e Kosovës me rastin e ceremonisë së 11 vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.



FOTO NGA PARAKALIMI I USHTRISË, ME RASTIN E 11 VJETORIT TË DITËS SË PAVARËSISË



Prishtinë, 17 shkurt 2019 – Me rastin e 11 vjetorit të ditës së Pavarësisë së Kosovës



Prishtinë, 17 shkurt 2019 – Foto nga parakalimi i Ushtrisë së Kosovës, me rastin e 11 vjetorit të ditës së Pavarësisë



Prishtinë, 17 shkurt 2019 – Foto nga parakalimi i Ushtrisë së Kosovës, me rastin e 11 vjetorit të ditës së Pavarësisë



Prishtinë, 17 shkurt 2019 – Ecje në sheshin Skenderbe së bashku me bacin Rifat Jashari dhe kryeministrin Haradinaj, me rastin e 11 vjetorit të ditës së Pavarsisë



HOMAZHE NË PREKAZIN HISTORIK NË 11 VJETORIN E PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.

PREKAZ, 17 SHKURT 2019





Prekaz, 17 shkurt 2019 – Homazhe në Prekazin historik së bashku me Presidentin Thaçi dhe kryeministrin Haradinaj



Prekaz, 17 shkurt 2019 – Homazhe në Prekazin historik së bashku me Presidentin Thaçi dhe kryeministrin Haradinaj



**MOMENTE NGA PRITJA SHTETËRORE ME RASTIN E 11
VJETORIT TË PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

PRISHTINË, 17 SHKURT 2019





Prishtinë, 17 shkurt 2019 – Së bashku me mikun tim Walker nga pritja shtetërore me rastin e 11 vjetorit të Pavarësisë



KOMUNIKATË PËR MEDIA ME RASTIN E 11 VJETORIT TË PAVARSISË

PRISHTINË, 19 SHKURT 2019



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Kosova do të shtrijë dhe përforcojë rrjetin diplomatik në disa kontinente, Ambasadat në Tajlandë, Bangladesh janë hapur, kurse në Kolumbi dhe Ganë hapen së shpejti

Prishtinë, 19 shkurt 2019 – Në vitin e njëmbëdhjetë të ekzistencës së saj si shtet i pavarur, sovran dhe i mirë integruar në komunitetin ndërkombëtarë të shteteve, Republika e Kosovës do të vazhdojë të shtrijë dhe përforcojë edhe më shumë rrjetin e saj diplomatik në disa kontinente. Mbretëria e Tajlandës, Republika Popullore e Bangladeshit, Republika e Kolumbia-s dhe Republika e Ganës janë disa nga shtetet, ku pritet të hapen dhe funksionalizohen Ambasadat e reja të Republikës së Kosovës brenda këtij viti kalendarik. Nëpërmjet këtyre Misioneve të reja Diplomatike, Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës synon të mbulojë edhe disa shtete të tjera nëpërmjet akreditimeve jo-rezidente, me qëllimin e zgjerimit të bashkëpunimit dhe vendosjes së partneriteteve sipas interesave të përbashkëta. Ministria e Punëve të Jashtme tashmë ka ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet për procedurat respektive, që ndërliidhen me hapjen dhe funksionalizimin e plotë të këtyre Ambasadave.



GJATË NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJE DYPALËSHE ME HOMOLOGEN JAPONEZE

PRISHTINË, 21 SHKURT 2019

Pas takimit dypalësh që kam zhvilluar në ambientet e Ministrisë së Punëve të Jashtme me Ministren e Shtetit për Punë të Jashtme të Japonisë, znjsh. Toshiko Abe, kemi nënshkruar një Marrëveshje dypalëshe në mes dy vendeve, nëpërmjet së cilës, Republika e Kosovës do të përfitojë një grant me vlerë prej 250 milion jen japonez. Qeveria japoneze nëpërmjet ofrimit të këtij granti synon promovimin e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit tonë nëpërmjet programeve të ndryshme, që ndërlidhen me këto fusha. Nga ana e saj, Ministrja Abe, duke vlerësuar marrëdhëniet shumë të mira në mes dy vendeve dhe dy popujve ka theksoi që Qeveria japoneze dëshiron, që ato të zhvillohen edhe më shumë në të ardhmen.



Prishtinë, 21 shkurt 2019 - Gjatë takimit me Ministren e Shtetit për Punë të Jashtme të Japonisë, Abe



TAKIM ME SHEFEN E EULEX-IT, ALEXANDRA PAPADOPOUOLU PRISHTINË, 26 SHKURT 2019

Në takim me shefen e EULEX-it diskutuam se transformimi të këtij misioni në Kosovë. Theksuam se transferimi i EULEX-it, në pjesën veriore të Kosovës është një problematikë. Dy palët u pajtuam se arritja e marrëveshjes është e vetmja zgjidhje mes Kosovës dhe Serbisë.



Prishtinë, 26 shkurt 2019-Takim me Shefen e EULEX-it, Znj.Alexandra Papadopouolu.



LETËR E HAPUR PRESIDENTIT TË SERBISË

PRISHTINË, 27 SHKURT 2019

I nderuar President i Serbisë, z.Vuçiq

Si udhëheqës i politikës së jashtme dhe diplomacisë së Republikës së Kosovës, po ju drejtohem me këtë letër vullnetmire. Jam thellësisht i bindur, që thellë-thellë, edhe nëse nuk i afirmoni publikisht, ju do t'i mirëkuptoni, si frymën ashtu edhe mesazhet konstruktive të kësaj letre të hapur. Askush nuk mundë të pretendojë se ju nuk e njihni fare mirë historinë politike të disa vendeve në rajon. Është temë tjetër se si i qaseni ju asaj aktualisht.

Institucionet e Republikës së Kosovës, janë vendosmërisht të përkushtuara, që t'i zbatojnë dhe afirmojnë të drejtat qytetare dhe kushtetuese të komunitetit serb në Kosovë. Kjo vlen kudo që jeton ky komunitet, në jug, lindje, veri apo perëndim të Republikës së Kosovës.

Përpos për serbët, ne veprojmë kështu edhe për të gjitha komunitetet që jetojnë në shtetin tonë të ri. Ndryshe nuk ka se si të jetë. Kosova renditet tek kombet dhe shtetet që u ngritën dhe që qëndrojnë mbi themelet e lirisë.

I nderuar z.President,

Sot ishim dëshmitar të një takimi mes Jush dhe disa serbëve të Republikës së Kosovës. Jemi të tronditur me faktin, që në vend se ky takim të ishte rutinor, mos të them konstruktiv e paqedashës, Ju pohoni se këtij takimi do t'i referoheni në komunikime e biseda të nivelit të lartë ndërkombëtar, madje edhe ne Kinë. Nuk e kuptojmë logjikën e "mureve kineze" mes dy vendeve tona, e cila është edhe në kundërshtim me çasjen evropiane e cila po investon në konektivitet në këto hapësira.

Serbia, dhe ju si President i saj, nuk do të duhej të synoni, t'i ktheni serbët e Republikës së Kosovës në murin ndarës, ku përplasen mospajtimet tona ndër-shtetërore. Ju jeni në dijeni, se për dallim prej Serbisë, Republika e Kosovës e ka paraparë me Kushtetutë që bashkëpunimi ndër-shtetëror mes të dyja vendeve tona të mund të lehtësohet edhe përmes komunikimit serb. Ju po ashtu e dini, që kjo nuk mund të ndodhë në dëm të karakterit Sovran dhe unitar të Republikës së Kosovës.

Askush mbi faqe të dheut nuk mundë të mohojë faktin që serbët e Republikës së Kosovës jetojnë në një ambient të sigurtë dhe sipas një rendi juridik e institucional, ku të drejtat dhe mundësitë në dobi dhe favor të tyre, flasin asimetrikisht. Mohimi i fakteve nga ana juaj paraqet mëkat, përderisa t'u kërkohet serbëve t'i refuzojnë ato, përbëjnë mëkat e vuajtje bashkë. Është koha që Serbia t'i lejoje serbët të bëjnë jetën e tyre të lirë nga ndërhyrjet e saj.



Nuk mund të mos ua them, që mesazhet me të cilat i drejtoheni serbëve në vizitë në Serbi, dhe përmes tyre bashkëqytetarëve serb në Republikën e Kosovës, ndonëse të projektuara të targetojnë rrugëtimin ndërkombëtar të vendit tonë, ngarkojnë negativisht dhe dëmtojnë vetëm komunitetin serb, asgjë më shumë. Kosova dhe shtetësia e saj, si Brenda ashtu edhe ndërkombëtarisht, nuk dëmtohen nga mesazhe të tilla përçarëse.

President i nderuar,

Politika e instrumentalizimit të qytetarëve serbë, nga Serbia zyrtare, në funksion të shfrytëzimit të tyre të vahdueshëm në procesin e dialogut për Marrëveshjen gjithëpërfshirëse, ligjërisht obliguese për të dy shtetet, ndërkombëtarisht e afirmuar si paqësore, nuk mund të jetë as premtuese as e qëndrueshme.

Politika dhe qasja instrumentalizuese si kjo në lidhje me takimin që keni zhvilluar sot, përpos që prodhon kundërefekte në teren, ajo po ashtu po deformon profilin paqedashës të cilin ju po provoni ta ndërtoni e ta plasoni me zell, kudo në komunitetin ndërkombëtar.

Jam i bindur që pajtoheni me mua nëse ju them, se ju nuk mund të shiheni njëkohësisht si njeri paqësor në SHBA dhe Evropë, ndërsa si planprishës e paqepërshës në rajon. Është paradoksale, për të mos thënë cinike, që ju të derdhni lotë krokodili në forume të nivelit të lartë evropiane, në lidhje me përkushtimin tuaj për arritjen e Marrëveshjes Gjithëpërfshirëse, përdërisa në anën tjetër në Serbi plasoni mesazhe tensioni dhe pasigurie për qytetarët serbë që jetojnë në Republikën e Kosovës. Ky është pozicionimi më i keq i mundshëm, jo vetëm në raport me serbët e Republikës së Kosovës, por edhe në raport me procesin e dialogut për Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse.

I nderuar z.Vuçiq,

Më lejoni të ofroj një përmbyllje ekspeditive të kësaj letre të hapur, sepse sikur në këto mesazhe, ne do të fokusohemi të jemi ekspeditiv në secilin proces.

Qytetarët e Republikës së Kosovës janë përballur me vuajtje e sakrifica, deri në atë nivel, për të cilin deri më sot, asnjë përfaqësues i lartë i Serbisë nuk ka gjetur kurajon që ta pranojë, e të mos flasim për pranimin e përgjegjësive shtetërore të vendit tuaj, të cilën ju e fshihni pas narracioneve jo të vërteta për të kaluarën dhe të tashmen e shtetit të Kosovës dhe shteteve tjera në Ballkan. Qindra masakra, dhjetra mijëra të vrarë dhe dhjetëra mijëra gra të dhunuara pranë fëmijëve dhe familjarëve të tyre.

Nuk mund të mos ua them, që Marrëveshja Gjithëpërfshirëse është një stad kthese drejt një paqeje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, e ku nënkuptohet një proces ku ju dhe vendi juaj, e pranoni përgjegjësinë, jepni llogari për krimet e kryera, dhe aktivisht përfshihen në ndërtimin e një kapitulli të ri të marrëdhënieve mes dy vendeve dhe popujve tanë.



Ndryshe nga pohimet tuaja fiktive, ne kemi ndërtuar një Ushtri paqësore e multietnike, FSK-në e cila mishëron vlerat e NATO-s, dhe e cila do të rrugëtojë bashkë me të. Duke qenë e kufizuar me vende anëtare të kësaj organizate, dhe me Kosovën e cila do të jetë anëtare e saj në të ardhmen, Serbia do të kufizohet me paqe dhe stabilitet.

Secili vëzhgues rasti i zhvillimeve në rajon, e lëre më një President sikurse jeni ju, është në dijeni që për Marrëveshjen Gjithëpërfshirëse mes dy shteteve tona, nuk ka alternativë.

Serbia ka pasur shumë liderë të cilët e kanë ditur që historia i ka rezervuar Kosovës atributet e shtetësisë, ndërkombëtarisht, por asnjëri nga ta nuk ka pasur kurajon që këtë ta pranojë publikisht këtë fakt. Rrjedhimisht Marrëveshja Gjithëpërfshirëse do të ndodhë, sepse ikja nga ajo nuk ka alternativë.

Uroj që ju të shiheni si Presidenti i Parë i Serbisë, i cili merr guximin të përballet me të vërtetën, njohjen e Republikës së Kosovës, dhe që nuk ikën nga kjo e vërtetë me takime të improvizuara sikurse ky i fundit mes jush dhe disa serbëve të Kosovës në vizitë tek ju në Beograd. Kontriboni paqës zoteri President i Serbisë!



PJESMARRËS NË TAKIMIN E MINISTRAVE TË JASHTËM TË ORGANIZATËS SË BASHKËPUNIMIT ISLAMIK

ABU DHABI, 28 SHKURT 2019

Me ftesë të autoriteteve të shtetit nikoqir, Emirateve të Bashkuara Arabe, kam qëndruar në Abu Dhabi, për të marrë pjesë dhe përfaqësuar vendin në sesionin e 46-të të Këshillit të Ministrave të Jashtëm të Organizatës për Bashkëpunim Islamik, që do të zhvillojë punimet më datën 1 dhe 2 mars, 2019. Në sesionin e titulluar: “50 vjet të Bashkëpunimit Islamik: Udhërrëfyesi për Prosperitet dhe Zhvillim”, pritet të ketë përfaqësues nga 26 shtete anëtare dhe nga pesë shtetë vëzhguese.





NË ABU DHABI, NË SAMITIN E OBI-SË, TAKIME ME PËRFAQËSUES NGA ARABIA SAUDITE, JORDANIA DHE TURQIA

ABU DHABI, 1 MARS 2019

E mrekullueshme ta takosh nje mik të mirë si Ministri i Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Emirateve të Bashkuara Arabe, Sheikh Abdullah bin Zayed Al Nahyan dhe për të diskutuar me të marrëdhëniet e shkëlqyera që gëzojnë Kosova dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Ne do të forcojmë partneritetin tonë në ekonomi dhe tregti përmes projekteve konkrete që do të ishin të dobishme për dy vendet tona.





NË TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË RUMANISË, TEODOR MELESCANU

ABU DHABI, 1 MARS 2019

Shkëmbim i mirë me Ministrin e Jashtëm të Rumanisë, Teodor Melescanu në anën e OIC Abu Dhabi mbi përparësitë e First Romanian Presidency of the Council of the EU-2019 dhe perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor.





BASHKBISEDIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË AFGANISTANIT, SALAHUDDIN RABBANI

ABU DHABI, 1 MARS 2019

Gjithmonë kënaqësi të bisedosh me mikun e mirë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Afganistanit Salahuddin Rabbani dhe të diskutosh për marrëdhëniet e mira mes Kosoves dhe Afganistanit. Së shpejti duhen ndërmarrë hapa konkretë për ta forcuar atë.





TAKIM ME MINISTRIN E PUNËVE TË JASHTME TË SOMALISË Z. AHMED ISSE AWAD

ABU DHABI, 1 MARS 2019

Shkëmbim i mirë me Ministrinë e Punëve të Jashtme të Somalisë me Ministrin Ahmed Isse Awad. Ne kemi marrëdhënie të mira dhe e mbështesin njëri - tjetrin në fazën ndërkombëtare. Ne do të punojmë për të forcuar shkëmbimin dypalësh.





TAKIM ME ZËVENDËSMINISTRIN E JASHTËM TË TURQISË, Z.SEDAT ÖNAL

ABU DHABI, 1 MARS 2019

Kam pasur një takim të frytshëm me Zëvendësministrin e Jashtëm të Turqisë z.Sedat Önal për marrëdhëniet tradicionale të shkëlqyera dhe mbështetjen e vazhdueshme që Turquia po i jep agjendës Euro Atlantike dhe Globale të Kosovës. Ne do të zgjerojmë më tej bashkëpunimin e ngushtë dypalësh në të gjitha sferat me interes reciprok.





TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË TOGO-S, Z.ROBERT DUSSEY

ABU DHABI, 1 MARS 2019

Bukur të takohem me mikun tim të mirë Ministrin e Jashtëm Tогоles z.Robert Dussey. Togo gjithmonë qëndronte me Kosovën dhe ne e vlerësojmë këtë miqësi të sinqertë. Ne do të bëjmë bashkëpunim konkret në fusha të dobishme për vendet tona.





BASHKBISEDIM ME MINISTRIN E SHTETIT PËR PUNË TË JASHTME TË ARABISË SAUDITE, Z. ABEL AL-JUBEIR

ABU DHABI, 1 MARS 2019

Një diskutim i shkëlqyeshëm me Adel Al-Jubeir, Ministrin e KSAmofaEN të Shtetit për Punët e Jashtme. Ne kemi marrëdhënie të shkëlqyera dhe ASK është një partner i besueshëm i Kosovës në qëllimin tonë për t'u bërë një anëtar i plotë dhe i barabartë i bashkësisë ndërkombëtare. Ne do të forcojmë partneritetin tonë.



Abu Dhabi, 1 mars 2019 – Gjatë takimit me Ministrin e Shtetit për Punë të Jashtme të Arabisë Saudite, z. Abel Al-Jubeir.



TAKIM ME MINISTRIN E PUNËVE TË JASHTME TË JORDANISË, Z.AYMAN SAFADI

ABU DHABI, 1 MARS 2019

Diskutim i shkëlqyeshëm mbi partneritetin tonë të shkëlqyeshëm me Jordanin, Ministri i Punëve të Jashtme Ayman Safadi. Kosova & Jordanoa gëzojnë lidhje të shkëlqyera dhe tradicionale dhe ne do të punojmë ngushtë për të forcuar marrëdhëniet në ekonomi, tregti, kulturë dhe siguri. Mezi pres ta vizitoj Jordanin së shpejti. Jordania është një aleat i fortë.



Abu Dhabi, 1 mars 2019 – Gjatë takimit me Ministrin e Punëve të Jashtme i Jordanisë, Z.Ayman Safadi.



LOBIM INTENZIV NË OBI, TAKIME ME HOMOLOGËT NGA KUVAJTI, GAMBIA, BANGLADESHI, EBA DHE AFGANISTANI

ABU DHABI, 2 MARS 2019

Në ditën e dytë të vazhimit të punimeve të sesionit të 46-të të Këshillit të Ministrave të Jashtëm të Organizatës për Bashkëpunim Islamik, që po i zhvillon punimet në Emiratet e Bashkuara Arabe, kam vazhduar lobimin intenziv edhe në orët e paraditës, me takimet dypalëshe, që kam zhvilluar me ministrin e jashtëm të Bangladeshit, Abdul Momen, me Zëvendëskryeministrin dhe ministrin e jashtëm të Kuvajtit, Sheikh Sabah Al Khaled Al Ahmad Al Sabah, ministrin e jashtëm të Gambisë, Mamadou Tangara, atë të Afganistanit, Salahuddin Rabbani si dhe Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Emirateve të Bashkuara Arabe, Sheikh Abdullah bin Zayed Al Nahyan.

Në të gjitha këto takime, kemi diskutuar për vazhdimin e thellimit të bashkëpunimit në mes dy vendeve, përderisa kemi kërkuar mbështetjen e mëtutjeshme për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtarë dhe integrimin e plotë të shtetit tonë në Organizatat Ndërkombëtare.

Hapja e Ambasadave të Republikës së Kosovës në Kuvajt e Bangladesh dhe emërimi i një Ambasadori jo-rezident në Afganistan ka qenë njëra nga temat e diskutimeve, ndërsa në takimet e ndara, që i kam zhvilluar me homologët nga Kuvajti, Bangladeshi dhe Afganistani si dëshmi e përkushtimit dhe zotimit të vendit tonë për avancimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit dy-palësh në të gjitha fushat e interesit të përbashkët.

Në takimin me homologun nga Emiratet e Bashkuara Arabe, numri dy i Qeverisë, Pacolli, ka diskutuar mbi bashkëpunimin për promovimin e investimeve dhe tregtisë si dhe pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e Kosovës në ExpoDubai 2020, ndërsa gjatë bashkëbisedimit me ministrin e jashtëm të Gambisë, ai e ka ftuar këtë të fundit, që ta vizitojë së shpejti vendin tonë.



GJATË TAKIMIT ME MINISTRIN E JASHTËM TË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE, SHEIKH ABDULLAH BIN ZAYED AL NAHYAN

ABU DHABI, 2 MARS 2019

Një takim i shkëlqyeshëm me Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Emirateve të Bashkuara Arabe, Sheikh Abdullah bin Zayed Al Nahyan, ne biseduam për marrëdhëniet e shkëlqyera që gëzojnë dy vendet tona. Kosova & Emiratet e Bashkuara Arabe do të zgjerojnë bashkëpunimin duke promovuar investime, shkëmbim tregtie, gjithashtu kemi biseduar për pjesëmarrjen e Kosovës në Expo Dubai. Emiratet e Bashkuara Arabe janë një partner i fortë i Kosovës.




Abu Dhabi, 2 mars 2019 – Gjatë takimit me Ministrin e Punëve të Jashtme të Emirateve të Bashkuara Arabe, Sheikh Abdullah bin Zayed Al Nahyan.



TAKIM ME HOMOLOGUN TIM NGA KUVAJTI, Z.SHEIKH SABAH AL KHALED AL AHMAD AL SABAH

ABU DHABI, 2 MARS 2019

Diskutim i shkëlqyeshëm me Zëvendëskryeministrin dhe Ministrin e jashtëm të Kuvajtit, Z.Sheikh Sabah Al Khaled Al Ahmad Al Sabah, mbi miqësinë tradicionale midis Kosovës dhe Kuvajtit dhe eksplorimin e zonave që afrojnë vendet tona. Kosova do të hapë Ambasadën e saj në Kuvajt për të forcuar lidhjet ekonomike dhe tregtare.





TAKIM I FRYTSHËM ME MINISTRIN E JASHTËM TË GAMBISË, Z. MAMADOU TANGARA

ABU DHABI, 2 MARS 2019

Mirë për të parë mikun tim Mamadou Tangara, Ministër i Jashtëm i Gambia. Që nga vizita ime e fundit në Banjul, dy qeveritë tona kanë shkëmbyer intensifikuar. Ne do të punojmë së bashku për të forcuar axhendën dypalëshe dhe shumëpalëshe. Tangara do të vizitojë Kosovën së shpejti për të forcuar lidhjet tona.



Abu Dhabi, 2 mars 2019 – Gjatë takimit me Ministrin e Jashtëm të Gambisë, Tangara.



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË AFGANISTANIT, Z.SALAHUDDIN RABBANI

ABU DHABI, 2 MARS 2019

Diskutim i mirë me Ministrin e Jashtëm të Afganistanit z.Salahuddin Rabbani mbi bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh. Afganistani ka qenë ndër të parat që ka njohur Kosovën dhe mbështetur agjendën tonë të IO's. Ne do të emërojmë një Ambasador jo-rezident së shpejti në Kabul dhe do të eksplorojmë fushat e bashkëpunimit.



Abu Dhabi, 2 mars 2019 – Gjatë takimit me Ministrin e Jashtëm të Afganistanit, z.Salahuddin Rabbani.



VAZHDON LOBIMI INTENZIV NË OBI, TAKIME ME MINISTRAT E JASHTËM TË MALDIVEVE, OMANIT, GABONIT DHE SIERRA LEONE-S

ABU DHABI, 2 MARS 2019

Gjatë qëndrimit në Abu – Dhabi kemi vazhduar me agjendën e ngjeshur dhe lobimin intenziv nëpërmjet takimit të dhjetëra homologëve të tij, që po marrin pjesë dhe përfaqësojnë vendet e tyre në sesionin e 46-të të Këshillit të Ministrave të Jashtëm të OBI-it, dhe e cila po i zhvillon punimet në kryeqytetin e Emirateve të Bashkuara Arabe, Abu Dhabi. Kemi vazhduar takimet bilaterale me ministrin e Jashtëm të Maldiveve, Abdullah Shahid, atë të Omanit, Yusuf bin Alawi bin Abdullah, Gabonit, Kambogo Abdu Razzaq Guy dhe Sierra Leone-s, Dr. Alie Kabba kanë qënë aktivitetet e tjera të pasditës së sotme në margjina të punimeve të ditës së dytë të sesionit të 46-të të Këshillit të Ministrave të Jashtëm të OBI-it. Në të gjitha këto takime, kam falënderuar shefat e diplomacive të këtyre shteteve për mbështetjen, që i kanë dhënë vendit tonë në proceset e shtet-ndërtimit, kemi shkëmbyer pikëpamjet për shikimin e mundësive të thellimit dhe zgjerimit të mëtejme të bashkëpunimit me shtetet njohëse, përderisa kemi kërkuar përkrahje për agjendën multilaterale të Kosovës, shpreshtim të kontakteve të drejtpërdrejta dhe ndërtim të partneriteteve të reja edhe me shtetet jo-njohëse.



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË UGANDËS DHE ISH-PRESIDENTI I UNGA-S SAM KUTESA

ABU DHABI, 2 MARS 2019

Gjithmonë kënaqësi për të biseduar me Ministrin e Jashtëm të Ugandës dhe ish-Presidentin e UNGA-s Sam Kutesa për marrëdhëniet midis Kosovës dhe Ugandës dhe potencialit për të vendosur lidhje të ngushta dhe dinamike në shumë sfera me interes të ndërsjellë.



Abu Dhabi, 2 mars 2019 – Gjatë takimit me Ministrin e Ministrin e Jashtëm të Ugandës



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË MALDIVEVE, Z.ABDULLAH SHAHID

ABU DHABI, 2 MARS 2019

Takim i shkëlqyeshëm me Ministrin e Jashtëm të Maldiveve Z.Abdullah Shahid për marrëdhëniet e shkëlqyera që gëzojnë Kosova dhe Maldivet. Ne festojmë 10 vjetorin e njohjes së Kosovës nga Maldivet dhe do të ndërmarrim aktivitete për të festuar këtë miqësi.





TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË OMANIT, Z.YUSUF BIN ALAWI BIN ABDULLAH

ABU DHABI, 2 MARS 2019

E shkëlqyeshme gjithmonë për të biseduar me Ministrin e Jashtëm të Omanit, Z.Yusuf bin Alawi bin Abdullah për bashkëpunimin e Kosovës me Omanin dhe potencialin që ne duhet të zgjerojmë në ekonomi, tregti dhe turizëm. Mirënjohës Omanit për mbështetjen që i është dhënë agjendës shumëpalëshe të Kosovës.





TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË BANGLADESHIT Z. ABDUL MOMEN

ABU DHABI, 2 MARS 2019

I Kënaqur të shoh Ministrin e Jashtëm të Bangladeshit z.Abdul Momen dhe të flasë për marrëdhëniet e shkëlqyera që gëzojnë vendet tona. Hapja e Ambasadës së Kosovës në Dhaka është një gur i ri në partneritetin tonë dhe ne presim bashkëpunim konkret në shumë fusha. E ftova të vizitojë Kosovën.



Abu Dhabi, 2 mars 2019 – Gjatë takimit me Ministrin e Jashtëm të Bangladeshit z.Abdul Momen



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË GABONIT, Z.KAMBOGO ABDU RAZZAQ GUY

ABU DHABI, 2 MARS 2019

Shkëmbim i shkëlqyeshëm me Ministrin e Jashtëm të Gabonit z.Kambogo Abdu Razzaq Guy. Kosova & Gaboni do të intensifikojnë shkëmbimin politik dhe do të ndërmarrin hapa për të rritur marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare. Së shpejti do të zhvillojmë raundin e parë të konsultimeve politike.





DEKLARATË

ABU DHABI, 2 MARS 2019

Ministri i Jashtëm Pacolli: Mirënjohës OBI-it dhe shteteve anëtare për aprovimin e Rezolutës, që bën thirrje për njohje të Kosovës, presim njohje edhe nga 19 shtetet tjera anëtare

E kam mirëpritur dhe përshëndetur aprovimin me unanimitet të plotë të Rezolutës për Kosovën nga 57 shtetet anëtare të Organiztës për Bashkëpunim Islamik – OBI-it, në sesionin e 46-të të Këshillit të Ministrave të Jashtëm, në kryeqytetin e Emirateve të Bashkuara Arabe, Abu Dhabi. Mirënjohës OBI-it dhe shteteve anëtare për miratimin me unanimitet të Rezolutës, duke thirrur mbi shtetet e saj anëtare, që ta njohin Kosovën dhe mbështesin anëtarësimin e saj në Organizata Ndërkombëtare. Kosova do të vazhdojë angazhimin e saj me OBI-in dhe do të rris edhe më tej lidhjet, pas aprovimit të kësaj Rezolute.

Tashmë 38 shtete anëtare të OBI-it e njohin Republikën e Kosovës. Ne, presim që edhe 19 shtetet anëtare të kësaj Organizate, të cilat ende nuk e kanë marrë këtë vendim ta bëjnë këtë së shpejti. Rezoluta bën thirrje pikërisht për këtë dhe presim lëvizje të reja në këtë drejtim. Gjatë pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të Kosovës në sesionin e 46-të të Këshillit të Ministrave të Jashtëm, në Abu Dhabi, kam takuar shumicën e homologëve të tij nga 57 shtetet anëtare, që morën pjesë në këtë takim dhe që vijnë nga katër kontinente të ndryshme të botës.



**Draft Resolution No. 20/46-POL
On The Situation in Kosovo**

The Forty- Sixth Session of the Council of Foreign Ministers, (Session: 50 Years Of Islamic Cooperation: Roadmap For Prosperity And Development), held in Abu Dhabi, United Arab Emirates 24-25 Jumadah Al-Thani 1440 H (1-2 March 2019),

Guided by the purposes and principles of the Charter of the United Nations, the Charter of the Organization of the Islamic Cooperation, the Universal Declaration of Human Rights, the International Covenants on Human Rights, the Geneva Conventions of August 1949 and 1951 as well as other instruments of international law,

Upholding the role of the United Nations in the peaceful settlement of disputes and maintenance of international peace and security,

Referring to the UN Security Council Resolutions 1160 (1998), 1999 (1998), 1203 (1998), 1239 (1999) and 1245 (1999), and the relevant statements of its President and the Secretary-General of the United Nations,

Recalling the International Court of Justice Advisory Opinion of 22 July 2010 on the “Accordance with international law of the unilateral declaration of independence in respect of Kosovo”,

Recalling also the UN General Assembly Resolution 64/298,

Recalling further the Resolution No. 16/31 adopted at the thirty-first Session of the Islamic Conference of Foreign Ministers held in Istanbul on 14-16 June 2004, the Resolution No. 36/34 of the 34th Session of the CFM, Islamabad, 15-17 May 2007, the Resolution No. 14/36 of the 36th Session of the CFM, Damascus, 23-25 May 2009, the Resolution No.17/38 of 38th Session of the CFM, Astana, 27-30 June 2011, the Final Communiqué of the 11th OIC Summit, Dakar, 13-14 March 2008, the Declaration of the OIC Ministerial Meeting in Kampala in June 2008 and in New York in September 2008; the Final Communiqué of the Coordination Meeting of the Foreign Ministers of the OIC Member States in New York in September 2009, 2010, 2011, 2012 and 2013, the Final Communiqué of the Cairo Summit 2013, Resolution No. 16/40 POL of the 40th Session of CFM, Conakry, Republic of Guinea, from 9-11 December 2013, the Resolution No. 18/41-POL of the 41st CFM, Jeddah, the Kingdom of Saudi Arabia from 18-19 June 2014, the Resolution No. 18/42-POL of the 42nd Session of the CFM, Kuwait, State of Kuwait from 27-28 May 2015, and the Final Communiqué of the Istanbul (Republic of Turkey) Summit, 14-15 April 2016, the Resolution No. 18/43-POL of the 43rd Session of the CFM, Tashkent, Republic of Uzbekistan from 18-19 October 2016, and the Resolution No.18/44-POL of the 44th Session of the CFM, Abidjan, Republic of Cote d’Ivoire, from 10-11 July 2017, and the Resolution No.18/45-POL of the 45th Session of the Council of Foreign Ministers held in Dhaka, People’s Republic of Bangladesh, from 5-6 May 2018.

Noting the Declaration of Independence by the Assembly of Kosovo of 17 February 2008,

Considering the fact, that Kosovo has been recognized by 116 states, including 38 OIC Member States,



Reaffirming the continued interest of the OIC toward the people of Kosovo and the peace and stability in the whole Balkan region,

- 1- **Takes note** on the implementation of Human Rights with highest standards guaranteed by the constitutional framework, under the direct supervision of Kosovo institutions, democratic participation of civil society and relevant stakeholders;
- 2- **Reaffirms** the highest standards enshrined in the Constitution of Kosovo and democratic law framework;
- 3- **Takes note** of the progress made towards the strengthening of democracy in Kosovo and the institutional work at all relevant levels, serving peace and stability in the country and the entire region;
- 4- **Acknowledges** the Advisory Opinion of the International Court of Justice on Kosovo's Declaration of Independence, delivered on 22 July 2010, in which the Court rendered that Kosovo's Declaration of Independence violated neither general international law, Security Council Resolution 1245 (1999), nor the Provisional Constitutional Framework of Kosovo, adopted by UNMIK;
- 5- **Welcomes** the commitment by all stakeholders, (local and international authorities), to further strengthening democracy, rule of law and the institutional work at all relevant levels throughout the entire territory of Kosovo, serving peace and stability in the country and the entire region throughout Kosovo;
- 6- **Welcomes** the continued support provided by the Organization of Islamic Cooperation to Kosovo.
- 7- **Also welcomes** the continuing efforts of the European Union to advance the European perspective of Kosovo and the whole of the Western Balkans, making thus a decisive contribution to the stability and prosperity of the region;
- 8- **Welcomes** Kosovo's membership into International and Intergovernmental Organizations and Regional Initiatives, accordingly encouraging further membership as an equal member into International Organizations, conventions and associations;
- 9- **Supports** the process of dialogue between Kosovo and Serbia with the European Union facilitation on technical issues as requested by the UNGA resolution 64/298 and welcomes the historic agreement reached on 19 April 2013 in Brussels between Kosovo and Serbia with the facilitation of the European Union, which paved the way for the normalization of their relations, and calls upon the parties to fully implement the agreement;
- 10- **Calls** upon the Member States of the Organization of the Islamic Cooperation to consider recognizing of Kosovo based on their free and sovereign rights as well as on their national practice;
- 11- **Welcomes** the cooperation of Kosovo with the OIC economic and financial institutions, and calls on the international community, including the willing of the OIC Member States, to continue contributing to the fostering of the Kosovo's economy;
- 12- **Requests** the Secretary-General, to submit to the 47th Session of the OIC Council of Foreign Ministers a follow-up report on the progress of the present Resolution.



DEKLARATË

PRISHTINË, 3 MARS 2019

Ministri i Jashtëm Pacolli: Kosova dhe Kolumbia kanë vendosur marrëdhënie diplomatike, do të shkëmbehen Ambasadorët

Sot kam mirëpritur një letër të pranuar nga homologu im nga Republika e Kolumbias, Carlos Holmes Trujillo García, nëpërmjet së cilës jam njoftohet mbi Dekretin për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike në mes dy shteteve, veprim ky, që mundëson komunikimin e përhershëm të nivelit më të lartë në mes dy vendeve me shkëmbimin edhe të Ambasadorëve.

Kjo letër pason pas një takimi, që kam zhvilluar me ministrin e jashtëm të Kolumbias, Carlos Holmes Trujillo García, në pjesën e parë të muajit shkurt në Uashington D.C.

Pas takimit me ministrin e jashtëm të Kolumbisë, Carlos Holmes Trujillo García, muajin e kaluar, Kosova dhe Kolumbia kanë vendosur marrëdhënie diplomatike nëpërmjet shkëmbimit të Ambasadorëve. Kosova do të hapë Ambasadën e saj me qëndrim në Bogota dhe Kolumbia do të emërojë Ambasador jo-rezident nga Italia.

Nëpërmjet hapjes së Ambasadës rezidente në Bogota, Republika e Kosovës synon mbulimin dhe përfaqësimin jo-rezident diplomatik edhe në shtete të tjera në atë kontinent.



Prishtinë, 3 mars 2019 – Takim me homologun nga Republika e Kolumbias, Carlos Holmes Trujillo García



TAKIM ME MINISTRIN E PUNËVE TË JASHTME DHE PROMOVIMIT TË TREGTISË TË MALTËS, CARMELO ABELA.

PRISHTINË, 6 MARS 2019

Republika e Maltës vazhdon të qëndrojë përkrah Kosovës në rrugëtimin tonë evropian, duke qenë ndër shtetet më mbështetëse në BE, si për liberalizim të vizave ashtu edhe për integrimin e Kosovës në BE. Malta ka qenë dhe vazhdon të jetë e zëshme në mbështetje të Kosovës në çdo organizatë ndërkombëtare dhe është zëri ynë edhe aty, ku ne nuk mund të jemi ende. Dy vendet tona gëzojnë një partneritet të qëndrueshëm dhe një miqësi të fortë.

Jam i lumtur, që shkëmbyem Notën zyrtare, për të vazhduar Kornizën e Bashkëpunimit në mes të dy MPJ-ve edhe për dy vite të tjera, për të thelluar më tej marrëdhëniet tona përmes konsultimeve politike, shkëmbimit të ekspertizave në integrimin evropian; përmes iniciativave kulturore, që dy popujt tanë ta njohin më mirë njëri tjetrin; trajnimin e diplomatëve të rinj; aktivitete në promovim të investimeve të tregtisë etj. Jam shumë i lumtur, gjithashtu, që e finalizuam edhe Marrëveshjen dypalëshe për Eliminimin e Taksave të Dyfishta. Kjo Marrëveshje do të ndihmojë drejtpërdrejt në hapjen e rrugëve për shkëmbimet tregtare midis Kosovës dhe Maltës.



Prishtinë, 6 mars 2019 – Takim me homologun tim nga Malta, Carmelo Abela



Prishtinë, 6 mars 2019 – Takim me homologun tim nga Malta, Carmelo Abela



TAKIM ME AMBASADORËN JO-REZIDENTE TË PANAMASË NË VENDIN TONË, ANABELLA GUARDIA DE RUBINOFF

PRISHTINË, 7 MARS 2019

Ambasadorën jo-rezidente të Panamasë në vendin tonë, Anabella Guardia de Rubinoff, e informova për të gjitha proceset e rëndësishme, që po kalon vendi si në nivel vendor ashtu edhe atë ndërkombëtar. Kosova dhe Panamaja kanë arritur, që të ndërtojnë marrëdhënie të shkëlqyeshme. Në vazhdim, diskutuam edhe mbi situatën në Venezuelë. E ritheksova qëndrimin tonë të palëkundur se Kosova ka njohur, z. Guaido, dhe legjitimitetin e tij si të vetmin përfaqësues të qytetarëve në Venezuelë në përputhje me qëndrimet e aleatëve tanë dhe atyre të Lima Group. Vlerësuam bashkërisht se dy shtetet tona kanë potencial të thellimit të raporteve bilaterale në shumë fusha të interesit të përbashkët.



Prishtinë, 7 mars 2019 – Gjatë takimit me Ambasadorën jo-rezidente të Panamasë në vendin tonë, Anabella Guardia de Rubinoff.



TAKIM ME AMBASADORIN E BELGJIKËS NË KOSOVË, FRANCOIS BONTEMPS

PRISHTINË, 8 MARS 2019

Së bashku me Ambasadorin e Belgjikës në Kosovë, Francois Bontemps, ne kemi nënshkruar instrumentet e ratifikimit të marrëveshjes për sigurimet shoqërore nga dy vendet tona. Me këtë kemi forcuar kornizën ligjore dhe siguroam të drejtën e qytetarit tonë në 2 vende.





Prishtinë, 8 mars 2019 – Gjatë takimit me Ambasadorin e Belgjikës në Kosovë, Francois Bontemps



PRANIMI I KOPJEVE TË LETRAVE KREDENCIALE NGA AMBASADORI I KATARIT

PRISHTINË, 11 MARS 2019

Me këtë rast, e kemi falënderuar Ambasadorin, Ali Al Marri për marrëdhëniet e shkëlqyeshme në mes të dyja vendeve dhe kemi vlerësuar ndihmën e vazhdueshme, që shteti i Katarit ka dhënë dhe vazhdon të jap për Republikën e Kosovës. Tutje, e kam njoftuar Ambasadorin Al Marri për planet e Republikës së Kosovës, që ta funksionalizojë Ambasadën në Doha brenda këtij viti. Në fund, përmes Ambasadorit, Al Marri, i percolla edhe ftesën për Zëvendëskryeministrin dhe Ministrin e Punëve të Jashtme të shtetit të Katarit, Shkëlqesinë e Tij, Mohammed bin Abdulrahman bin Jassim Al Thani, që ta vizitojë Kosovën në muajt në vijim.





TAKIM ME KOMANDANTIN E KFOR-IT, GJENERAL MAJOR LORENZO D'ADDARIO

HAJVALI, 11 MARS 2019

Kënaqësi të mirëpres për një drekë pune në Rezidencën time Komandantin e KFOR-it, Gjeneral Major Lorenzo D'Addario, i shoqëruar nga Nënkolonel Andrea Fiorentini, me të cilët biseduam për situatën në vend dhe për kontributin e KFOR-it, për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Gjeneral Majori D'Addario, më njoftoi për objektivat e KFOR-it, si dhe më siguroi që KFOR-i do të vazhdojë të mbetet partner serioz për institucionet e Republikës së Kosovës në përgjithësi.



Hajvali - Rezidenca, 11 mars 2019 – Takimi me Komandantin e KFOR-it, Gjeneral Major Lorenzo D'Addario



Hajvali - Rezidenca, 11 mars 2019 – Takimi me Komandantin e KFOR-it, Gjeneral Major Lorenzo D'Addario



TAKIM ME DELEGACIONIN E BIZNESEVE AMERIKANE

PRISHTINË, 12 MARS 2019

Takim me një delegacion të bizneseve amerikane, të cilat kanë shprehur interesim për eksplorimin e ekosistemit të Teknologjisë Informative dhe të Inovacionit në Kosovë, duke mos përjashtuar mundësitë tjera të investimeve dhe bashkëpunimit ekonomik. Biseduam për një sërë temash, ku ua shpjegova potencialin që Kosova ka për zhvillim dhe hapësirën që u ofrohet bizneseve të huaja për investime, si dhe folëm për sistemin e taksave që është shumë i avancuar. Ndër të tjera, e potencova faktin që Kosova vazhdon të mbetet një nga vendet në të cilin bizneset ruse dhe kineze nuk kanë arritur të hyjnë, e kjo i jep avantazh qysh në start bizneseve Perëndimore. Poashtu, u fokusuam tek potenciali njerëzor që Kosova ofron, me një rini të shkolluar dhe të gatshme për tregun e punës, gjë për të cilën delegacioni i bizneseve amerikane e vlerësoi si një element kyq për këdo që dëshiron të investojë në Kosovë.



Prishtinë, 12 mars 2019 - Takim me delegacionin e bizneseve amerikane



Prishtinë, 12 mars 2019 – Gjatë takimit me delegacionin e bizneseve amerikane



DEKLARATË

PRISHTINË, 13 MARS 2019

Kosova anëtarësohet në Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës dhe Resurseve Natyrore (IUCN), fuqizon edhe më tutje subjektivitetin ndërkombëtar

Republika e Kosovës është anëtarësuar si shtet anëtar në Unionin Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës dhe Resurseve Natyrore (IUCN), selia e së cilës ndodhet në Gland të Konfederatës Zvicerane. Procesi i anëtarësimit në këtë organizatë është udhëhequr nga Ministria e Punëve të Jashtme në bashkërendim dhe koordinim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Me këtë anëtarësim, Kosova fuqizon edhe më tutje subjektivitetin e saj ndërkombëtar, ndërsa përfitimet për vendin do të jetë të shumëanshme në çështjet që ndërlidhen me veprimtarinë dhe mandatin e organizatës.

IUCN është organizata e vetme për mbrojtjen e mjedisit, duke siguruar kështu, që çështja e ruajtjes së natyrës të ketë zërin e saj në nivelet më të larta të qeverisjes ndërkombëtare.





DEKLARATË

PRISHTINË, 13 MARS 2019

Mirëpres deklaratën e Ministrit të Jashtëm Spanjoll. Kosova dhe Spanja kanë më shumë histori të bashkëpunimit. Spanja ka qenë mbështetëse e madhe e çlirimit të Kosovës dhe qëndrimi i qeverisë së re në Madrid është në vijë me atë që Kosova ka qenë "Sui Generis". Kosova ka shpallur pavarësinë në vijë me të drejtën ndërkombëtare dhe vullnetin e popullit të Kosovës për pavarësi. Arritja e një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë që qon në njohje të ndërsjellë, do të sjellë edhe pranimin nga 5 vendet e BE-së dhe hapjen e perspektivës së qartë për anëtarësimin në NATO dhe BE. Besoj fuqishëm se edhe qëndrimi spanjoll do të shkojë në këtë drejtim.





TAKIM ME DELEGACIONIN SHTETËROR TË BRITANISË SË MADHE

PRISHTINË, 13 MARS 2019

Në Takim me delegacionin shtetëror dhe z. Richard Moore, Drejtor Politik i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Britanisë, ka potencuar se Republika e Kosovës ka menaxhuar me sukses debatin e brendshëm për dialogun, duke e kthyer këtë debat në funksion të përpilimit të platformës kombëtare; Në frymë të njejtë është vepruar edhe me krijimin e Ekipit të Dialogut, si dhe me aprovimin e ligjit për këtë proces. Pra, Kosova ka aplikuar një qasje institucionale, transparente, gjithpërfshirëse dhe demokratike. Kurse potencova se në anën tjetër, Serbia ka bërë të kundërten: Në vend se ta shfrytëzoj dialogun për krijimin e një klime pozitive dhe të mirëbesimit, ajo ka bërë të kundërten, duke vendosur parakushte e kushte për tu ulur në tavolinë; Serbia me kushtëzime dëshiron ta sjellë Kosovën në pozicione të pa barabarta negociuese; Në esencë, si secili dialog, edhe ky dialog, duhet të jetë i pakushtëzuar, nëse do të bëhej fjalë për krijimin e një klime mirëbesimi, Serbia e ka mundësinë ta bëjë këtë në raport me dialogun, duke ndaluar fushatën që ajo e quan fushata e çnohjeve; Ta bëjë këtë duke ndaluar fushatën e anti-antarësimit në organizata ndërkombëtare të Kosovës, të ndaloj veprimet kundër subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës; Kosova i ka 1001 arsye të mos i besoj Serbisë, se ulja e saj në tavolinë është në funksion të arritjes së marrëveshjes, dhe përkundër kësaj, ne kemi shfaqur guximin të ulemi të dialogojmë. Kjo sepse ne i besojmë SHBA-ve, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, i besojmë vendeve të Bashkimit Evropian.



Prishtinë, 13 mars 2019 – Gjatë takimit me delegacionin shtetëror të Britanisë së Madhe



Prishtinë, 13 mars 2019 – Gjatë takimit me delegacionin shtetrorë të Britanisë së Madhe



NË JAVËT E FRANKOFONISË MPJ DHE AMBASADA E FRANCËS ORGANIZOJNË SHFAQJEN E FILMIT FRANCEZ “QUAI D’ORSAY”

PRISHTINË, 13 MARS 2019

Ministria e Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me ambasadën e Francës në Kosovës organizoi shfaqjen e filmit të njohur francez “Quai d’Orsay” me regji nga Bernard Tavernier. Pas shfaqjes së filmit e mori fjalën Ministri i Jashtëm, z. Behgjet Pacolli, i cili i uroi mirëseardhjen të gjithë të pranishmëve dhe shprehu edhe njëherë përkushtimin e Qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë së Jashtme për promovimin e Frankofonisë në Kosovë dhe vlerave të përbashkëta të vendeve anëtare, nga promovimi i paqes, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.





Prishtinë, 13 mars 2019 - Së bashku me Ish presidentin Fatmir Sejdiu, në kuadër të Javëve të Frankofonisë



Prishtinë, 13 mars 2019- *Takimi me Ambasadorët Frankofon në kuadër të Javëve të Frankofonisë*



I NDERUAR ME VIZITËN E DELEGACIONIT TË ETIOPISË NË KOSOVË

PRISHTINË, 19 MARS 2019

Kam pritur në takim miqësor Kryetarin e Shtëpisë së Përfaqësuesve të Popullit (Parlamentit) të Republikës Federale Demokratike të Etiopisë, SH.T.Z Tagesse Chaffo Dullo, i shoqëruar nga Deputeti, njëherësh Kryetari i Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme, Z. Tesfaye Daba Wakjira. Gjatë takimit diskutuam përrrethanat që dërguan tek shpallja e pavarësisë së Kosovës, dhe për nevojën që Etiopia ta njeh Republikën e Kosovës si shtet të pavarur dhe sovran, si dhe mundësitë që të dyja vendet kanë për bashkëpunim në të gjitha fushat. Kryeparlamentari Dullo u shpreh i impresionuar me zhvillimin e Kosovës në këtë periudhë kaq të shkurtër kohore, kurse Z. Wakjira premtoi se do ta marr Ministrin e Punëve të Jashtme të Etiopisë në interpelancë për të kuptuar arsyet pse Etiopia ka dështuar ta njoh pavarësinë e Republikës së Kosovës.





Prishtinë, 19 mars 2019- Takim me delegacionin nga Etiopia dhe z. Tagesse Chafo Dullo, Kryetar Parlamentit të Etiopisë



TAKIM ME AMBASADORIN E KUVAJTIT NË TIRANË SH.T.Z. FAYEZ MISHARI AL JASSIM

PRISHTINË, 20 MARS 2019

Takim me Ambasadorin e Kuvajtit në Tiranë Sh.T.Z. Fayez Mishari Al Jassim, Ambasadori na falënderoi për mikëpritjen dhe gjithashtu na ftoi për vizitë në Kuvajt. Ne i premtuam se do të gjejmë kohën dhe momentin e duhur për të vizituar Kuvajtin, gjithashtu biseduam rreth hapjes së Ambasadës së Kuvajtit në Prishtinë, në mënyrë që të rriten bashkëpunimet në mes dy vendeve.



Prishtinë, 20 mars 2019 - Takim me Ambasadorin e Kuvajtit në Tiranë Sh.T.Z. Fayez Mishari Al Jassim



Prishtinë, 20 mars 2019- *Takim me Ambasadorin e Kuvajtit në Tiranë, Sh.T.Z.Fayez Mishari Al Jassim*



VIZITA E HOMOLOGUT TË MALIT TË ZI z. SRDJAN DARMANOVIC NË PRISHTINË


PRISHTINË, 20 MARS 2019

Republika e Kosovës dhe Mali i Zi kanë arritur të ndërtojnë marrëdhënie të shkëlqyera si dy shtete fqinje, por ne do të vazhdojmë, që të avancojmë edhe më tutje këtë bashkëpunim ndër-shtetëror në të gjitha fushat e interesit të përbashkët në mes dy vendeve. Bashkëpunimi në fushën e integrimeve ka qenë njëra nga çështjet e diskutuara në kuadër të këtij takimi, për të cilën kemi nënshkruar edhe një Marrëveshje. Në vazhdim kam falënderuar homologun tim nga Mali i Zi, Darmanoviq, për mbështetjen e vazhdueshme që ky shtet i ka dhënë vendit tonë për anëtarësim në Organizatat Ndërkombëtare, për kontributin konkret, që ky shtet po e jep për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë përmes pjesëmarrjes në trupat e KFOR-it, ndërkohë që një vëmendje e posaçme i është dhënë edhe thellimit të mëtutjeshëm të bashkëpunimit në fushën e ekonomisë.





Rezidenca në Hajvali, Prishtinë, 20 mars 2019 - Darka me Ministrin e Jashtëm nga Mali i Zi, H.E. Srdjan Darmanovic.





Prishtinë, 21 mars 2019 – Me homologun nga Mali i Zi në ambientet e MPJ-së pas nënshkrimit të marrveshjes dy paleshe për zbatimin e MSA-së.



TAKIM ME AMBASADORIN E SHQIPËRISË NË KOSOVË, z.QEMAL MINXHOZI

PRISHTINË, 21 MARS 2019

Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, e kam emëruar Dekan të Korit Diplomatik në Republikën e Kosovës. z. Minxhozi shquhet për kontributin e tij në rritjen e bashkëpunimit mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, andaj ky emërim do të ndikojë edhe në rritjen e bashkëpunimit mes Misioneve Diplomatike të akredituara në Republikën e Kosovës dhe institucioneve shtetërore të Kosovës. Jam i bindur se Z. Minxhozi do ta ushtrojë këtë funksion me nder dhe përgjegjësi të lartë.





DEKLARATË

PRISHTINË, 29 MARS 2019

Konfederata Helvetike, së bashku me SHBA, Gjermaninë, Francën, Britaninë, Italinë dhe vendet tjera perëndimore, ka mbështetur, fuqishëm rrugëtimin e Republikës së Kosovës në të gjitha etapat.

Kontributi i Zvicrës, ku kemi një diasporë të madhe me afërsisht 300 mijë qytetarë tanë, është i madh në çlirimin, shtetëndërtimin dhe zhvillimin e Republikës së Kosovës.

Ambasadorit Jean – Hebert Lebet, i shpreha mirënjohjen e thellë të institucioneve dhe popullit të Kosovës, për kontributin e tij dhe shtetit që përfaqëson.

Miqtë dhe aleatët kanë dhënë dhe po japin kontribut të madh, për ardhmërinë e këtij vendi andaj të gjithë ne, duhet t'i dëgjojmë me shumë vëmendje këshillat dhe sugjerimet e tyre. Sa herë kemi qenë bashkë me aleatët, kemi dalë fitimtar.

Ne do të vazhdojmë bashkë dhe kemi cfarë të mësojmë nga një demokraci qindar vjeçare sikurse është Zvicra.





NË TAKIM ME PRESIDENTIN E GUINEA BISSAU, Z.JOSE MARIO VAZ

SENEGAL, 3 PRILL 2019

Në takimin bilateral që zhvillova me presidentin e Guinesë Bissau, z. Jose Mario Vaz, diskutuam për rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve tona. Presidentit Vaz i shpreha falenderimet e mëdha të popullit të Kosovës për mbështetjen e tyre në secilën fazë të avansimit të shtetit tonë. Republika e Kosovës është e përkushtuar që të vendos dhe thellojë marrëdhëniet diplomatike me çdo vend të botës andaj jam shumë i lumtur që në këtë drejtim jemi në rrugë të drejtë. Propagandat e hedhura nga ndonjë fqinj i Kosovës në kurriz të qëndrimit të shtetit të Guinesë Bissau, nuk ishin fare pjesë e diskutimit me presidentin Vaz, i cili pranoi me dëshirë ftesën për të vizituar Kosovë.



Senegal, 3 prill 2019- *Takim me Presidentin e Guinesë Bissau, z. Jose Mario Vaz.*



Senegal, 3 prill 2019- Takim me Presidentin e Guinesë Bissau, z. Jose Mario Vaz.



TAKIM ME PRESIDENTIN E GAMBISË Z.ADAMA BARROW

SENEGAL, 3 PRILL 2019

Një takim shumë të përzemërt pata edhe me presidentin e Gambisë z.Adama Barrow. Presidenti Barrow, konfirmoi mbështetjen e plotë për secilin hap ndërkombëtar të Kosovës. E drejta e vendit tonë është e pakontestueshme andaj edhe mbështetja e secilit shtet anëtar të OKB në këtë rrugë është e jashtëzakonshme dhe si asnjëherë më parë.





TAKIM ME PRESIDENTIN E RI TË REPUBLIKËS DEMOKRATIKE TË KONGOS Z.FELIX TSHISEKEDI

SENEGAL, 3 PRILL 2019

Gjatë qëndrimit në Senegal, shfrytëzova rastin që me presidentin e ri të Republikës Demokratike të Kongos z.Felix Tshisekedi, të bisedojmë për mundësinë e lidhjes së marëdhënieve diplomatike dhe bashkëpunimit dypalësh mes dy shteteve tona. Presidenti Tshisekedi i prezentova realitetin e Kosovës të argumentuar edhe me vendimin e GJND, -së se pavarësia e Kosovës ka qnë në përputhje të plotë me të drejtën ndërkombëtare, duke i kërkuar formalizimin e aktit të njohjes si respekt ndaj ligjeve dhe vullnetit të qytetarëve të Kosovës.





TAKIM ME PRESIDENTIN E BURKINA FASOS Z.ROCH MARC CHRISTIAN KABORE

SENEGAL, 3 PRILL 2019



Senegal, 3 prill 2019-Takim me Presidentin e Burkina Fasos z.Roch Marc Christian Kabore



TAKIM ME PRESIDENTIN E SENEGALIT Z.MACKY SALL

SENEGAL, 3 PRILL 2019

Gjatë qëndrimit në Senegal pata nderin që të përfaqësoj Republikën e Kosovës, në ceremoninë inauguruese të presidentit të këtij vendi të rëndësishëm. Kosova dhe Senegali kultivojnë marrëdhënie të shkëlqyera dypalëshe. Ne jemi i vetmi vend në rajon që kemi hapur ambasadën në këtë vend afrikan. E falënderoj ambasadorin Gahi për punën e shkëlqyer në interes të vendit.





TAKIM ME KRYEMINISTRIN E GABONIT Z.JULIEN NKOGHE BEKALE

SENEGAL, 3 PRILL 2019

Kryeministrin e Gabonit z.Julien Nkoghe Bekale e falenderova për mbështetjen që shteti i tij i ka dhënë Republikës së Kosovës që nga formalizimi i njohjes në vitin 2011. Takime jashtëzakonisht të frytshme në funksion të fuqizimit ndërkombëtar të vendit tonë.





TAKIM ME AMBASADORIN AMERIKAN NË SENEGAL TULINABO S. MUSHINGI

SENEGAL, 3 PRILL 2019

Aty ku prezent është SHBA patjetër që Kosova ndihet e sigurt. Ambasadori amerikan në Senegal Tulinabo S. Mushingi, një njeri i jashtëzakonshëm dhe me përkushtim jashtëzakonisht pozitiv në raport me Kosovën. Qytetarët e Kosovës, shteti ynë janë të bekuar që kanë në krah liderin më të fuqishëm të demokracisë botërore.





TAKIM ME PRESIDENTIN E NIGERISË, Z.MUHAMMADU BUHARI

SENEGAL, 3 PRILL 2019

Me presidentin e Nigerisë, z.Muhammadu Buhari vazhduam diskutimet për formalizimin e marrëdhënieve bilaterale mes dy shteteve tona. Nigeria si shtet i fuqishëm me rreth 200 milion banorë padyshim përbën interes të madh në aspektin e marrëdhënieve dypalëshe. Si vazhdimësi e bisedave të mëhershme në Abuja dhe Nju Jork, Presidenti Buhari u tregua optimist në formalizimin e shpejtë të procedurave.





TAKIM ME PRESIDENTIN E NIGERIT Z.MAHAMADOU ISSOUFOU

SENEGAL, 4 PRILL 2019

Në Senegal takova edhe Presidentin e Nigerit z.Mahamadou Issoufou, vend ky i cili përveq njohjes së Kosovës, mbështet vendin tone në secilën nismë ndërkombëtare.



Senegal, 4 prill 2019-Takim me Presidentin e Nigerit, z.Mahamadou Issoufou.



TAKIMI ME PRESIDENTIN E MADAGASKARIT, Z. ANDRY NIRINA RAJOELINA

SENEGAL, 4 PRILL 2019

Takimi me Presidentin e Madagaskarit, z. Andry Nirina Rajoelina, ishte jashtëzakonisht i frytshëm. Biseduam për thellimin e marrëdhënieve ndërshtetërore duke filluar nga akreditimi i ambasadorit jorezident të Republikës së Kosovës në këtë shtet afrikan. Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar që të ecë përpara në forcimin e partneritetit me të gjitha shtetet anëtare të OKB-së.



Senegal, 4 prill 2019-Takim me Presidentin e Madagaskarit, z. Andry Nirina Rajoelina.



NGA PJESËMARRJA NË FORUMIN EKONOMIK BOTËROR

JORDANI, 6 PRILL 2019

Me ftesë të mbretit Abdullahu II, pjesmarrës në Forumin Ekonomik Botëror në Jordani. Në këtë aktivitet të rëndësishëm ministri Pacolli ka zhvilluar takime të nivelit të lartë, në interes të avansimit të raporteve të Republikës së Kosovës me vende tjera.





Jordani, 6 prill 2019- *Forumi Ekonomik Botëror.*

TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË SLOVAKISË, MIROSLAV LAJČÁK

JORDANI, 6 PRILL 2019

Në Jordani, në margjinat e forumit Ekonomik botëror, zhvillova një takim me ministrin e jashtëm të Sllovakisë, Sh.T. Miroslav LAJČÁK. Përkundër faktit që Sllovakia ende nuk e ka njohur Republikën e Kosovës, bashkëpunimi ynë është jashtëzakonisht në rrugë të mbarë. Ne jemi të përkushtuar në ndërtimin e raporteve të mira me të gjitha vendet e BE-së, pjesë e së cilës familje synojmë që të bëhemi. Në frymën e bashkëpunimit, me ftesën time, LAJČÁK do të vizitojë Republikën e Kosovës në qershor të këtij viti. Gjithashtu edhe zyra jonë në Sllovakia do të hapet së shpejti.





TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË XHIBUTIT Z. MAHAMOUD ALI YOUSOUF

JORDANI, 6 PRILL 2019

Gjatë Forumit Ekonomik Botëror në Jordani, kam pasur një takim të shkëlqyer me Ministrin e Jashtëm të Xhibutit z. Mahamoud Ali Youssof. Në një brifing të shkurtër e informova Ministrin Ali Youssof për situatën në Kosovë dhe të arriturat e saj në shumë fusha. Ministri i Jashtëm i Xhibutit theksoi se votimi në Interpol ka qenë një gabim i madh që nuk është votu pro – Kosovës. Kosova dhe Xhibuti kanë një miqësi të ngushtë dhe Ministri i Jashtëm i tyre më siguroi për mbështetjen e tyre të vazhdueshem për Kosovën.





TAKIM ME MINISTRIN E JASHEM TË LETONISË Z.EDGARS RINKEVICS

JORDANI, 6 PRILL 2019

Letonia është një partner i fuqishëm i Kosovës në BE dhe NATO. Si dy vende të vogla ata i kuptojnë sfidat që Kosova i kalon. Letonia gjithmonë ka mbështetur fuqimisht liberalizimin e vizave për Kosovën dhe Edgar's më konfirmoi mbështetjen e tyre. Do të punojmë më shumë për zgjerimin e lidhjeve tregtare dhe ekonomike.





TAKIM ME ZV.KRYEMINISTRIN E LIBANIT GHASSAN HASBANI

JORDANI, 6 PRILL 2019

Kisha një takim të frytshëm me Zv.Kryeministrin e Libanit Ghassan Hasbani me të cilin diskutuam potencialin për të ndërtuar bashkëpunim ekonomik dhe tregtar si hap të parë në fillim të marrëdhënjëve tona bilaterale. Shpreha interesimin e shtetit të Kosovës për bashkëpunim dypalësh; Kërkuam hapjen e zyrës përfaqësuese si në modelin e Athinës ku do të mundësojmë bashkëpunimin tregtar mes dy shteteve tona. Kërkova të përsëritet kërkesa për njohje duke shpjeguar mosngjashmërinë e “rastit” të Kosovës me asnjë rast tjetër dhe me gjendjet e brendshme të vetë këtij vendi, gjithashtu njohje të dokumenteve të udhëtimit, si hap i parë dhe këmbimi i delegacioneve dhe bashkëpunimit në fusha si kultura, sporti, etj. Në fund të takimit kërkuam mbështetjen e shtetit mik të Libanit në forumet shumëpalëshe, sidomos në anëtarësim në organizata ndërkombëtare si rasti i INTERPOL dhe organizata tjera relevante ku përfitojnë gjithë qytetarët e Kosovës.





TAKIM ME ZËVENDËSKRYEMINISTRIN E JORDANISË, Z.RAJAI MUASHER

JORDANI, 6 PRILL 2019

Shumë i lumtur që takova homologun tim jordanez, Zëvendëskryeministrin e Jordanisë, z.Rajai Muasher, me të cilin biseduam për marëdhëniet e shkëlqyera që gëzojnë Kosova dhe Jordania. Jordania është një partner i fuqishëm i Kosovës dhe do të vazhdoj të mbështesë Kosovën në të gjitha nivelet. Ne do të fokusohemi më shumë në bashkëpunim ekonomik, tregtar dhe të sigurisë.





TAKIM ME ZV.PRESIDENTEN DHE MINISTREN E JASHTME TË PANAMASË ISABEL DE SAINT MALO DE ALVARADO

JORDANI, 6 PRILL 2019

Në margjina të Forumit Ekonomik botëror, zhvillova një takim të mrekullueshëm me Zv.Presidenten dhe Ministren e Jashtme të Panamasë Isabel de Saint Malo de Alvarado.

Panamaja është një mbështetës i fuqishëm i Kosovës ne Amerikën Latine dhe biseduam për të zgjeruar bashkëpunimin tonë dypalësh me fokus ekonominë dhe tregtinë. Së fundmi jemi në proces edhe të nënshkrimit të tri marrëveshjeve në fushën e sigurisë, të cilat kanë për qëllim përafrimin e mëtejme të vendeve tona, tani si partnerë në preventimin dhe luftën kundër kimit të organizuar, dhe fenomeneve tjera ndërkombëtare.





TAKIM DYPALËSH ME ZNJ.GILA DEMIRI GAMLIEL, MINISTREN E BARAZISE SOCIALE TË IZRAELIT

JORDANI, 6 PRILL 2019

Shumë i lumtur të takohem me palën Izraelite dhe të diskutojmë për mënyren e fuqizimit të marrëdhënieve të të dy shteteve, ne si shtet jemi shumë të interesuar për të promovuar ndryshime politike, ekonomike dhe kulturore mes dy vendeve. Biseduam gjithashtu rreth vizites së Kongresmenit Israelit në Kosovë, pastaj rreth vizitës nga viti i kaluar nga një ndër organizatat e Izraelit. Ne theksuam se Kosova është e pajtimit për të filluar një etapë të re me shtetin e Izraelit si në qasjen politike edhe atë ekonomike dhe shoqërore.





TAKIM DYPALËSH ME Z. AMR NASSAR, MINISTËR I TREGTISË DHE INDUSTRIË NË EGJIPT

JORDANI, 6 PRILL 2019

Jemi të kënaqur që Egjipti si vend lider i Afrikës e ka njohur pavarësinë e vendit tonë. Deri tani 13 nga 22 vende arabe, dhe 34 nga 57 shtete anëtare të Organizatës për Kooperim Islamik (OKI) e kanë njohur Kosovën. Ri-shprehëm dëshirën tone që sa më shpejtë të nënshkruajmë marrëveshjen e marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve tona për ti hapur rrugë bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes; Pas kësaj jemi të interesuar menjëherë të hapim ambasadën tonë në Kajro. Ndërkohë shprehim dëshirën që sa më parë të rihapim zyrën tonë përfaqësuese në Kajro, e cila do të facilitonte sidomos bashkëpunimin tregtar mes dy vendeve tona.





TAKIM ME MINISTRIN E PUNËVE TË JASHTME PALESTINEZ Z. RIAD AL-MALKI

JORDANI, 6 PRILL 2019

Kisha një takim fantastik me Ministrin al – Malki, fillimisht e falenderova për votën pozitive ndaj nesh në anëtarësimin në INTERPOL, duke theksuar se askush më mirë se ata nuk e njih rëndësinë e aplikimit dhe të qenurit anëtar i INTERPOL-it. Takimin e mbyllëm me shpresën se përkundër dallimeve, ato nuk do të shprehen në publik në mënyrë që të ruajmë frymën e respektit të ndersjellë.





Jordani, 6 prill 2019-Takim me Ministrin e Punëve të Jashtme Palestinez z. Riad al-Malki.



TAKIMI ME PRINCESHËN ALGJERIANE ZNJ. RYM AL-ALI

JORDANI, 6 PRILL 2019



Jordani, 6 prill 2019-Takimi me Princeshën Algjariane znj. Rym al-Ali.



TAKIM ME ZV.MINISTREN E SHTETIT TË RUMANISË ZNJ.MARIA MAGDALENA GRIGORE

JORDANI, 6 PRILL 2019

Ne e theksim se duam bashkëpunim më të ngushtë me Rumaninë gjithashtu e njoftuam Shtetin Rumun per numrin e madh të studentëve tanë në shtetin e tyre dhe sigurisht se presim bashkëpunime tjera. Shteti Rumun na njoftoi se do të jetë prezent në Procesin e SEECP-së dhe se do të përkrahi këtë process të rëndësishëm, njëkohësisht të ngriten bashkëpunime tjera mes nesh dhe ky bashkëpunim të filloj nga diku. Sigurisht se u diskutua edhe për fillimin e negociatave për hapjen e zyrës Ekonomike në Bukurresht.






TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË REPUBLIKËS SË TURQISË MEVLUT ÇAVUSOGLU

STAMBOLL, 7 PRILL 2019

Pas përfundimit të suksesshëm të vizitës në Jordani, në Stamboll u prita nga Ministri i Jashtëm i Republikës së Turqisë, Mevlut Çavusoglu. Raportet e Shkëlqyera ndërmjet dy shteteve tona, do të vazhdojnë edhe më tutje drejt avansimit. Turqia nëpërmjet ministrit të jashtëm fuqishëm rikonfirmon mbështetjen e gjithanshme për Kosovën.





Turqi, 7 prill 2019-Takim me Ministrin e Jashtëm të Republikës së Turqisë, Mevlut Çavusoglu.



DARKA E PUNËS SË MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME TË PROCESIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR

VARSHAVË, 11 PRILL 2019

Pjesëmarrës në darkën e punës së Ministrave të Punëve të Jashtme të Procesit të Ballkanit Perëndimor, në kuadër të takimeve në përgatitje të Samitit të Poznanit, që do të mbahet në korrik 2019. Në darkë u diskutua për gjendjen e të rinjëve në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në Bashkimin Evropian, sfidat më të cilat ballafaqohen dhe ndikimi që ata do duhet të kenë në Evropën e përbashkët. U fol edhe për rëndësinë që perspektiva evropiane të jetë gjithnjë e pranishme dhe të promovohet dhe mbështetet tutje sidomos tek të rinjtë, përndryshe premtimet, reformat, nismat e ndryshme rajonale vështirë se do të kenë sukses për të siguruar të rinjtë e rajonit se e ardhmja e tyre është evropiane.









TAKIM BILATERAL ME MINISTRIN E JASHTËM GJERMAN Z.HEIKO MASS

VARSHAVË, 11 PRILL 2019

Në Varshavë, zhvillova një takim bilateral me ministrin e jashtëm gjerman z.Heiko Mass, i cili tashmë konfirmoi se Gjermania me të gjithë mekanizmat e saj mbështet plotësisht liberalizimin e vizave për Kosovën. I inkurajuar jashtëzakonisht shumë me mbështetjen e madhe gjermane për vazhdimin e dialogut me Serbinë, rëndësin e këtyre bisedimeve dhe arritja e një marrveshje në mes dy shteteve në afat sa më të shkurtër. Njoftova ministrin Mass për platformën e dialogut e cila ditë më parë u miratua në Kuvendin e Kosovës, dhe për gatishmërinë e palës kosovare për rifillim të dialogut. I shpreha edhe shqetësimet për kampanjën agresive dhe shpifëse të Serbisë rreth njohjeve të shtetit të Kosovës.



Poloni/Varshavë, 12 prill 2019-Takim bilateral me Ministrin e Jashtëm Gjerman z.Heiko Mass.



Poloni/Varshavë, 12 prill 2019-Takim bilateral me Ministrin e Jashtëm Gjerman z.Heiko Mass.



SEANCA PLENARE E TAKIMIT TË MINISTRAVE TË JASHTËM NË KUADËR TË PROCESIT TË BERLINIT NË VARSHAVË

VARSHAVË, 12 PRILL 2019

Gjatë pjesëmarrjes, në takimin ministror, që po zhvillohet në kuadër të Procesit të Berlinit, në kryeqytetin polak Varshavë, theksova rëndësinë e përfshirjes së temës së rinisë në debat dhe sfidat e problemet me të cilat po përballet ajo në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Në vazhdim, potencova se është detyrë parësore e institucioneve të ofrojnë perspektivë për të rinjtë, t'u mundësojnë më shumë mirëqenie, kushte dhe mundësi për të nesërmen e tyre. Duke folur për bashkëpunimin rajonal, potencova se Kosova nuk ka çështje të hapura me disa vende të Ballkanit Perëndimor dhe përmendi së fundi edhe përfundimin e ratifikimit të Marrëveshjes për Demarkacionin me Malin e Zi. Tutje, kam potencuar se Kosova është e përkushtuar për zgjidhje paqësore dhe me marrëveshje të çështjeve edhe me Serbinë dhe e përkushtuar, gjithashtu, për dialog, që do të çonte drejt marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet dy vendeve.







Poloni, 12 prill 2019- Takimi i Ministrave të Jashtëm në kuadër të Procesit të Berlinit në Varshavë.



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË GREQISË, Z.GEORGIUS KATROUGALOS

VARSHAVË, 12 PRILL 2019

Në Varshavë pata një takim shume të përzemërt me Ministrin e Jashtëm të Greqisë, z.Georgius Katrougalos. Diskutuam për mundësitë e përafrimit të Dy vendeve tona në fusha të ndryshme. Ministri Katrougalos më ka siguruar se ai dhe Qeveria greke vlerësojnë progresin e arritur në Kosovë në përmbushjen e kriterëve për vizat dhe parimisht ka qëndrim pozitiv për Kosovën. Greqia kërkon nga Kosova dhe shtetet tjera të rajonit të jenë të vendosur dhe të përkushtuar drejt forcimit të marrëdhënieve rajonale dhe procesit të integritit të rajonit në BE.






DEKLARATË E SH.T.Z BEHGJET PACOLLI

PRISHTINË, 15 PRILL 2019

Hapja e Ambasadës Japoneze në Prishtinë, lajm i jashtëzakonshëm

Gjithmonë i lumtur kur pranoj letra që ri-theksojnë përkrahjen e fuqishme të vendeve nga katër anët e botës. Sot pranova urimet më të përzemërta nga znj. Toshiko Abe, Ministre Shtetërore e Punëve të Jashtme të Japonisë, ku theksohet rëndësia e shënimit të dhjetëvjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes Japonisë dhe Kosovës. Ministria Abe e afirmon tutje diskutimin që kemi pasur bashkë, për hapjen e Ambasadës Japoneze në Republikën e Kosovës vitin që vjen, duke ri-theksuar atë çfarë kemi diskutuar bashkë, që hapja e Ambasadës do të shënoj një momentum të rid he të fuqishëm në thellimin e marrëdhënieve, edhe ashtu të shkëlqyera mes dy vendve tona. Japonia ka qenë dhe mbetet përkrahëse e fuqishme në kontinentin aziatik, dhe ne do t'i jemi përjetësisht mirënjohës këtij vendi.








VIZITA E ZV. PRESIDENTIT TË KENYAS SH.T.Z WILLLIAM SAMOEI RUTO

PRISHTINË, 19 PRILL 2019

Kosova dhe Kenia kanë potencial për të thelluar bashkëpunimin e tyre në të gjitha fushat, bashkëpunim ky i cili fillon me njohjen e pavarësisë së Kosovës dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, për çka Zv.Presidenti Ruto premtoi se do të angazhohet personalisht për ta shtyer këtë process përpara. Zv.Presidenti Ruto u shpreh i mrekulluar me Kosovën, popullin dhe natyrën e saj, ai premtoi se do të rikthehet në vizitë së shpejti. Gajtë kësaj vizite në Kosovë, Zv.Presidenti Ruto u prit në takime të ndara nga Presidenti Thaçi dhe Kryeministri Haradinaj.







Prishtinë, 19 prill 2019 -Takimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj me Zv.Presidentin e Kenyas, Willlliam Ruto.



RAPORTIMI NË KOMISIONIN PARLAMENTAR PËR INTEGRIME EVROPIANE

PRISHTINË, 23 PRILL 2019

Raportimin tim para komisionit e fillova me veprimet e ndërmarra nga Ministria e Punëve të Jashtme për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit-MSA-së, në mes të Kosovës dhe BE-së. Deputetët i njoftova se Ministria e Punëve të Jashtme po ashtu është duke i përmbushur obligimet rreth tri Masave tjera zbatuese:

Strategjia për Punë të Jashtme- që është hartuar nga MPJ dhe është përcjellë në qeveri për miratim;

Plani i Veprimit për Zhvillimin sa më efikas të Dialogut Politik në mes të RKS dhe BE- është miratuar dhe jemi në zbatim e sipër;

Numri i vizave të lëshuara shtetasve të vendeve të treta nga ana e Konsullatave dhe përfaqësive diplomatike të Republikës së Kosovës- raportohen rregullisht për çdo tre muaj në detaje;

Po ashtu ndër detyrat e rëndësishme që Ministria e Jashtme bartë në zbatimin e MSA-së ka të bëjë me **Këshillin e Stabilizim Asociimit, KSA**, që është struktura e nivelit politik që vendos dhe rekomandon për çështje që dalin në kuadër të zbatimit të MSA-së dhe në çështjet me interes të përbashkët për palët. Në pjesën e dytë, fokusi im ishte në veprimet e ndërmarra nga Ministria e Punëve të Jashtme lidhur me procesin e integritit evropian në përgjithësi. I njoftova deputetët se ndër prioritetet kryesore të politikës së jashtme të Kosovës mbetet avancimi i partneritetit strategjik me Bashkimin Evropian dhe NATO-n. Pjesë e madhe e agjendës së Brukselit përfshinë edhe marrëdhëniet e mira me vendet fqinje.

Raportimin tim e përfundova duke iu falënderuar për mbështetjen dhe shpresoj në mirëkuptimin dhe ndihmën e tyre në këtë rrugëtimin tonë të veshtirë të integritit evropian, por jo edhe të përealizueshëm.



Prishtinë, 23 prill 2019 – Gjatë raportimit para Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian



TAKIM ME ZV.MINISTRIN E PUNËVE TË JASHTME TË TURQISË, z. FARUK KAYMAKÇI

PRISHTINË, 23 PRILL 2019

Me Zëvendësministrin e Punëve të Jashtme të Republikës së Turqisë, Ambasadorin Faruk Kaymacki, diskutuam për marrëdhëniet e shkëlqyera të cilat dy vendet tona i gëzojnë, si dhe për ndihmën e Turqisë në proceset e integritit të Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Mora premtim nga Zëvendësministri Kaymaçki se Turqia do të vazhdojë të ndihmojë Kosovën në të gjitha proceset nëpër të cilat ne si shtet po kalojmë. Zëvendësministrin Kaymaçki e njoftova se pala kosovare është në përmbyllje të procedurave për funksionalizimin e Marrëveshjes për Tregti të Lirë me Turqinë, e cila do të jetë e dobishme për të dyja palët.



Prishtinë, 23 prill 2019-Takim me Zv.Ministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë z. Faruk Kaymakçi.



TAKIMI I NIVELIT TË LARTË PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

BERLIN, 29 PRILL 2019

Në Berlin me Presidentin Thaçi dhe Kryeministrin Haradinaj ishim pjesë në Takimin e Nivelit të Lartë për Ballkanin Perëndimor me ftesë të Kancelares gjermane Merkel dhe presidentit francez Macron, për të diskutuar zhillimet aktuale në rajon dhe perspektivën evropiane të të gjitha vendeve. Kosova mbetet e përkushtuar fuqishëm për bashkëpunim rajonal dhe normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë si dy shtete të pavarura dhe sovrane. Ka ardhur koha që Serbia të pranojë realitetin dhe të shohë të ardhmen me Kosovën si dy fqinjë të barabartë. Një qështje e rëndësishme për delegacionin tonë është liberalizimi i vizave i vizave për qytetarët tanë. Jemi të vendosur për këtë kërkesë, pasi është mënyra e vetme për t'i treguar popullit të Kosovës se e ardhmja evropiane është e prekshme.







TAKIM ME MINISTRIN E BRENDSHËM TË GJERMANISË HORST SEEHOFER

BERLIN, 30 PRILL 2019

Së bashku me kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, kishim një takim shumë konstruktiv me ministrin e brendshëm të Gjermanisë, Horst Seehofer. Pos tjerash u diskutua edhe për liberalizimin e vizave. U dakorduam që të formohen grupet punuese në mënyrë që liberalizimi i vizave të implementohet sa më parë! Faleminderit Gjermani!





TAKIMI I PARISIT, I MUAJIT QERSHOR TË KËTIJ VITI

BERLIN, 30 PRILL 2019



bundeskanzlerin
Bundeskanzleramt (Berlin)



Berlin, 30 Prill 2019 - Takimi i Parisit, i muajit qershor të këtij viti, si rrjedhojë e takimit të Berlinit do të sqarojë shumëçka në dobi të paqes në Ballkan.



VIZITA E AMBASADORIT TË SHTETIT TË KATARIT NË SHQIPËRI, JOREZIDENT PËR KOSOVË, ALI BIN HAMAD AL MARRI

PRISHTINË, 2 MAJ 2019

Pata kënaqësinë të mirëpres në zyrën time për një takim pune Ambasadorin e Shtetit të Katarit në Shqipëri, jorezident për Kosovë, Shkëlqesinë e Tij, Ali Bin Hamad Al Marri, me të cilin diskutuam për marrëdhëniet e shkëlqyeshme mes të dyja vendeve tona. E informova Ambasadorin Al Marri për procesin e hapjes së Ambasadës së Republikës së Kosovës në Doha, e cila në vetvete është mesazh që ne i çmojmë jashtëzakonisht shumë marrëdhëniet me Shtetin e Katarit. Ambasadorin Al Marri e njoftova për planin që kam për të vizituar zyrtarisht Katarin në muajin shtator, me ç'rast edhe do të inaugurojmë Ambasadën tonë atje, si dhe do të zhvilloj takime të nivelit të lartë me qëllim ngritjen e bashkëpunimit dy-palësh në të gjitha fushat.





TAKIM KOORDINUES PËR HAPAT E MËTUTJESHËM PAS TAKIMIT TË BERLINIT

PRISHTINË, 2 MAJ 2019





KOMISIONI PARLAMENTAR PËR MARRËDHËNIE TË JASHTME DIASPORË DHE INVESTIME STRATEGJIKE

PRISHTINË, 02 MAJ 2019

Para deputetëve të Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, jam shprehur i sigurt se liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës do të ndodhë brenda këtij viti. Kurse, për pretendimet mbi tërheqjet e njohjeve, sigurova deputetët se shumë shpejt do të arrijnë njohje të reja për Kosovën. Ua kam bërë të ditur se këto ditë pritet njohja nga dy shtete, dhe se nga njëri shtet është marrë konfirmimi, të cilët tashmë kanë nisur procedurat për njohjen e Kosovës. Gjatë raportimit i kam njoftuar po ashtu se Kosova do aplikojë për anëtarësim në Këshillin e Evropës, ndërsa, lidhur me ecurinë e anëtarësimit në INTERPOL, do ti njoftojë në një mbledhje të mbyllur të komisionit. Raportimi im lidhet me angazhimet diplomatike të Ministrisë për Punë të Jashtme gjatë katër mujorit të këtij viti, përfshirë këtu edhe Samitin e Berlinit, mbajtur ditë më parë. Në mënyrë kronologjike i njoftova për marrëdhëniet dypalëshe të vendit tonë, procesin e njohjeve, diplomacinë ekonomike, marrëdhëniet rajonale, raportet me BE-në, organizatat ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrjen e Kosovës në luftën globale kundër terrorizmit. Gjithashtu u jam përgjigjur pyetjeve dhe shqetësimeve që ngritën anëtarët e komisionit.



Prishtinë, 4 Maj 2019 - Takimi me Komisionin parlamentar për Punë të Jashtme dhe Investime Strategjike.



ARBËRESHËT E ITALISË GJATË QËNDRIMIT NË KOSOVË

PRISHTINË, 3 MAJ 2019

Në Kosovë ka qëndruar një delegacion i kryetarëve të komunave arbëreshe në Itali. Kosova i priti me një seancë solemne në Kuvend, ku deputetët i falënderuan për kontributin e tyre ndër shekuj që të ruajnë gjuhën dhe kulturën shqiptare. Ndërsa ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli iu drejtua atyre në gjuhën italiane. *“Faleminderit Itali që ke bërë të mundur që të bëjë të jetoj një pjesë shumë të bukur, një etnitet shumë të bukur. Ju jeni pjesa me të cilën krenohemi më së shumti, përfaqësues edhe të Italisë jeni. Italia nuk është larg nesh, është afër, Italia ka qenë shumë afër ne kosovarëve, vetëm para 20 viteve kur ky popull ka jetuar ditët e tij më të tmerrshme. Kanë qenë ditë ‘të ekziston apo mos të ekzistosh’, e nga Italia kanë ardhur ndihmat që na kanë bërë të jetojmë, që na kanë ndihmuar të rezistojmë edhe në këtë pjesë të Adriatikut. Ju jemi shumë mirënjohës Italisë, dyfish”, tha ai.* Ndërsa, në emër të grupit të arbëreshëve të Italisë Rosario Petta tha se po e ndiejnë veten si në shtëpi të vëllezërve. *“Sot e ndiejmë vetën në shtëpinë tonë, Ndjem në shtëpinë e një vëllau tim i cili vetëm gjeografikisht jeton larg meje, vëlla që ka të njëjtin gjak në vena sikur unë Gjak arbëresh...Faleminderit të gjithëve me zemër”, tha Petta.*





Prishtinë, 3 maj 2019- Arbëreshët e Italisë për vizitë në Kosovë, vlerësohen si pishtarë të Rilindjes Kombëtare.



TAKIM ME GJENERALIN AMERIKAN TIMOTHY ORR DHE DELEGACIONIN NGA SHTETI AMERIKAN I IOWA-S

HAJVALI – REZIDENCA, 6 MAJ 2019

Në iftarin e parë të muajit të madh të Ramazanit, kisha nderin që t'a kem mysafir Gjeneralin amerikan Timothy Orr dhe delegacionin nga shteti amerikan i Iowa-s. Miqtë nga SHBA çdoherë në secilën shtëpi në Kosovë janë si në shtëpinë e tyre.





TAKIM ME KRYETARIN E KOMUNËS SË PRISHTINËS, SHPEND AHMETI.

PRISHTINË, 7 MAJ 2019



Prishtinë, 7 maj 2019 - Takim me Kryetarin e Komunës së Prishtinës, z. Shpend Ahmeti.



**NË AMBASADËN E SHQIPERISË PËR TË SHPREHUR
NGUSHËLLIME PËR DËSHMOREN, ZARIFE HASANAJ**

PRISHTINË, 13 MAJ 2019





NIKOQIR I MIQËVE NGA SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

HAJVALI -REZIDENCA, 14 MAJ 2019





TAKIM ME AMBASADORIN TURK NË KOSOVË, CAGRI SAKAR PRISHTINË, 15 MAJ 2019

Takim kuartazie me Ambasadorin e ri, të Republikës së Turqisë në Kosovë, me të cilin diskutuam për marrëdhëniet e shkëlqyeshme që të dyjat vendet tona gëzojnë. Turqia vazhdon të luaj një rol jashtëzakonisht konstruktiv karshi Kosovës,, dhe mbetet përkrahës i fuqishëm i Kosovës në të gjitha forumet ndërkombëtare.





TAKIMI ME AMBASADORIN SLOVEN, BOJAN BERTONCELJ

PRISHTINË, 16 MAJ 2019

Gjatë takimit me Ambasadorin e Sllovenisë të akredituar në Kosovë, Bojan Bertonseljm, janë ri-konfirmuar marrëdhëniet e shkëlqyeshme në mes dy vendeve dhe dy popujve, me zotime dhe përkushtime të reja për forcimin e mëtejme të këtyre marrëdhënieve në fusha të interesit të përbashkët. Ambasadori Bertonselj ka shprehur gatishmërinë e Republikës së Sllovenisë për të asistuar Republikën e Kosovës në të gjitha proceset e integritimit në të cilat vendi po kalon, si dhe në të njejtën kohë ka premtuar përkrahjen e Sllovenisë në procesin e liberalizimit të vizave.



Prishtinë, 16 maj 2019 -Takim me Ambasadorin Slloven, z.Bojan Bertonselj



NGA TAKIMI ME GRUPIN E VISHEGRADIT

PRISHTINË 20 MAJ 2019

Kosova këtë vit kryesonë me WBF dhe jemi shumë të kënaqur që pasra fillimit të kryesimit kemi mbajtur takim me ambasadorët e shteteve të V4 këtu në MPJ, të Republikës së Kosovës ku në vija të trasha i kemi diskutuar së bashku idetë për kryesim. Fondi Ndërkombëtar i Vishegradit (në vijim Fondi i Vishegradit) është organizatë ndërkombëtare donatore e themeluar në vitin 2000 nga qeveritë e shteteve të Grupit të Vishegradit – Çekia, Hungaria, Polonia dhe Sllovakia për ta promovuar bashkëpunimin rajonal në rajonin e Vishegradit (V4), si dhe ndërmjet rajonit V4 dhe shteteve tjera, sidomos në rajonet e Ballkanit perëndimor dhe të Partneritetit lindor. Fondi e bën këtë duke i dhuruar 8 milion euro përmes granteve, bursave dhe rezidencave për artistët që çdo vit dhurohen nga kontributet e barabarta të të gjitha shteteve të V4. Shtetet tjera donatore (Kanadaja, Gjermania, Holanda, Koreja Jugore, Suedia, Zvicra dhe SHBA) që nga viti 2012 i kanë siguruar edhe 10 milion Euro të tjera përmes skemave të ndryshme të granteve të Fondit.



Prishtinë, 20 maj 2019-Takim me grupin e Vishegradit



IFTARI I SHTRUAR PËR PERSONALITETE TË LARTA SHTETRORE

HAJVALI – REZIDENCA, 23 MAJ 2019 – IFTARI









NGA TAKIMI I MINISTRAVE TË V4 DHE BALLKANIT PERËNDIMOR

BRATISLLAVË, 28 MAJ 2019

I informova ministrat e jashtëm të rajonit dhe përfaqësuesit e BE-së për aksionin kundër krimit të organizuar në veri të Mitrovicës por edhe në pjesët tjera të Kosovës, ku u arrestuan një numër i madh i të përfshirëve në krim të organizuar dhe kontrabandë, duke përfshirë një numër të madh të zyrtarëve Policor. Në fjalën time unë kam dënuar veprimet shkatërruese të Serbisë që po ndërmerret kundër Republikës së Kosovës. Pjesëtarët e Forcave të Sigurisë të Kosovës, të cilët janë kërcënuar dhe janë vazhdimisht nën presion të largohen nga FSK-ja, pronat dhe familjet e pjesëtarëve të FSK-së po sulmohen, kërcënohen dhe për më tepër, pjesëtarët e FSK-së po arrestohen dhe lirohen nga policia serbe kur ata udhëtojnë në Serbi, vetëm për ta shtyrë largimin e pjesëtarëve serbë të FSK-së. Duke i kërcënuar ata madje edhe me dënime publike të rënda. Ua bëra të ditur se Serbia e pengoi bashkëpunimin rajonal duke orkestruar shfaqje të ndryshme që treguan fytyrën e vërtetë të Beogradit. Duke e vënë theksin te rëndësia e një bashkëveprimi të përforcuar mes të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve anëtare të BE-së, ne evokouam rëndësinë e zhvillimeve të reja për fuqizimin e perspektivës evropiane të rajonit. Gjithashtu vlerësova se procesi i zgjerimit duhet të jetë një proces i dyanshëm jo vetëm në aspektin gjeopolitik por edhe ekonomik.





TAKIM ME AMBASADORIN E MAURITANISË, SH.T.Z HAMED SIDI MOHAMED

PRISHTINË, 29 MAJ 2019

Prita në takim Ambasadorin e Mauritanisë shkëlqesinë Hamed Sidi Mohamed, u shpreha mjaft i lumtur për miqësinë me Mauritaninë si një nga vendet e para që e ka njohur Pavarësinë e Republikës së Kosovës. E njoftova ambasadorin se ne jemi të lumtur për ardhjen dhe emërimin e tij si Ambasador jo-rezident në Kosovë. Thellimi i bashkëpunimit në të gjitha fushat mes të dyja vendeve është i domosdoshëm. Diskutuam për vizitat që duhet ti shkëmbejmë mes dy vendeve dhe shpreha gatishmërinë tonë për bashkëpunim në të gjitha fushat.





TAKIM ME ARTON ZEKAJ, ISH KAPITEN I U16 DHE U17 TË SERBISË

PRISHTINË, 29 MAJ 2019

Para dy vitesh, Vokri në emër të Kosovës iu pat drejtuar Arton Zekajt, ish kapiten I U16 dhe U17 të Serbisë, duke e ftuar që t'i bashkohet kombëtares së Kosovës. Artoni është aktiv në futboll që nga mosha 6 vjeçare, duke ju bashkuar në fëmijërinë e hershme Akademisë së Futbollit të Partizanit. Pas shumë kërkesave të shumë klubeve evropiane, Artoni i është bashkuar nënkampionit të Francës, Lille, përderisa FIFA ka lejuar që Artoni t'i bashkohet U21 të Republikës së Kosovës. Tani është momenti që ky i ri, yll në ngritje, të shkëlqej në Lille, Francë si dhe në vendin e tij Kosovën. I ri, shtatlartë, i shpejtë, i fuqishëm, me talentin e rrallë në lojën në mesfushë, Zekaj do të jetë një shtyllë lidhëse mes mbrojtjes dhe sulmit të kombëtares sonë. E falenderoj nga zemra që i'u përgjigj ftesës së Legjendës Vokri dhe pritjeve të futbolldashësve të Kosovës. Urime, suksese!





Prishtinë, 29 maj 2019-Takim me Arton Zekaj, ish kapiten i U16 dhe U17 të Serbisë.



TAKIM ME AMBASADORIN E MAURITANISË, HAMED SIDI MOHAMED

PRISHTINË, 29 MAJ 2019

Në takim me Ambasadorin e Mauritanisë Shkëlqesinë Hamed Sidi Mohamed, u shpreha mjaft i lumtur për miqësinë me Mauritaninë si një nga vendet e para që e ka njohur Pavarësinë e Republikës së Kosovës. Thellimi i bashkëpunimit në të gjitha fushat mes të dyja vendeve është i domosdoshëm. Diskutuam për vizitat që duhet ti shkëmbejmë mes dy vendeve dhe shpreha gatishmërinë tonë për bashkëpunim në të gjitha fushat. Ambasadori na falënderoi për mikpritjen dhe theksoi se Mauritania ka mbështetur Kosovën dhe vazhdon të bëjë një gjë të tillë, bashkëpunimi mes dy vendeve tona fillon nga vëllazeria dhe respekti mes popujve tanë. Mauritania duhet ta konsideroj hapjen e Ambasadës së tyre në Prishtinë. Në këtë kuadër, ne jemi të gatshëm të ndihmojmë financiarisht në marrjen e objektit dhe rezidencës së Ambasadorit, në një lokacion dinjitoz për Ambasadën e tyre.



Prishtinë, 29 maj 2019-Takim me Ambasadorin e Mauritanisë, Hamed Sidi Mohamed



TAKIM ME JOEL HAKIZIMANA, SEKRETAR PERMANENT I QENDRËS SË PAVARUR PËR KËRKIME DHE INICIATIVA TË DIALOGUT (CIRID)

PRISHTINË, 30 MAJ 2019

Nga takimi me një delegacion nga Qendra e Pavarur për Kërkim dhe Iniciativa të Dialogut (CIRID) me seli në Gjenevë, të prirë nga Sekretari Permanent i kësaj organizate, Z. Joël Hakizimana. CIRID njëherit shërben edhe si organizatë përfaqësuese e diasporës afrikane, andaj tema kyçe në diskutimin në këtë takim ka qenë thellimi i bashkëpunimit me diasporën afrikane me qëllim të avancimit të marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe shteteve të kontinentit afrikan. Përfaqësuesit e CIRID premtuan angazhim në sjelljen e njohjeve të reja për Republikën e Kosovës.





TAKIM ME PËRFAQËSUESEN E UNDP, ALEKSANDRA ROCCASALOVO

PRISHTINË, 31 MAJ 2019

Kam pritur në takim shefen e UNDP- së në Kosovë znj. Alessandra Roccasalovo, me të cilën gjatë takimit është biseduar për tema të ndryshme me rëndësi për Kosovën si dhe bashkëpunimin e ndërsjelltë në mes UNDP-së dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, duke përfshirë edhe bashkëpunim në të ardhmen. Me këtë rast Pacolli e ka falënderuar znj. Roccasalovo për mbështetjen që i ka dhënë UNDP-ja, Ministrisë së Punëve të Jashtme, në çështje të ndryshme, përmes ofrimit të mbështetjes konsulente.



Prishtinë, 31 maj 2019-Takim me Përfaqësuesen e UNDP-së, znj. Alessandra Roccasalovo.



NË 20 VJETORI I ÇLIRIMIT TË KOSOVËS, DUKE I URUAR MIRËSEARDHJE NË FAMILJEN TIJ, NË KOSOVË, PRESIDENTIT CLINTON

PRISHTINË, 11 QERSHOR 2019

Në 20 vjetorin e Çlirimit të Kosovës, pritje e ngrohtë për ish-Presidentin amerikan z.Bill Clinton, së bashku me ish-Presidenten e Kosovës znj.Atifete Jahjaga. Amerika është aleati më i ngusht i shtetit të Kosovës.







Prishtinë, 12 qershor 2019- Me ish-Presidentin kroat, z.Stjepan Mesic.



Prishtinë, 12 qershor 2019- Clark gjatë fjalës së tij në 20 vjetorin e çlirimit të Kosovës.



Prishtinë, 12 qershor 2019- Ish presidentja Atifete Jahjaga në fjale saj.



Prishtinë, 12 qershor 2019- Kryeministri i Kosovës gjatë fjalës së tij para të pranishmëve.



Prishtinë, 12 qershor -Vizita e Presidentit Clinton, Sekretares Albright dhe Gjeneralit Clark në Kosovë me rastin e 20 vjetorit të çlirimit të Kosovës.



Prishtinë, 12 qershor -Vizita e Presidentit Clinton, Sekretares Albright dhe Gjeneralit Clark në Kosovë me rastin e 20 vjetorit të çlirimit të Kosovës.





FJALIMI I PRESIDENTIT CLINTON, NË SHESHIN SKENDERBEU NË PRISHTINË, ME RASTIN E 20 VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË KOSOVËS

PRISHTINË, 12 QERSHOR

Presidenti Bill Clinton na siguroi se kurrë nuk do të mbetemi vetëm, dhe ai na kujtoi se mbrojtja e njerëzve ishte qëllimi kryesor i bombardimeve. Ai dha shpresë 20 vjet më parë, kur nuk kishim asgjë tjetër, dhe ai na dha shpresë sot, përsëri kur jemi të lirë dhe të pavarur. Kosova është krenare që është vendi më pro SHBA në botë. Kjo do të jetë përgjithmonë. Është për shkak të asaj që bëri Presidenti Bill Clinton dhe Sekretarja Madeline Olbright për të sjellë njerëzit tanë në shtëpi dhe të na japin lirinë tonë. Në çdo cep të vendit do të gjeni simbole dhe kujtime për atë.



Prishtinë, 12 qershor -Vizita e Presidentit Clinton, Sekretares Albright dhe Gjeneralit Clark në Kosovë me rastin e 20 vjetorit të çlirimit të Kosovës.



Prishtinë, 12 qershor 2019- Vizita dyditore e ish-Presidentit amerikan Bill Clinton.



TAKIME ME KRERËT MË TË LARTË INSTITUCIONAL TË SHTETIT TË ÇEKISË

PRAGË, 13 QERSHOR 2019

Me ftesë të ministrit të Jashtëm Çekë, Tomáš Petříček, kam qëndruar për vizitë zyrtare në Pragë. Gjatë vizitës dy ditore zhvillova takime me krerët më të lartë institucional të shtetit të Çekisë.






TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË ÇEKISË, TOMAS PETRICEK

PRAGË, 13 QERSHOR 2019

Në takim me ministrin e jashtëm të Çekisë, Tomas Petricek, një mik i Kosovës dhe përkrahës i proceseve integruese të vendit biseduam për thellimin e marrëdhënieve tona dhe ndërtimin e një partneriteti gjithëpërfshirës, në të gjitha fushat me theks në zhvillimin ekonomik dhe të investimeve. Ngritëm çështjen për zhvillimet në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, mënyrat e bashkëpunimit për të ndërtuar të ardhmen në BE. Ministri Petricek përshëndeti të arriturat tona dhe u zotua për mbështetjen e Kosovës në proceset e saj demokratike dhe të konsolidimit ndërkombëtar. Gjithashtu mirëpriti dhe mbështeti punën e bërë në përmbushjen e të gjitha kriterëve të përcaktuara për Kosovën në liberalizim të vizave. Ministri Petricek tha se Çekia do ta mbështes Kosovën në anëtarësimin e saj në INTERPOL, siç ka bërë edhe në të kaluarën. U pajtuam se na duhet thellim i marrëdhënieve tona në të gjitha fushat.





Pragë, 13 qershor 2019-Takim me Ministrin e Jashtëm të Çekisë, Tomas Petricek



TAKIM ME ZËVENDËSKRYEMINISTRIN E REPUBLIKËS SË ÇEKISË DHE MINISTRIN E INDUSTRIË DHE TREGTISË, KAREL HAVLÍČEK

PRAGË, 13 QERSHOR 2019

Në kuadër të vizitës sime dy ditore në Pragë, kam takuar Zëvendëskryeministrin e Republikës së Çekisë dhe Ministrin e Industrisë dhe Tregtisë, Karel Havlíček. Një bisedë e hapur dhe shumë e çiltër, me ide konkrete të thellimit dhe zgjerimit të bashkëpunimit në fushën e ekonomisë. Të dy vendet tona mund të ofrohen më shumë përmes bashkëpunimit ekonomik dhe Zëvendëskryeministri Havlíček shprehi gatishmërinë e Çekisë për të punuar me Kosovën në shumë sektorë, me theks në energji. Mikpritësi e cilësoi Kosovën pjesë të Evropës dhe tha se Çekia do të ndërtojë marrëdhënie të forta ekonomike me Kosovën.





Pragë, 13 qershor 2019-Takim me Zëvendëskryemministrit e Republikës së Çekisë dhe Ministrin e Industrisë dhe Tregtisë, Karel Havlíček.



Çeki, 13 qershor 2019- Vizitë me delegacionin nga Kosova në një kompani në Pragë.



TAKIM ME KRYETARIN E DHOMËS SË DEPUTETËVE TË PARLAMENTIT TE REPUBLIKËS SË ÇEKISË DHE NËNPRESIDENTIN E SENATIT

PRAGË, 14 QERSHOR 2019

Në Pragë takova Kryetarin e Dhomës së Deputetëve të Parlamentit të Republikës së Çekisë Radek Vondráček dhe nënpresidentin e Senatit, Jiří Růžička. Në takim biseduam për zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet Parlamenteve të dy vendeve dhe shkëmbimin e përvojave. Parlamenti i Çekisë mund të ndihmojë Kosovën në rrugën e saj të integritimeve evropiane dhe në përafrimin e legjislacionit të Republikës së Kosovës me BE-në. Gjatë takimit biseduam hapur për bashkëpunimin e dy vendeve në fusha të ndryshme dhe për krijimin e një Grupi të Miqësisë ndërmjet Parlamentit të Republikës së Kosovës dhe të Çekisë.







VENDOSJA E LULEVE NË VARRIN E PRESIDENTIT Z.VACLAV HAVEL

PRAGË, 14 QERSHOR 2019

Duke vizituar Pragën ne i bëmë homazhe varrit të Presidentit z.Vaclav Havel për luftën e tij pasionante për lirinë brenda dhe jashtë vendit. Havel ishte një mbrojtës i lirisë, demokracisë dhe të drejtave të njeriut dhe mik i shkëlqyeshëm i Kosovës. Ai i dha dimension intelektual fushatës Ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë.





Pragë, 14 qershor 2019-Vendosja e luleve në Varrin e Presidentit të ndjerë z.Vaclav Havel.



TAKIMI JOFORMAL ME SHEFAT E MISIONEVE TË SHTETEVE ANËTARE TË SEECP

RISHTINË, 20 QERSHOR 2019

Prezantuar logon tonë, diskutuar për idetë dhe prioritetet tona kryesore gjatë kryesisë sonë dhe prezantuar projekt kalendarin e aktiviteteve. SEECP gjatë kryesimit të Kosovës në detyrë do të zhvillohet më tej si një shprehje e solidaritetit dhe përpjekjeve të shteteve pjesëmarrëse për të forcuar lidhjet dhe bashkëpunimin midis tyre dhe shteteve dhe strukturave tjera euroatlantike. Sipas objektivave kryesore të SEECP që janë forcimi i bashkëpunimit politik dhe të sigurisë, bashkëpunimi ekonomik, Kosova do të kontribuojë për të punuar më tej së bashku, për të krijuar në rajon kushtet tona për prosperitetin e kombeve tona në një mjedis të paqes, sigurisë, fqinjësisë së mirë stabilitetit, qasja koherente e bashkëpunimit rajonal, promovimi i vlerave universale demokratike, respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut. Kryesia e Kosovës në detyrë do të jetë një vazhdimësi e parimeve të Kartës së SEECP, Deklaratat e Samitit të SEECP që bashkëpunojnë ngushtë me të gjitha shtetet pjesëmarrëse të SEECP dhe strukturat përkatëse rajonale dhe ndërkombëtare.





TAKIM ME HOMOLOGUN NGA SLLOVAKIA

REZIDENCA, HAJVALI – 20 QERSHOR

Në rezidencën time isha i lumtur të presë Miroslav Lajčák, Ministrin e Punëve të Jashtme, Çështjeve Evropiane dhe Kryesuesin e rradhës të OSBE-së dhe ekipin e tij.

Ne diskutuam për çështjet me rëndësi jo vetëm në lidhje me vendet tona, por të gjithë rajonin. OSBE është një partner i rëndësishëm i Kosovës dhe misioni i tyre në Kosovë gjatë dhe pas luftës ka luajtur një rol historik për Kosovën.





Rezidenca, Hajvali – 20 Qershor – Takim me delegacionin nga Sllovakia



AMBASADORJA E KOSOVËS, ZANA RUDI, I PARAQITI LETRAT E KREDENCËS PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS KOOPERATIVE TË GUAJANËS

Guajana, 20 Qershor 2019

Ambasadorja e Kosovës Zana Rudi i paraqiti Letrat e Kredencës Presidentit David Granger të Republikës Kooperative të Guajanës, duke e akredituar atë si Ambasadoren e 1-rë të Kosovës në Guajanë. Guajana është partneri i gjatë i Kosovës që mbështet integrimin tonë ndërkombëtar.







TAKIMI ME AMBASADORIN BRITANEZ Z.RUARI O'CONNELL

PRISHTINË, 24 QERSHOR 2019

Prita në takim Ambasadorin Britanez z.Ruari O'Connell të cilin e falenderova për angazhimin e tij të vazhdueshëm për Republikën e Kosovës dhe për popullin e saj. Gjatë takimit diskutuam për situatën politike në vend dhe problemet me të cilat ballafaqohet diplomacia kosovare. Ambasadori O'Connell më dorëzoi ftesën nga Sekretari për Punë të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, Jeremy HUNT, për të marrë pjesë në Konferencën Globale për Lirinë e Medias e cila do të mbahet në Londër me 11 dhe 12 Korrik. Ambasadori O'Connell e rikonfirmoi përkrahjen e Mbretërisë së Bashkuar për Kosovën në proceset e saj integruese dhe shprehi shpresën e tij që këto marrëdhënie do të vazhdojnë të kultivohen edhe më tutje.





TAKIMI ME AMBASADORIN E LUKSEMBURGUT JOREZIDENT PËR KOSOVË Z.PAUL SCHMIT

PRISHTINË, 24 QERSHOR 2019

Kam pritur sot në takim ambasadorin e Luksemburgut në Kosovë, Paul Schmit, me të cilin diskutova për programet e përkrahjes nga ky vend për procesin e integritimit. Falenderova ambasadorin Schmit për vazhdimin e mbështetjes së Luksemburgut në synimin e Kosovës për t'u bërë anëtarë si në Interpol ashtu dhe në organizatat e tjera ndërkombëtare.



Prishtinë, 24 qershor 2019-Takimi me Ambasadorin e Luksemburgut, jorezident për Kosovë, z.Paul Schmit.



TAKIM ME KRYEDIPLOMATËN NORVEGJEZE, INE MARIE ERIKSEN SØREIDE

PRISHTINË, 25 QERSHOR 2019

Kryediplomatëd Norvegjeze, Ine Marie Eriksen Søreide, i bëra me dije se Norvegjia është vend model nga i cili mund të mësojmë shumë për zhvillimin dhe bashkëpunimin ndër-shtetëror. Ky vend ka përkrahur fuqishëm Republikën e Kosovës në të gjitha etapat para dhe pas pavarësisë. Edhe sot, Eriksen shfaq mirëkuptim total për nevojën e përkrahjes së Kosovës në proces të hapjes së mundësive të reja. Gjatë këtij takimi, znj. Eriksen i shpjegova faktin se Serbia po provon ta bllokojë Kosovën në synimin e saj të integritimit në familjen e shteteve demokratike, evropiane. U dakorduam për thellimin e bashkëpunimit mes dy vendeve dhe shpreha mirënjohje për përkrahjen e Norvegjisë në procese të afirmimit tonë ndërkombëtar.





Prishtinë, 25 qershor 2019-Takimi i delegacionit kosovar nga MPJ dhe delegacionit të kryediplomates Norvegjeze, Ine Eriksen.



30 VJETORI I FORUMIT TË CRANS MONTANËS

GENEVE, 27 QERSHOR 2019

Në 30 vjetorin e Forumit të Crans Montanës, një tryezë e respektuar e diplomacisë botërore, para fjalimit tim, pata rastin të takohesha me personalitete të rëndësishme. Pata një takim miqësor me Dr.Sali Berisha, ish President dhe ish Kryeministër i Shqipërisë.



Geneve, 27 qershor 2019 – Takim në kuadër të Forumit të Crans Montana, me ish presidentin shqiptar, Sali Berisha



FOTOGRAFI NGA TAKIMET ME PËRFAQËSUES SHTETESH NGA E MBARË BOTA NË FORUMIN E CRANS MONTANA

GENEVE, 27 QERSHOR 2019





TAKIM ME ZONJËN E PARË TË GUINESË ZNJ. HADJA CONDE DJÉNÉ KABA

GENEVE, 27 QERSHOR 2019

Shkëmbim i shkëlqyeshëm me Zonjën e Parë të Guinesë Znj. Hadja Conde Djéné Kaba. Kosova dhe Guinea janë miq dhe partnerë që mbështesin njëri-tjetrin ndërkombëtarisht.





TAKIM ME KRYEMINISTRIN E TUVALU Z. ENELE SOPOAGA

GENEVE, 27 QERSHOR 2019

Gjatë Forumit Crans Montana pata një shkëmbim të shkëlqyeshëm me Enele Sopoaga, Kryeministrin e Tuvalu. Të dy diskutuam për sfidat me të cilat përballen vendet tona të vogla dhe mbështetjen e ndërsjellë në organizatat ndërkombëtare. Këtë vit Ambasadori Leon Malazogu ishte akredituar në Tuvalu. Ne do të punojmë sëbashku.





TAKIM ME SHEFIN EKZEKUTIV ABDULLAH ABDULLAH TË AFGANISTANIT

GENEVE, 27 QERSHOR 2019

Takim i shkëlqyeshëm me Shefin Ekzekutiv, Abdullah Abdullah të Afganistanit për marrëdhëniet e shkëlqyera që kanë vendet tona. Mirënjohës për mbështetjen e vazhdueshme të Afganistanit në axhendën ndërkombëtare të Kosovës. Ne do të punojmë për të forcuar bashkëpunimin tonë dypalësh.





GJATË FJALIMIT PARA TË PRANISHMËVE NË FORUMIN CRANS MONTANA

GENEVE, 27 QERSHOR 2019

“Kosova është gati për t’u bërë pjesë e OKB-së me rolin e saj konstruktiv në rajon prej 20 vjetësh që ka fituar lirinë e saj”, me këto fjalë nisa fjalimin tim para të pranishmëve në forumin e respektuar të Crans Montana. Po ashtu, i’u drejtova miqve spanjollë, duke iu bërë me dije Kosova nuk ka lidhje me Katalonjën, sepse ne kemi dalë nga një periudhë e gjatë represioni kolonial, i cili kulmoi me gjenocid në vitin 1999” - kështu ju drejtova pjesëmarrësve të nivelit të lartë të Forumit të Cransmontanës në Zvicër, forum që prej 30 vjetësh është shndërruar në institucion dialogu real. Gjatë fjalimit e njoha audiencën me të arriturat e vendit tonë nga shpallja e pavarësisë, njohur ndërkombëtarisht nga 116 shtete, ashtu dhe nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Ftova miqtë afrikanë që ende nuk e kanë bërë - të njohin Kosovën dhe të vendosin me ne marrëdhënie bashkëpunimi në të gjitha fushat, madje dhe në atë universitare.



Geneve, 27 qershor – Gjatë fjalimit para të pranishmëve në Forumin “Crans Montana”



TAKIM ME MINISTREN E PUNËVE TË JASHTME BULLGARE, EKATERINA ZAHARIEVA

GENEVE, 27 QERSHOR 2019

Mirënjohës ndaj homologes time, Ministres së Jashtme bullgare Ekaterina Zaharieva për mbështetjen e saj parimore për liberalizimin e vizave për Kosovën dhe nevojën që anëtarët e BE të "përbushin premtimet e tyre" për reformat që ka ndërmarrë Kosova. Evropa duhet të tregojë leadership, të mos tërhiqet nga rajoni ynë. Kosova ka përbushur të gjitha kriteret e kërkuara. Komisioni Evropian dhe Parlamenti Evropian i kanë njohur reformat tona. Tani koha për vendimarrje. Sfidat e brendshme në BE nuk janë justifikim për ta mbajtur popullin e Kosovës të izoluar.





TAKIMI VJETOR I ORGANIZATËS BOTËRORE TË DOGANAVE

PARIS, 1 KORRIK 2019

Në Paris së bashku me Kryeministrin Haradinaj takuam ministrin e Brendshëm të Francës, Christopher Castaner, me ç'rast kërkua mbështetjen e Francës në procesin e liberalizimit të vizave, si një hap tejet të rëndësishëm për Kosovën. Kryeministri Haradinaj dhe ministri Castaner nënshkruan edhe letrën e qëllimit të mirë, për të thelluar bashkëpunimin në luftimin e krimit të organizuar, terrorizmit dhe migrimin ilegal. Kosova është një partner evropian i Francës dhe ne mbetemi të përkushtuar ndaj idesë së integritimit evropian. Në këtë frymë, mbështetja e Francës është e rëndësishme në hapin përfundimtar për të arritur lëvizjen e lirë për qytetarët e Kosovës. Ne do të punojmë ngushtë për ta arritur këtë qëllim.



Paris, 1 Korrik 2019 - Takim Me Ministrin E Brendshëm Të Francës, Z.Christopher Castaner



Paris, 1 Korrik 2019 – Së bashku me Kryeministrin Haradinaj takuam ministrin e Brendshëm të Francës, z.Christopher Castaner



NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES HISTORIKE PËR BASHKËPUNIM STRATEGJIK MES MINISTRIVE TË PUNËVE TË JASHTME TË KOSOVËS DHE SHQIPËRISË

TIRANË, 2 KORRIK 2019


Jashtëzakonisht i lumtur që në Tiranë kemi nënshkruar marrëveshjen historike për bashkëpunim strategjik mes Ministrive të Punëve të Jashtme që do të bashkojnë dhe afrojnë pas 11 vjet pavarësie bashkëpunimin diplomatik të Kosovës dhe Shqipërisë. Ne synojmë të zhvillojmë një politikë të bashkërenduar në fushat strategjike të rëndësisë kombëtare në politikën e jashtme. Kosova dhe Shqipëria do të bashkërendojnë nga afër politiken e jashtme, do të krijojnë misione të përbashkëta diplomatike dhe do të ndajnë stafin dhe përvojën për zbatimin e interesave tona kombëtare. Ky është një hap i madh përpara për të ardhur së bashku në skenën botërore dhe për të vepruar si një komb.



Tiranë, 2 korrik 2019 – Momente pas nënshkrimit të marrëveshjes historike



Tiranë, 2 korrik 2019 – Momente nga konferenca për media me ministrin në detyrë, Gent Cakaj



Tiranë, 2 korrik 2019 – Momente nga nënshkrimi i marrëveshjes me ministrin në detyrë, Gent Cakaj



Tiranë, 2 korrik 2019 – Momente nga nënshkrimi i marrveshjes me ministrin në detyrë, Gent Cakaj



TAKIM LAMTUMIRËS ME AMBASADORIN E KANADASË DANIEL MAKSYMIUK

PRISHTINË, 3 KORRIK 2019

Nga takimi lamtumirës me ambasadorin e Kanadasë, Daniel Maksymiuk, të cilin e falënderova për kontributin e tij në forcimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Kanadasë. Ai ka qenë aktiv në nxitjen e miqësisë tanimë të shkëlqyer mes shteteve tona dhe Kanadaja mbetet një mbështetës i patundur i Kosovës në të gjitha nivelet.





TAKIM ME KRYETARIN E KOMITETIT OLIMPIK TË KOSOVËS, BESIM HASANI

PRISHTINË, 3 KORRIK 2019

Kam pritur në një takim Kryetarin e Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, të cilit i kam shprehur mirënjohjen dhe respektin për arritjet e atletëve të Kosovës në garat ndërkombëtare dhe punën e mirë që Komiteti po bën për të promovuar Kosovën në botë. Ne do të mbështesim atletët pasi ky është një element i rëndësishëm në forcimin e imazhit të Kosovës në skenën ndërkombëtare. E informova Kryetarin gjithashtu se Ministria e Punëve të Jashtme do të krijojë këto ditë, një Departament për Diplomacinë Kulturore dhe Sportive që do të përfshijë diplomatë dhe sportistë të suksesshëm dhe të njohur ndërkombëtarisht për të siguruar mbështetje të fuqishme për aktivitetet e tyre dhe për të fuqizuar me shumë diplomacinë kulturore dhe sportive të Kosovës.



Prishtinë, 3 korrik 2019- Takim me Kryetarin e Komitetit Olimpik të Kosovës z.Besim Hasani.



NGA SAMITI I POZNANIT

POZNAN, 4 KORRIK 2019

Dëshiroj fillimisht të përgëzoj Poloninë dhe mikun tim Ministrin e Jashtëm Jacek Czaputowicz për një vit të jashtëzakonshëm të kryesimit me Procesin e Berlinit, për organizimin e madh të këtij Samiti dhe për angazhimin për të sjellë një frymë të re bashkëpunimi dhe mirëkuptimi. Është e rëndësishme ky rol dhe vlera e shtuar e Polonisë në procesin e zgjerimit të BE, që ka mbetur në gjysmë të rrugës dhe mbështetjen e saj për vendet e Ballkanit Perëndimor në rrugën drejt integritimit. Ne kemi shumë për të mësuar gjatë integritimit evropian dhe mbi të gjitha kemi shumë për të kapërcyer në marrëdhëniet tona në Ballkan dhe në raport me shoqëritë tona.



Poznan, 4 korrik – Gjatë takimit me homologun Polak, Jacek Czaputowicz



Poznan, 4 korrik – Pritja e ngrohtë dhe miqësore në Poznan



Poznan, 4 korrik – Fotografi e përbashkët me homologët në Samitimin e Ballkanit Perëndimor në Poznan



TAKIM ME KONGRESMENIN ELIOT ENGELL

PRISHTINË, 6 KORRIK 2019

Nderë dhe kënaqësi të kaloj kohë së bashku me mikun e madh të Kosovës, kongresmenin Eliot Engell. Kontributi i Engel për vendin tonë është i njohur nga secili qytetar i Kosovës. Kongresmeni Engel edhe sot nga pozicioni i udhëheqësit të komitetit për politikë të jashtme në kongresin e SHBA, ndihmon fuqizimin dhe zhvillimin e vendit tonë. Faleminderit kongresman Engel.





Prishtinë, 6 korrik – Momente të paharruara me mikun e shqiptarëve kongresmenin Engel



Prishtinë, 6 korrik – Momente të paharruara me mikun e shqiptarëve kongresmenin Engel



DARKA ME DISA NGA AMBASADORËT E AKREDITUAR NË KOSOVË

REZIDENCA HAJVALI, 6 KORRIK 2019

Darkë me disa nga Ambasadorët e akredituar në Kosovë, në shenjë mirënjohjeje për kontributet e tyre për marrëdhëniet e shkëlqyeshme që Republika e Kosovës gëzon me këto vende. Këta ambasadorë kanë luajtur rol jashtëzakonisht të madh edhe në formimin e demokracisë në Kosovë, si dhe në subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës, për çka unë dhe qytetarët e Kosovës jemi shumë mirënjohës.



Prishtinë, 6 korrik – Momente nga darka me disa nga ambasadorët e akredituar në Kosovë



Prishtinë, 6 korrik – Momente nga darka me disa nga ambasadorët e akredituar në Kosovë



Prishtinë, 6 korrik – Momente nga darka me disa nga ambasadorët e akredituar në Kosovë



KOSOVA KRYESON PROCESIN E BASHKËPUNIMIT TË EVROPËS JUGLINDORE-SEECF

PRISHTINË, 15 KORRIK 2019

Kosova ka marrë përsipër nga Bosnja dhe Hercegovina kryesimin e rradhës të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECF). SEECF është organizata më e vjetër dhe më e rëndësishme politike në Evropën Juglindore që përfshin Kosovën, Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Slloveninë, Kroacinë, Malin e Zi, Serbinë, Maqedoninë Veriore, Greqinë, Bullgarinë, Rumaninë dhe Turqinë. Në të njëjtën kohë do të tregojmë se sa politikisht korrekt duhet të veprojmë në rajon me qëllim të forcimit të së ardhmes evropiane të Ballkanit Perëndimor. Kosova do të promovojë aktivitete të ndryshme dhe do të presë shumë takime të nivelit të lartë gjatë kryesisë. Në të njëjtën kohë, Kosova gjithashtu ka kryesimin e MARRI-it dhe të Fondit të Ballkanit Perëndimor, duke luajtur kështu një rol të fuqishëm në rajonin tonë. Vitin tjetër nga Kosova Kryesimi i SEECF do t'i dorëzohet Turqisë.









TAKIM LAMTUMIRËS ME AMBASADORIN E NORVEGJISË NË KOSOVË PER STRAND

PRISHTINË, 16 KORRIK 2019

Thellësisht mirënjohës që në takimin lamtumirës me Ambasadorin e Norvegjisë në Kosovë, Per Strand Sjaastad, konstatuam bashkë që bashkëpunimi mes vendeve shteteve dhe popujve tanë, mbetet i paluhatur dhe i palëkundur. Ambasadori Norvegjez edhe një herë konfirmoi që ai do të vazhdojë ta përkrahë Kosovën në të gjitha formatet, dhe njëherësh theksoi faktin që këto 20 vite, Kosova ka shënuar një progres të konsideruar në të gjitha fushat. Ambasadorin Norvegjez e sigurova që mirënjohja e Republikës së Kosovës për shtetin dhe popullin Norvegjez është gurthemeli i forcimit të marrëdhënieve mes vendeve tona.



Prishtinë, 16 korrik 2019 – Momente nga shkëmbimi i dhuratave me Ambasadorin Norvegjez



TAKIM ME AMBASADORIN E ZVICRËS SH.T. JEAN HUBERT LEBET

PRISHTINË, 16 KORRIK 2019

Takim me Ambasadorin Zvicran, me të cilin diskutuam për bashkëpunimin dhe për rolin e Zvicrës në forcimin e Deokracisë dhe sundimit të ligjit. Zvicra mbetet aleat i rëndësishëm në integrimet euro-atlantike të Kosovës.





RRUGËS PËR WASHINGTON PËR TË MARR PJESË NË MINISTERIALIN E DYTË PËR LIRITË FETARE

WASHINGTON, 17 KORRIK 2019

Rrugës për në Washington për të marrë pjesë me ftesë të Sekretarit Amerikan të Shtetit Mike Pompeo në Ministerialin e dytë për liritë fetare. Mozaiku i Kosovës si një shtet i ri, multietnik dhe multi-fetar pasqyron një shembull konkret të ndërtimit të konceptit të avancuar të harmonisë ndër-fetare të kultivuar me shekuj. Do të mbaj shumë diskutime me zyrtarët amerikan dhe shumë vende të tjera për të shtyer prioritetet diplomatike të Kosovës.





MINISTERIALI I DYTË PËR LIRITË FETARE

WASHINGTON, 18 KORRIK 2019

Me ftesën e Sekretarit Amerikan të Shtetit Mike Pompeo duke marrë pjesë në Ministerialin e Lirive Fetare për të diskutuar mbi liritë fetare në mbarë botën dhe për të mbajtur takime bilaterale me zyrtarë amerikanë dhe homolog për të çuar përpara objektivat e politikës së jashtme të Kosovës. Sekretari Pompeo e hapi takimin për të shprehur mbështetjen amerikane për këtë iniciativë të rëndësishme. Unë do të paraqes gjendjen në Kosovë dhe atë që kemi bërë në mbrojtje të lirive fetare si një nga vendet më të përparuara në Evropë dhe më gjerë.





Washington, 18 korrik 2019 – Gjatë takimit në Ministerialin e Lirive Fetare



Washington, 18 korrik 2019 – Gjatë takimit në Ministerialin e Lirive Fetare



Washington, 18 korrik 2019 – Gjatë takimit në Ministerialin e Lirive Fetare



MINISTERIALI I DYTË PËR LIRITË FETARE

WASHINGTON, 18 KORRIK 2019

Në fjalimin tim në Ministerialin mbi liritë fetare të thirur nga Sekretari Amerikan i Shtetit paraqita mozaikun multi-etnik dhe multi-fetar të Kosovës. Liria fetare është një parim që ka rëndësi për ne, për shkak të historisë sonë, trashëgimisë sonë dhe të ardhmes sonë. Në rrugëtimin tonë përpara ne duhet të shohim përsëri në traditën tonë të gjatë të bashkëjetesës paqësore midis feve të ndryshme, ne, myslimanët, katolikët, ortodoksët, protestantët, hebrenjtë dhe shumë komunitete të tjera jetojmë së bashku në harmoni dhe bashkëjetesë. Kushtetuta e Kosovës promovon praktikimin e pakufizuar të besimit dhe i jep trajtim të barabartë të gjitha feve në Kosovë dhe pasuesve të tyre. Ne kemi përfshirë instrumentet e Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Evropës si pjesë e sistemit tonë ligjor. Kosova po krijon mekanizma institucionalë që do të forcojnë angazhimin e Qeverisë me të gjitha bashkësitë fetare në Kosovë. Kosova është një shembull në rajon dhe më gjerë në lidhje me tolerancën ndërfetare dhe bashkëjetesën e religjioneve. Ne do të promovojmë këtë vlerë dhe trashëgiminë e Kosovës dhe jemi të lumtur ta ndajmë atë në mbarë botën.



Washington, 18 korrik 2019 – Gjatë fjalimit në takimin e Ministerialin e Lirive Fetare



MINISTERIALI I DYTË PËR LIRITË FETARE

WASHINGTON, 18 KORRIK 2019

Kosova përfaqësohet në mënyrë të privilegjur në Ministerialin për Liritë Fetare. Arritjet tona janë të njohura gjerësisht. Falënderova Sekretarin Amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, për mbështetjen e tij dhe atë amerikane ndaj Kosovës.



Washington, 18 korrik 2019 – Fotografia e përbashkët me pjesëmarrësit në Ministerialin e Lirive Fetare



TAKIM ME MINISTRIN E PUNËVE TË JASHTME TË POLONISE, JACEK CZAPUTOWICZ

WASHINGTON, 18 KORRIK 2019

Gjithmonë kënaqësi për të shkëmbyer mendime me Ministrin e Punëve të Jashtme të Polonise, Jacek Czaputowicz, për zhvillimet në Evropë dhe BB6 dhe bashkëpunimin tonë dypalësh. Ne gjithashtu rishikuam rezultatet e Samitit të Poznanit dhe shprehu mirënjohjen tonë për mbështetjen e fortë polake ndaj perspektivës së BE-së për Kosovën.



Washington, 18 korrik 2019 – Bashkëbisedim me Ministrin e Punëve të Jashtme të Polonise, Jacek Czaputowicz



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË IZRAELIT, ISRAEL KATZ

WASHINGTON, 18 KORRIK 2019

Në Washington, në margjinat e ministerialit mbi liritë fetare, kisha një diskutim të shkëlqyeshëm me ministrin e jashtëm të Izraelit, Israel Katz, mbi marrëdhëniet midis Kosovës dhe Izraelit dhe bashkëpunimin konkret që dy vendet tona mundë të kenë. Ne do të eksplorojmë fusha me interes të ndërsjellë në dobi të vendeve tona dhe lidhjeve tradicionale.



Washington, 18 korrik 2019 – Shtrëngim duarsh me homologun tim nga Izraeli, Israel Katz



TAKIM ME NDIHMËS SEKRETARIN AMERIKAN TË SHITIT PHILIP REEKER

WASHINGTON, 20 KORRIK 2019

Takim shumë i rëndësishëm me Ndihmës sekretarin amerikan të shtetit Philip Reeker. Aleanca jonë me SHBA është jashtëzakonisht e rëndësishme për të ardhmen euroatlantike. Përkushtimi amerikan për Kosovën është i palëkundër. Kosova është me fat që në rrugëtimin e vet ec përkrah shtetit më të fuqishëm dhe më demokratik të botës.



Washington, 20 korrik 2019 – Mikpritje e ngrohtë në Washington nga Sekretari Amerikan I Shtetit, Philip Reeker



TAKIM ME SEN RON JOHNSON - KRYETARI I KOMITETIT TË SIGURISË KOMBËTARE

WASHINGTON, 20 KORRIK 2019

Në Washington është çdo herë kënaqësi për të shkëmbyer mendime me Sen Ron Johnson mbi zhvillimet në Kosovë dhe Western Balkans dhe angazhimin e Shteteve të Bashkuara në rajonin tonë për të trajtuar kërcënimet dhe për të ecur përpara me çështje kyçe thelbësore për stabilitetin rajonal dhe prosperitetin.



Washington, 20 korrik 2019 – Kënaqësi për të shkëmbyer mendime me Sen Ron Johnson



TAKIM ME KRYETARIN RUDY GIULIANI

WASHINGTON, 20 KORRIK 2019

Gjithmonë i kënaqur kur e pashë mikun tim Kryetarin Rudy Giuliani dhe flasim për partneritetin Kosovë –United States dhe mënyrën se si të rritet më shumë kjo miqësi e palëkundur. Kryetari Giuliani është një mbështetës dhe mik i fortë i Kosovës në SH.B.A.



Washington, 20 korrik 2019 – Gjithmonë i kënaqur kur takoj një mbështetës dhe mik i fortë i Kosovës në SH.B.A., RUDY GIULIANI



KOSOVA DHE ANTIGUA&BARBUDA NËNSHKRUAJNË VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE

WASHINGTON, 24 KORRIK 2019

Kosova dhe Antigua & Barbuda kanë vendosur sot marrëdhëniet diplomatike në Uashingtonit. Ky është një hap i madh për Kosovën në forcimin e pozitës tonë diplomatike në rajonin e Karaibeve. Sot zhvillova një telefonatë me Ministrin e Punëve të Jashtme të Antigua dhe Barbuda Chet Greene dhe e falënderova atë për këtë kapitull të ri në marrëdhëniet tona dypalëshe dhe e sigurova për gatishmërinë tonë për të punuar ngushtë në çështje të rëndësishme për dy vendet tona.



24 Korrik 2019 - Kosova dhe Antigua&Barbuda nënshkruajnë vendosjen e marrëdhënieve diplomatike në Washington.



TAKIM ME FUTBOLLISTIN E KOMBËTARES SHQIPTARE, SHKËLZEN GASHI

PRISHTINË, 02 GUSHT 2019

Kalimthi pata një takim shumë të këndshëm me futbollistin e kombëtares, Shkelzen Gashi, i cili e ka bërë kombin tonë krenar për suksesin e madh që ai ka treguar me Kombëtaren.



Prishtinë, 2 gusht 2019- Takim me futbollistin e kombëtares shqiptare Shkelzen Gashi .



TAKIM LAMTUMIRËS ME AMBASADOREN KROATE NË KOSOVË, MARIJA KAPITANOVIÇ

PRISHTINË, 20 GUSHT 2019



Prishtinë, 20 gusht 2019 - Gjatë takimit lamtumirës ambasadoren e Kroacisë, Marija Kapitanoviç



TAKIM ME AMBASADORIN JAPONEZ NË VJENË, JO-REZIDENT PËR KOSOVË, KIYOSHI KOINUMA

PRISHTINË, 26 GUSHT 2019

Takim me Ambasadorin japonez në Vjenë, jo-rezident për Kosovë, Kiyoshi Koinuma. Kosova dhe Japonia vazhdojnë të kultivojnë mardhënie të shkëlqyera. Falenderova Ambasadorin japonez për pritjen e mirë që Japonia i ka bërë ekipit kosovar të xhudos.



Prishtinë, 20 gusht 2019 - Takim me Ambasadorin japonez në Vjenë, jo-rezident për Kosovë, Kiyoshi Koinuma



TAKIM ME z. ROLAND VAN REMOORTELE, INSPEKTOR I POSTEVE DIPLOMATIKE

PRISHTINË, 27 GUSHT 2019

Takim shumë i rëndësishëm me shefin e zyrës së Belgjikës në Kosovë, Jean-Louis Servais, dhe Roland Van Remoortele, inspektor i posteve diplomatike. Aleanca jonë me shtetin e Belgjikës është jashtëzakonisht për të ardhmen tonë evropiane. Përkushtimi i shtetit belg në Kosovë është i palëkundur.





TAKIM ME TË NGARKUARIN E PËRKOHSHËM ME PUNË TË AMBASADËS HUNGAREZE NË PRISHTINË, BELA BOZSIK

PRISHTINË, 27 GUSHT 2019

Kosova ka marrëdhënie tradicionalisht të shkëlqyera me Hungarinë. Me të Ngarkuarin e përkohshëm me Punë të Ambasadës Hungareze në Prishtinë, z. Bela Bozsik, u pajtuam se thellimi i marrëdhënieve bilaterale në të gjitha nivelet dhe fuqizimi i partneritetit ekonomik, me theks në fushën e investimeve, është në dobi të të dyja vendeve. Bashkëbiseduam hapur edhe për të drejtën e pamohueshme të lëvizjes së lirë për qytetarët e Kosovës dhe domosdoshmërinë e anëtarësimit të vendit tonë në Organizatat Ndërkombëtare.






PJESË E TAKIMIT E MINISTRAVE TË JASHTËM TË BE-SË NË HELSINKI, GYMNICH MEETING

HELSINKI-FINLANDË - 30 GUSHT 2019

Me ftesë zyrtare nga shefja në largim e diplomacisë evropiane, Federica Mogherini, po marrë pjesë dhe përfaqësojë vendin në një takim të nivelit të lartë të Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian. “Kosova po trajtohet e barabartë në ministerialin e shefave të diplomacisë së 28 vendeve të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor në Helsinki. Jam këtu për të adresuar vizionin e Kosovës për bashkëpunimin rajonal, obstrukcionet e Serbisë në dialog dhe në shkëmbimet ekonomike në rajon dhe thirrjen e Kosovës për t’i dhënë fund izolimit të saj ndërkombëtar nëpërmjet liberalizimit të vizave”.



Helsinki, 30 gusht 2019 – Shtrëngim duarsh me shefen në largim të diplomacisë evropiane, Federica Mogherini



Helsinki, 30 gusht 2019 – Foto e përbashkët me nikoqirët e Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian.



KOMUNIKATË PËR MEDIA

HELSINKI – FINLANDË, 31 GUSHT 2019



Debat midis ministrit Pacolli dhe atij Serb Daçiq në Helsinki: "Përralla të tjera tregoni në Beograd dhe të tjera këtu. Ndalni dhunën ndaj qytetarëve dhe bizneseve tona në kufi dhe në territorin tuaj. Skandalet tuaja në Afrikë janë të njohura..."

Zëvendëskryeministri i Parë dhe Ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, z. Behgjet Pacolli, po përfaqëson Kosovën në takimin e rëndësishëm që shënon njëkohësisht fillimin e presidencës finlandeze të BE-së. Gjatë paraqitjes së Ministrit të Jashtëm të Kosovës, Behgjet Pacolli dhe atij serb, Ivica Daçiq, gjatë punimeve të sesionit të diskutimeve dhe debatit në Forumin informal të 28 ministrave të jashtëm të BE-së, dhe atyre të Ballkanit, u zhvillua debat i ashpër.

Ministri Pacolli reagoi ndaj përpjekjeve djallëzore të shefit të diplomacisë serbe për të paraqitur një rol konstruktiv të Serbisë në rajon dhe për të demonizuar Kosovën në një forum kaq prestigjioz.

"Ju tregoni përralla të tjera në Beograd dhe të tjera këtu ", I tha ministri Pacolli, homologut të tij Serb. "Nuk jeni engjëll si doni të dukeni me fjalët e bukura para kolegëve të Evropës. A ju duket evropiane dhunimi i autobusëve, i qytetarëve, i bizneseve tona në pikat kufitare, apo në territorin e Serbisë? Skandalet që ju keni bërë nëpër Afrikë janë të njohura tashmë për të gjithë ", shtoi në fjalën e tij ministri Pacolli.



Ndërkohë në fillim të fjalës së tij, ministri Pacolli falënderoi Komisioneren për punë të jashtme Mogherini për ftesën që i bëri Kosovës të merrte pjesë si e barabartë në një forum kaq të rëndësishëm diplomatik. Duke Vlerësuar ndjenjën e përkatësisë euroatlantike të Kosovës, ministri Pacolli i bëri thirrje Bashkimit Evropian që të përmyllte misionin e vet ndaj Kosovës, duke e ndihmuar në përkryerjen e shtetësisë, mision që nisi me çlirimin e Kosovës nga gjenocidi, dhe vijoi me ndihmën e dhënë në krijimin dhe mbështetjen e institucioneve të reja kosovare. Më tej ministri Pacolli shtoi se Kosova dhe populli i saj janë më të izoluarit e kontinentit Evropian, dhe shtoi se kjo gjendje s’duhet të vazhdojë. “Ne kemi përfunduar detyrimet tona sipas kontratës: ju lutem, kosovarët duhet të lëvizin të lirë, ne e meritojmë Evropën, sepse jemi evropianë!” shtoi ai.

Duke ju referuar dialogut me Serbinë dhe pretendimeve serbe, ministri Pacolli tha me vendosmëri se Plani Ahtisaari ishte maksimumi i lëshimeve që Kosova i ka bërë Serbisë në të gjithë planet. Pacolli i përkujtoi këtij forumi të rëndësishëm se statusi që ka Kosova sot ka legjitimitet të plotë ndërkombëtar, madje është pranuar edhe prej shteteve që e kundërshtojnë pavarësinë sot. Në vëmendje të pranishmëve ai solli një deklaratë të miratuar në Londër në 31 janar 2006, të ministrave të jashtëm të vendeve të Grupit të Kontaktit, BE-së, ku përveç 3 parimeve të njohura, i bëhej thirrje Beogradit të mbajë parasysh se statusi i Kosovës duhet të ketë pëlqimin e popullit të saj.

“Demarkacioni mes Dy shteteve që nënkupton njohje reciproke, është i domosdoshëm, pa rregullime territoriale. Kosova është gati për dialog pa kushte... në baza barazie, por ne po bllokohemi ekonomikisht dhe diplomatikisht nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina në rajon dhe kudo”, tha ai.

Duke Denoncuar në këtë forum të rëndësishëm evropian, fushatat diplomatike të Serbisë kundër Kosovës, ku po përdoren para të paligjshme, shefi i diplomacisë kosovare, tha se vendosja e taksës 100% ishte reagimi legjitim i frustrimit ndaj kësaj situatë të papranueshme. Gjatë qëndrimit në këtë forum, ministri i jashtëm Pacolli pati takime të shkurtra dhe të frytshme me homologët e tij të shteteve kryesore evropiane, me ata të rajonit, etj.



TAKIM ME TË DËRGUARIN TE POSAÇËM AMERIKAN PËR BALLKANIN PERËNDIMOR, MATTHEW PALMER

BLED, 3 shtator 2019

Takim me të Dërguarin e Posaçëm Amerikan për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer, në margjinat e Forumit të Bled-it, pata një takim me të Dërguarin te Posaçëm Amerikan për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer. Unë e përgëzova z.Palmer për emërimin e tij dhe si një mik i vjetër i Kosovës në këtë pozicion të ri, do të vazhdojë të na mbështesë në të gjitha nivelet. Ne e shohim dialogun si një proces të rëndësishëm që ka një mundësi për të mbyllur kapitullin e errët midis Kosovës dhe Serbisë. Normalizimi i marrëdhënieve me njohje të ndërsjellë është qëllimi i vetëm, asgjë me pak, dhe vlerësojmë pozicionin e fuqishëm të Uashingtonit për këtë synim. Kosova mund të llogarisë si gjithmonë në ShBA, por edhe ShBA duhet të llogarisë tek ne, si partnerë të përkushtuar dhe të besueshëm.



BLED, 3 shtator 2019 – Takim i miqësor me të Dërguarin te Posaçëm Amerikan për Ballkanin Perëndimor, Matthew Palmer.



Bled-Slloveni, 03 shtator 2019 – Takim mes delegacioneve në Bled të Sllovenisë




TAKIM ME HOMOLOGUN TURK, MEVLUT CAVUSOGLU

BLED - SLLOVENI, 03 SHTATOR 2019

Turqia do të vazhdojë të ndihmojë forcimin ndërkombëtar të Kosovës. Këtë e rikonfirmoj homologu turk, Mevlut Cavusoglu. Kryediplomati kosovar dhe kryediplomati turk, kanë pasur darkë pune, në Slloveni, në margjinat e Forumit të 14-të Strategjik të Bledit. Ministri i Jashtëm i Turqisë, Cavusoglu i ka uruar homologun e tij sukses gjatë kryesimit të Kosovës në Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP). Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) ka startuar në vitin 1996 në Sofje me synim të fuqizimit të bashkëpunimit dhe mirëbesimit rajonal.



Bled-Slloveni, 03 shtator 2019 – Kënaqësi të shtrëngojnë duart me homologun nga Turqia, Mevlut Cavusoglu



Bled – Slloveni, 3 shtator 2019 – Gjatë drekës së punës mes delegacioneve tona.



NË MARGJINAT E FORUMIT TË BLEDIT TAKIM ME MINISTRIN E PUNËVE TË JASHTME TË SLLOVENISË, MIRO CERAR

BLED - SLLOVENI, 03 SHTATOR 2019

Në marrgjinat e Forumit të 14-të Strategjik të Bled-it, takim me ministrin e Punëve të Jashtme të Sllovenisë, z.Miro Cerar, kryediplomati kosovar tha se takimi me homologun e tij slloven ishte jashtëzakonisht i shkëlqyeshëm ashtu sikurse janë edhe marrëdhëniet e mira e tradicionale të Kosovës dhe Sllovenisë. Ministri Pacolli i shprehu mirënjohje ministrit Cerar për mbështetjen e vazhdueshme që Sllovenia i ka dhënë Kosovës në Bashkimin Evropian, NATO dhe kudo që shteti slloven është i pranishme në organizatat ndërkombëtare.



Bled – Slloveni, 3 shtator 2019 – *Gjithmon kënaqësi kur takoj ministrin e Punëve të Jashtme të Sllovenisë, z.Miro Cerar*



Bled – Slloveni, 3 shtator 2019 – *Bised e këndshme dhe frytëdhënëse me ministrin e Punëve të Jashtme të Sllovenisë, z.Miro Cerar*



GJATË TAKIMEVE NË FORUMIN E BLEDIT

03 SHTATOR 2019

Fjalimin tim gjatë takimit në Bled e fillova me dy fjalët kyçe të këtij paneli,

- Evropianizimi dhe
- Demokratizimi

Potencova se Ilustrimin tonë të synimeve, ne ia kemi hedhur vetvetes, si anëtare të ardhshme të BE-së dhe NATO-s, por është përgjegjësia e përbashkët, nga ana tjetër, që tregon rrugën e vetme përpara në përmbushjen e objektivave. Thash se jem plotësisht dakord se përgjegjësia është kryesisht mbi shpatullat e rajonit. Por potencova se kur BE-ja nuk arrin të sigurojë një perspektivë të qartë për integrimin ose madje as të përmbushë premtime shumë specifike pasi të përmbushen të gjitha kërkesat, ngarkesa mbi supet tona bëhet më e rëndë. Thash se BE ka shumë për të ofruar.



Bled – Slloveni, 3 shtator 2019 – *Momenti kur kam marr fjalën para të pranishmëve në Forumin e Bledit*



Bled – Slloveni, 3 shtator 2019 – Diskutim me Mathew Palmer gjatë Forumit në Bled




Bled – Slloveni, 3 shtator 2019 – Momenti kur kam marr fjalën para të pranishmëve në Forumin e Bledit



GJATË PRANIMIT TË LETRAVE KREDENCIALE NGA AMBASADORI I RI BRITANIK, NICHOLAS ABBOTT

PRISHTINË, 06 SHTATOR 2019

Në takim kam pritur Ambasadorin e ri të Britanisë së Madhe në Republikën e Kosovës, Nicholas Abbott, nga i cili kam pranuar edhe kopjet e letrave kredenciale, nëpërmjet të cilave ai u akreditua si Ambasador Fuqiptotë i Britanisë së Madhe në vendin tonë. Në margjina të këtij takimi të dy bashkëbiseduesit shkëmbyen pikëpamjet mbi mbarëvajtjen e zhvillimeve politike në Kosovë, rajon dhe më gjerë. Ata vunë në dukje në veçanti marrëdhënien speciale dhe partneritetin strategjik në mes dy vendeve dhe dy popujve.



Prishtinë, 6 shtator 2019 – *Gjatë pranimimit për letrave kredenciale nga Ambasadori i ri Britanik, Nicholas Abbott*



PËRURIMI I AMBASADËS NË DOHA TË KATARIT

DOHA, 11 shtator 2019

Kosova ka përruar Ambasadën në Doha, Shtetin e Katarit. Kjo ambasadë do të promovojë interesat e Kosovës në një vend që ka një pozicion të rëndësishëm në ekonominë botërore. Kjo Ambasadë e re është pjesë e përpjekjeve të mia për të zgjeruar rrjetin diplomatik të Kosovës në botë dhe forcimin e marrëdhënieve me ekonomi të fuqishme. Në dy vitet e mia si Ministër i Punëve të Jashtme, Kosova ka hapur Ambasadën në Katar, Tajlandë, Emiratet e Bashkuara Arabe, Bangladesh, Norvegji dhe ne jemi në proces për të zgjeruar më tej rrjetin tonë diplomatik. Mbrojtja e sovranitetit të Kosovës dhe promovimi i investimeve janë prioritet strategjik i imi.





DOHA, 11 shtator 2019 - Përrurimi i Ambasadës në Doha të Katarit

TAKIM MIKPRITËS ME AMBASADORIN E NORVEGJISË, JENS ERIC GRONDAHL

PRISHTINË, 11 SHTATOR 2019

Në takim mikpritës me ambasadorin e Norvegjisë, Jens Eric Grondahl, duke i shprehur mirëseardhje në Kosovë, ia konfirmova vullnetin tonë për thellimin e mëtejme të marrëdhënieve bilaterale dhe raporteve miqësore ndërmjet shteteve tona. Norvegjia ishte ndër të parat që u reshtua përkrah shteteve që njohën pavarësinë e Kosovës dhe gjithmonë në mbështetje të fuqishme të vendit tonë në proceset euroatlantike dhe të anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare.



Prishtinë, 11 shtator 2019 – Duke i shprehur mirëseardhje në Kosovë ambasadorit të Norvegjisë, Jens Eric Grondahl



Prishtinë, 11 shtator 2019 – Takim me Ambasadorin Norvegjez në Kosovë.




TAKIM ME AMBASADOREN E SHTETIT FRANCEZ, MARIE CHRISTINE BUTEL

PRISHTINË, 11 SHTATOR 2019

Franca është një partner i rëndësishëm i shtetit të Kosovës, duke dhënë kontribut të vazhdueshëm në projekte të rëndësishme për vendin, si në fushën ekonomike, sociale dhe ngritjen e kapaciteteve tona njerëzore. Ky përkushtim do të vazhdoj edhe më tutje ka konfirmuar ambasadorja e re shtetit francez, Marie Christine Butel, të cilën e njoftova për të arriturat e Kosovës, proceset aktuale politike dhe shpreha gatishmërinë për thellimin e mëtejme të marrëdhënieve bilaterale ndërmjet dy vendeve tona. Kosova mirëpret angazhimin dhe rolin e Francës, Presidentit Macron dhe iniciativës së tij në procesin e dialogut me Serbinë, për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare.



Prishtinë, 11 shtator 2019 – Takim me Ambasadoren e re të shtetit francez në Kosovë, Marie Christine Butel



Prishtinë, 11 shtator 2019 – Takim me Ambasadoren Franceze në Kosovë.



PRANIMI I KOPJEVE TË LETRAVE KREDENCIALE TË AMBASADORES SË RE TË KROACISË ZNJ.DANIELA BARISIÇ

PRISHTINË, 18 SHTATOR 2019

Takimi i pare me Ambasadoren e re të Kroacisë në Republikën e Kosovës, Shkëlqesinë e Saj Daniela Barisiç, duke i shprehur mirëseardhje në Kosovë. Urova ambasadoren Barisiç për detyrën e re dhe shprehu interesimin që marrëdhëniet e sinqerta bilaterale të zhvilluara ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë të vazhdojnë edhe në të ardhmen, me dinamikë të përforcuar. Në takim, të dy bashkëbiseduesit shkëmbyen pikëpamjet mbi mbarëvajtjen e zhvillimeve politike në Kosovë, rajon dhe më gjerë.



Prishtinë, 18 shtator 2019 – Duke i dëshiruar mirëseardhje Ambasadores së re të Kroacisë në Kosovë



Prishtinë, 18 shtator 2019 – Gjatë takimit me Ambasadoren e re Kroate në Kosovë



KOSOVA E AUSTRIA ME TRADITË TË MARRËDHËNIEVE TË MIRA BILATERALE

PRISHTINË, 18 SHTATOR 2019

Prita në takim përfaqësuesin e ri të Republikës së Austrisë në Prishtinë, ambasadorin Christoph Weidinger. I urova mirëseardhje ambasadorit Weidinger, dhe i thash se Kosova është përherë mirënjohëse për kontributin e Austrisë dhënë ndër vite. Ambasadorin e njoftova se Kosova është shtet i potencialeve të mëdha dhe shtova se jemi të kënaqur që investitorë austriakë tanimë kanë investuar në Kosovë.



Prishtinë, 18 shtator 2019 – Gjatë takimit me Ambasadorin e ri Austriak në Kosovë



TAKIM ME PËRFAQËSUESEN E RE TË MISIONIT TË LUKSEMBURGUT

PRISHTINË, 18 SHTATOR 2019

Luksemburgu ka një qasje të posaqme ndaj Kosovës, trajtimi ndaj Kosovës është bërë në mënyrë të vecantë dhe do të vazhdojnë ta trajtojnë Kosovën si të tillë.





TAKIM ME KONSULLIN E RI NGA TURQIA SERDAR OZAYDIN

PRISHTINË, 18 SHTATOR 2019

I urova mirëseardhje konsullit Ozaydin si dhe suksese në punën e tij, ndërsa të dy u pajtuam që të vazhdojm bashkëpunimin e ngushtë mes dy vendeve. Vlerësova lartë marëdhëniet ndërshtetërore mes dy vendeve, duke shtuar se “vendi mik, Turqia ka luajtur një rol të rëndësishëm në të gjitha periudhat, në mbështetje të lirisë, të pavarësisë dhe tani në mbështetje të forcimit dhe konsolidimit të mëtejme të shtetit demokratik të Kosovës”.





RRUGËS PËR NEW YORK PËR TË MARRË PJESË NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË KOMBEVE TË BASHKUARA

NEW YORK, 21 SHTATOR 2019

Sapo të arrij në New York do të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të KB. Ditëve të ardhshme do të zhvilloj takime të rëndësishme me krerë shtetesh dhe ministra të punëve të jashtme për të fuqizuar marrëdhëniet e Kosovës me këto vende dhe për të forcuar pozitën ndërkombëtare të Kosovës. Në këtë kohë interesi i Kosovës është mbi të gjitha për ta bërë vendin tonë më të fortë dhe me të integruar.



New York, 21 shtator 2019 – Me aeroplanin tim privat duke udhëtuar drejt Ney Yorkut



TAKIM ME MINISTRIN E SHTETIT PËR PUNË TË JASHTME TË KATARIT, SOLTAN BIN SAAD AL-MURAIKHI

NEW YORK , 22 SHTATOR 2019

Forumi ekonomik Kosovë-Katar do të sjellë investime të mëdha në shtetin tonë. Pata një takim të shkëlqyeshëm me Ministrin e Shtetit për Punë të Jashtme të Katarit Soltan bin Saad Al-Muraikhi në ditën e parë të javës së UNGA në New York. Katari është një partner i besueshem i Kosovës dhe mbështet zhvillimin tonë ekonomik dhe politik. Se fundi kemi hapur Ambasadën e Kosovës në Katar. Ne do të punojmë ngushtë për të forcuar lidhjet tona dhe për të forcuar më tej marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare. Investimet në Kosovë dhe vende të reja të punës janë fokusi im.



New York, 22 shtator 2019 – Bashkëbisedim i nfgrohtë me Ministrin e Shtetit për Punë të Jashtme të Katarit Soltan bin Saad Al-Muraikhi



TAKIM ME MINISTREN E PUNËVE TË JASHTME TË GUAYANAS, KAREN CUMMINGS

NEW YORK, 22 SHTATOR 2019

Guayana është një aleat diplomatik i Kosovës. Ajo ka mbrojtur Kosovën në shumë organizata ndërkombëtare dhe vazhdon të japë të njëjtën mbështetje. Kosova ka Ambasador jo-rezident dhe pritet t'i zgjerojmë marrëdhëniet duke promovuar bashkëpunimin politik dhe tregtar.



New York, 22 shtator 2019 – Bashkëbisedim me ministren e Punëve të Jashtme të Guayanas



NË VAZHDËN E PUNIMEVE TË UNGA NË NEW YORK

NEW YORK, 23 SHTATOR 2019

Takim me Ministrin e Punëve të Jashtme të Shën Vincentit dhe Grenadinet, z.Louis Straker. Kosova mezi pret të vazhdojë angazhimin me Saint Vincent dhe Grenadines për të zgjeruar bashkëpunimin dypalësh.



New York, 22 shtator 2019 – *Takim me Ministrin e Punëve të Jashtme të Shën Vincentit dhe Grenadinet, z.Louis Straker.*



PJESMARRËS NË THIRRJEN GLOBALE PËR MBROJTJEN E LIRISË FETARE TË ORGANIZUAR NGA PRESIDENTI I SHBA-SË, DONALD TRUMP

NEW YORK, 23 SHTATOR 2019

Së bashku me presidentin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, pjesmarrës në Thirrjen Globale për Mbrojtjen e Lirisë Fetare të organizuar nga presidenti i SHBA-së, Donald Trump. Kosova e gatshme t'u bashkohet nismave të presidentit Trump për të përmirësuar këto të drejta thelbësore të njeriut.



New York, 23 shtator 2019 – Së bashku me presidentin e Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, pjesmarrës në Thirrjen Globale për Mbrojtjen e Lirisë Fetare



PRITJE E DIASPORËS SHQIPTARE NË SHBA DHE KOMUNITETIN QË JETON DHE PUNON NË NEW YORK

NEW YORK, 23 SHTATOR 2019

Së bashku me Ministrin në Detyrë për Punët e Jashtme i Shqipërisë, Gent Cakaj, pjesë e pritjes madhështore të diasporës shqiptare në SHBA dhe komunitetin që jeton dhe punon në New York. Shteti i Kosovës është mirënjohës për mbështetjen e fortë që ata i japin atdheut.



New York, 23 shtator 2019 – Momenti të paharruara me diasporën shqiptare në New York



TAKIM ME ANWAR GARGASH, MINISTËR I SHTETIT PËR PUNË TË JASHTME TË EMIRATEVE TË BASHKUARA ARABE

NEW YORK, 23 SHTATOR 2019

Me të diskutuam për marrëdhëniet e shkëlqyera midis Kosovës dhe Emirateve të Bashkuara Arabe, mbështetjen e vazhdueshme që po i japin qëndrimit ndërkombëtar të Kosovës.



New York, 23 shtator 2019 – Takim me Anwar Gargash, homologun tim nga Emiratet e Bashkuara Arabe



TAKIM ME MINISTRIN E PUNËVE TË JASHTME TË SLOVAKISË, I CILI NJËHERËSH ËSHTË EDHE KRYESUES I OSBE-SË, MIROSLAV LAJČÁK

NEW YORK, 23 SHTATOR 2019

Takim i shkëlqyeshëm i shkëmbimit të ideve me ministrin e Punëve të Jashtme të Sllovakisë, i cili njëherësh është edhe kryesues i OSBE-së, Miroslav Lajčák. Bideduam për marrëdhëniet bilaterale dhe mbështetjen e vazhdueshme që Sllovakia i ka dhënë Kosovës drejt BE-së, NATO-së dhe OSBE-së. Ne vazhdojmë angazhimin pragmatik me Sllovakinë për të promovuar perspektivën Euro-Atlantike të Kosovës dhe rajonit.



New York, 23 shtator 2019 – Takim me homologun tim Sllovak, Lajčák



TAKIM ME SEKRETARIN E SHTETIT TË SELISË SË SHENJTË, PIETRO PAROLIN

NEW YORK, 24 SHTATOR 2019

Mirënjohës dhe falënderues për kontributin që Selia e Shenjtë i jep popullit shqiptarë. Sekretarit të Shtetit të Selisë së Shenjtë, Pietro Parolin, i bëra me dije se Kosova është e përkushtuar që të vazhdoj avancimin e raporteve me Vatikanin. Tradicionalisht Kosova dhe Selia e Shenjtë kanë kultivuar marrëdhënie të shkëlqyera. Vizita e Sekretarit të Shtetit të Selisë së Shenjtë në Kosovë këtë vit ka hapur një kapitull të ri në marrëdhëniet tona të shkëlqyera. Selia e Shenjtë mbështet zhvillimet pozitive në vendin tonë.




New York, 24 shtator 2019 – Kënaqësi sa herë takoj dhe shtrëngoj duart me Sekretarin e Selisë së Shenjtë në Vatikan



TAKIM ME KRYEMINISTRIN E NEVISIT DHE MINISTRIN E JASHEM TË SAINT KITTS DHE NEVIS MARK BRANTLEY

NEW YORK, 24 SHTATOR 2019

Nje takim shumë i frytshëm me mikun tim Kryeministrin e Nevisit dhe Ministrin e Jashtëm të Saint Kitts dhe Nevis z.Mark Brantley. I lumtur të punoj me miqtë e Kosovës nga çdo cep i botës.



New York, 24 Shtator 2019 - Takim me mikun tim Kryeministrin e Nevisit dhe Ministrin e Jashtëm të Saint Kitts dhe Nevis Mark Brantley



SHKËMBIM IDESHË GJATË NJË ECJE ME HOMOLOGUN TIM POLAK

New York, 24 Shtator 2019 -

Shkëmbim ideshë gjatë një shtitje në rrugët e New Yorkut me ministrin e Punëve të Jashtme të Polonisë, Jacek Czaputowicz.



New York, 24 Shtator 2019 - Shkëmbim ideshë gjatë një shtitje në rrugët e New Yorkut



New York, 24 Shtator 2019 – Bised shumë produktive me homologun tim polak



TAKIM ME MINISTREN E PUNËVE TË JASHTME TË SUDANIT, ASMAA ABDALLA

NEW YORK, 24 SHTATOR 2019

Diskutim i shkëlqyeshëm me ministren e Punëve të Jashtme të Sudanit, Asmaa Abdalla mbi marrëdhëniet e Kosovës me shtetin e Sudanit. Republika e Kosovës do të angazhohet për të rritur bashkëpunimin me autoritetet e reja të Sudanit.



New York, 24 Shtator 2019 – Shtrëngim duarsh me ministren e Punëve të Jashtme të Sudanit, Asmaa Abdalla



TAKIM ME MINISTREN E JASHTME TË GANËS, SHIRLEY AYORKOR BOTCHWAY

NEW YORK, 24 SHTATOR 2019

Gana është një nga shtetet Afrikane që ka mardhënie të shkëlqyera diplomatike me Republikën e Kosovës. Shteti i Kosovës pritet të hap së shpejti Ambasadën në Ganë për të zgjeruar lidhjet tona.



New York, 24 Shtator 2019 – Diskutim i shkëlqyeshëm me homologen time nga Gana



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË ÇEKISË, TOMASH PETRIÇEK

NEW YORK, 24 SHTATOR 2019

Republika e Çekisë ka konfirmuar mbështetjen e fuqishme për Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran dhe integrimin e saj në BE, NATO dhe organizata ndërkombëtare. Kosova është e përkushtuar të zgjerojë partneritetin dhe miqësinë e fortë. Çekia është një nga aleatët e rëndësishëm.



New York, 24 Shtator 2019 – Diskutim me homologun nga Çekia, Tomash Petriçek



TAKIM ME KRYEMINISTRIN E SAINT VINCENT DHE GRENADINES, RALPH GONZALES

NEW YORK, 24 SHTATOR 2019

Takim i frytshëm me kryeministrin e Saint Vincent dhe Grenadines, Ralph Gonzales. Me të bisedova për bashkëpunimin midis dy vendeve tona. Ne mezi presim kontributin e tyre në anëtarësimin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ne ramë dakord të punojmë më shumë në marrëdhëniet tona bilaterale për t'u bërë më të fortë.



New York, 24 Shtator 2019 – Diskutim me kryeministrin e Saint Vincent dhe Grenadines



TAKIM ME ZËVENDËS PRESIDENTIN E INDONEZISË HON. YUSUF KALLA

NEW YORK, 24 SHTATOR 2019

Takim me Zëvendës Presidentin e Indonezisë Yusuf Kalla. Lidhjet tradicionale të Kosovës dhe Indonezisë vazhdojnë të thellohen. Shteti i Indonezisë së shpejti pritet të njohë Kosovën dhe të hapë një kapitull bashkëpunimi dhe miqësie.



New York, 24 Shtator 2019 – I nderuar që takova Zëvendës Presidentin e Indonezisë Yusuf Kalla



TAKIM ME MINISTREN E PUNËVE TË JASHTME DHE TREGTISË TË XHAMAIKA, HON.KAMINJA J SMITH

NEW YORK, 24 SHTATOR 2019

Diplomacia bëhet ndonjëherë në vende të qeta. I nderuar që takova dhe diskutova çështje me interes të ndërsjellë me Ministren e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë të Xhamaika, Hon. Kamina J Smith. Ne do të angazhohemi më tej për të zyrtarizuar marrëdhëniet mes dy shteteve.



New York, 24 Shtator 2019 – I nderuar që takova dhe diskutova çështje me interes të ndërsjellë me homologen time nga Xhamaika



TAKIM ME MINISTRIN E SHETIT PËR PUNËT E JASHTME TË ARABISË SAUDITE, ADEL AL-JUBEIR

NEW YORK, 24 SHTATOR 2019

Në kuadër të qëndrimit në New York kënaqësi të takoi Ministrin e Shtetit për Punët e Jashtme të Arabisë Saudite, Adel Al-Jubeir. Vlerësova lartë nivelin shumë të mirë të marrëdhënieve midis dy vendeve tona dhe shpreha vullnetin për avancimin e mëtejshëm të tyre, duke u ndalur kryesisht në aspektin ekonomik.



New York, 24 Shtator 2019 – *Kënaqësi të takoi Ministrin e Shtetit për Punët e Jashtme të Arabisë Saudite, Adel Al-Jubeir*



NË NEW YORK MBAHET KËSHILLI I BASHKËPUNIMIT RAJONAL

NEW YORK, 24 SHTATOR 2019

Së bashku me partnerët e Ballkanit Perendimor dhe BE-së, pjesë e takimit të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal. Momenti i duhur që përfaqësuesit e Ballkanit Perendimor treguan pikat e forta drejtë të ardhmes në BE. Shefi i diplomacisë kosovare tha se Kosova do të luaj rol aktiv në promovimin e bashkëpunimit dhe do të kontribuojë tutje për një mjedis të paqes, sigurisë dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.



New York, 24 Shtator 2019 – Së bashku me partnerët e Ballkanit Perendimor dhe BE-së, pjesë e takimit të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal



TAKIM ME MINISTRIN E PUNËVE TË JASHTME TË ANTIGUA DHE BARBUDA, CHET GREENE

NEW YORK, 24 SHTATOR 2019

Kosova dhe Antigua dhe Barbuda kanë vendosur gjatë këtij viti marrëdhënie diplomatike. Me këtë shtet do të shkëmbejmë shumë shpejt Ambasadorët. Ky do të jetë një hap i madh për Kosovën në forcimin e pozitës tonë diplomatike në rajonin e Karaibeve.



New York, 24 Shtator 2019 – Takim me homologun tim nga Antigua dhe Barbuda



TAKIM ME NËNSEKRETAREN E PËRGJITHSHME TË OKB-SË PËR ÇËSHTJE POLITIKE, AMBASADOREN, ROSEMARY DICARLO

NEW YORK, 24 SHTATOR 2019

Me nënsekretaren e Përgjithshme të OKB-së për Çështje Politike, Ambasadoren, Rosemary Dicarlo pata një takim pune, gjatë të cilit e informova për zhvillimet e fundit në Kosovë dhe i ofrova vizionin tonë për marrëdhënien e Kosovës me OKB-në. Ne kemi një histori të përbashkët, historinë e ndërtimit të shtetit të lidhur me Kombet e Bashkuara.



New York, 24 Shtator 2019 – Me nënsekretaren e Përgjithshme të OKB-së për Çështje Politike, Ambasadoren, Rosemary Dicarlo



TAKIM ME KRYEMINISTRIN E TAJLANDËS, PRAYUT CHAN-O-CHA

NEW YORK, 25 SHTATOR 2019

Edhe njëher dëshmuam se këto dy shtete kanë marrëdhënie të shkëlqyera. Miqësia jonë është e fortë dhe këtë vit hapëm Ambasadën tonë në Tajlandë për të forcuar më tej këto marrëdhënie.



New York, 25 Shtator 2019 – Takim me kryeministrin e Tajlandës



TAKIM ME MINISTRIN KROAT I PUNËVE TË JASHTME DHE I ÇËSHTJEVE EVROPIANE GORDAN GRLIĆ RADMAN

NEW YORK, 25 SHTATOR 2019

Miqësia jonë është tradicionalisht e fortë me Kroacinë. Kosova është në të njëjtën linjë për çështje që kanë të bëjnë me të ardhmen Euro-Atlantike të Ballkanit dhe stabilitetin afatgjatë në rajonin tonë.



New York, 25 Shtator 2019 –Takim me homologun kroat, Gordan Grlić Radman



GJATË KRYESIMIT TË KONFERENCËS SË PROCESIT TË BASHKËPUNIMIT TË EVROPËS JUGLINDORE (SEECF)

NEW YORK, 25 SHTATOR 2019

Për herë të parë në histori, Kosova ka marrë Kryesinë e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECF). Ky është një hap i madh për Kosovën për të treguar leadership rajonal. Moment krenarie për Kosovën për të udhëhequr për një vit organizatën më të madhe dhe më të rëndësishme politike në rajonin tonë që bashkon Shqipërinë, BiH, Kroacinë, Slloveninë, Malin e Zi, Serbinë, Rumaninë, Greqinë, Turqinë, Maqedoninë e Veriut, Moldavinë.



New York, 25 Shtator 2019 – Për herë të parë në histori, Kosova ka marrë Kryesinë e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECF)



New York, 25 Shtator 2019 – Gjatë fjalës sime si kryesues i Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP)



TAKIM ME TË DËRGUARIN E POSAÇËM TË SEKRETARIT AMERIKAN TË SHETIT PËR BALLKANIN, MATT PALMER

NEW YORK, 25 SHTATOR 2019

Gjithmonë një kënaqësi të takoj të dërguarin e Posaçëm të Sekretarit Amerikan të Shtetit për Ballkanin H.E.Matthew Palmer dhe shkëmbimin me të për marrëdhëniet e shkëlqyera midis Kosovës dhe SHBA dhe angazhimit të vazhdueshëm të SHBA-vë për Kosovën. Jam i përkushtuar që të angazhohem me ShBA në çështjet strategjike të Kosovës, përfshirë normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë.



New York, 25 Shtator 2019 – Gjithmonë një kënaqësi të takoj z.Palmer



New York, 25 Shtator 2019 – Së bashku me kryeministrin Haradinaj në takim me z.Palmer



TAKIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË FINLANDËS, PEKKA HAAVISTO

PRISHTINË, 30 SHTATOR 2019

Kan pritur në një takim ministrin e Punëve të Jashtme të Finlandës, z.Pekka Haavisto, të cilin e falënderova për mbështetjen e vazhdueshme të Finlandës në proceset e shtet-ndërtimit dhe të integritimit euro-atlantike të Republikës së Kosovës. Vura në dukje marrëdhënien bilaterale dhe partneritetin strategjik në mes dy vendeve dhe dy popujve. Edhe ministri i Jashtëm Finlandez, Haavisto, vuri në dukje marrëdhëniet shumëdekadeshe të mirëkuptimit dhe miqësisë ndërmjet të dyja shteteve dhe raportet e afërta ndërmjet dy popujve, si kapital për investim edhe më të madh në të ardhmen.



Prishtinë, 30 Shtator 2019 – Në takim me homologun finlandez, Haavisto



Prishtinë, 30 Shtator 2019 – Në takim me ekipen e homologut finlandez, Haavisto



Prishtinë, 30 Shtator 2019 – Gjatë konferencës për media së bashku me homologun finlandez



TAKIM ME KONSULLIN E NDERIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË AUSTRALI, AVOKATIN, RAUF SULIO

PRISHTINË, 21 TETOR 2019

Pata nderin të takohem me Konsullin e nderit të Republikës së Kosovës në Australi, avokatin, Rauf Sulio. Zotri Sulio (përndryshe me origjinë nga Korça), është meritator për kultivimin e kontakteve të ngushta të Kosovës me Australinë dhe shtetet e Oqeanisë, që nga krijimi i kushteve për hapjen e Ambasadës tonë në Kambera e këndej. Diskutuam për shumë tema si dhe për situatën gjeopolitike në rajon.



Prishtinë, 21 tetor 2019 – Kënaësi sa herë takoj Konsullin e nderit të Republikës së Kosovës në Australi



TAKIM ME DIPLOMATEN GREKE NË PRISHTINË

PRISHTINË, 25 TETOR 2019

Prita në takim shefen e Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë në Prishtinë, znj. Chryssoula Aliferi, me të cilën diskutova për zhvillimet aktuale në Kosovë dhe rajon, marrëdhëniet midis dy vendeve dhe mundësitë e rritjes së tyre në kapacitete të plota. Gjatë takimit u konfirmua angazhimi dhe mbështetja e dy vendeve për ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme bilaterale në aspektin politik dhe ekonomik.



Prishtinë, 25 tetor 2019 – Në takim me shefen e Zyrës Ndërlidhëse të Greqisë në Prishtinë



SESIONI I 38-TË I MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË FRANKOFONISË

MONAKO, 29 TETOR 2019

Kënaqësi të jesh pjesëmarrës në Konferencën e 38-të të ministrave të vendeve anëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë. Në ndërkohë, në margjinat e kësaj konference janë paraparë të zhvillohen edhe shumë takime bilaterale mes ministrave të jashtëm të hapësirës frankofone. Kosova u anëtarësua për herë të parë në Frankofoni si anëtare vëzhguese në vitin 2014, ndërsa në tetor të vitit të kaluar iu ngrit statusi në anëtar të asociuar. Që nga anëtarësimi i Kosovës si anëtar vëzhgues në vitin 2014 në Samitin e Frankofonisë në Dakar, Kosova ka bërë përpjekje të shumta për promovimin e gjuhës frënge dhe Frankofonisë.



Monako, 28 tetor 2019 – Pjesmarrës në Konferencën e 38-të të ministrave të vendeve anëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë



Monako, 28 tetor 2019 – Flamuri i Kosovës në mesin e qindra flamujve të shteteve pjesmarrëse në Konferencën e 38-të të ministrave të vendeve anëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë



NË KONFERENCËN E 36-TË TË MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME TË FRANKOFONISË

MONAKO, 30 TETOR 2019

Në Konferencën e 36-të të Ministrave të Punëve të Jashtme të Frankofonisë në Monaco kam pasur sot shumë takime bilaterale. Qëllimi është të vazhdojmë angazhimin tonë për të kundërshtuar agresionin diplomatik dhe propagandistik serb dhe t'i shpjegojmë botës mënyrën e ndyrë që Serbia po përdor kundër Kosovës.





TAKIM ME CHANCEL SEKODE NDEUGBAY, MINISTRIN E REPUBLIKËS SË AFRIKËS QENDRORE DELEGAT PËR FRANKOFONINË

MONAKO, 30 TETOR 2019

Takim i shkëlqyeshëm me Chancel Sekode Ndeugbay, Ministrin e Republikës së Afrikës Qendrore Delegat për Frankofoninë. Ne rikonfirmuam marrëdhëniet e forta ndërmjet Kosovës dhe Republikës së Afrikës Qendrore dhe angazhimi tonë për të çuar më tej miqësinë dhe partneritetin tonë në fushat me interes të ndërsjellë.



Monako, 30 tetor 2019 – Takim i shkëlqyeshëm me Chancel Sekode Ndeugbay, homologu im nga Afrika Qendrore



DISKUTIM ME MINISTRIN E JASHTËM TË CHADIT Z.MAHAMAT ZENE CHERIF

MONAKO, 30 TETOR 2019

Diskutim i shkëlqyeshëm në Monako me Ministrin e Jashtëm të Chadit z.Mahamat Zene Cherif. Dy vendet tona kanë një miqësi dhe partneritet të fortë që daton prej shumë vitesh. Chadi ka mbështetur vazhdimisht Kosovën dhe ne do të punojmë së bashku për të thelluar më tej miqësinë tonë.





SHKËMBIM I MIRË ME MINISTRIN E JASHTËM TË MONAKOS Z.LAURENT ANSELMI

MONAKO, 30 TETOR 2019

Shkëmbim i mirë me Ministrin e Jashtëm të Monakos z.Laurent Anselmi për lidhjen e shkëlqyeshme ndërmjet Kosovës dhe Monakos dhe mbështetjes së tyre të vazhdueshme për anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare. Ne do të punojmë së bashku për të eksploruar lidhjet ekonomike dhe tregtare.



Monako, 30 tetor 2019 – Diskutim i frytshëm me Ministrin e Jashtëm të Monakos z.Laurent Anselmi



PREZANTIM PARA TË PRANISHMËVE TË KONFERENCËS SË MINISTRAVE TË PUNËVE TË JASHTME TË FRANKOFONISË

MONAKO, 31 TETOR 2019

Iu drejtova Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme të Frankofonisë ku prezantova arritjet e Kosovës dhe angazhimin tonë për misionin e Frankofonisë. Theksova nevojën që bashkësia ndërkombëtare të vazhdojë të mbështesë Kosovën në nivelin global si kontributi më i rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin në rajon dhe si njohje të rolit konstruktiv që luan Kosova. Ne do të vazhdojmë të angazhohemi me të gjitha vendet në mënyrë miqësore dhe bashkëpunuese dhe i bëj thirrje të gjithëve ta njohin Kosovën si një shtet të pavarur dhe të na mbështesin në përpjekjen tonë për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.



Monako, 31 tetor 2019 – Gjatë fjalës time në Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme të Frankofonisë



NË KONFERENCËN - ROLI I SHQIPËRISË NË PROMOVIMIN E INTERESAVE KOMBËTARE TË SHQIPTARËVE NË HAPËSIRËN E BALLKANIT PERËNDIMOR

TIRANË, 25 NËNTOR 2019

Në Tiranë mora pjesë me ftesën e Ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj, në konferencën - Roli i Shqipërisë në promovimin e interesave kombëtare të shqiptarëve në hapësirën e Ballkanit Perëndimor. Unë argumentova qartë për një integrim shumë më të fortë në sferën shqiptare. Ne duhet të punojmë ngushtë për të unifikuar ekonominë tona dhe për të thelluar integrimin në të gjitha sferat që do të forcojnë pozicionin tonë si dy shtete në rajon dhe më gjerë.



Tiranë, 25 nëntor 2019 – *Gjatë fjalës time drejtuar të pranishmëve në konferencën - Roli i Shqipërisë në promovimin e interesave kombëtare të shqiptarëve në hapësirën e Ballkanit Perëndimor*



VIZITË NË ZONAT E PREKURA TË TËRMETIT NË SHQIPËRI

THUMANE - DURRËS, 27 NËNTOR 2019

Mbërrita sot në zonat e prekura të tërmetit në Shqipëri që la shumë të vdekur dhe të plagosur ndërsa shkatëroj shumë shtëpi dhe banesa. Në Thumane vizitova komunitetet e prekura. Unë shpreha mbështetjen institucionale dhe private (ne koordinim me autoritetet perkatese aty) për qytetarët e Thumanes dhe të Shqipërisë. Kjo është situata më tragjike në 20 vjet për të gjithë kombin shqiptar dhe unë do të qëndroj në mbështetje me ata. Vlerësova ndihmën e ushtarëve të Kosovës dhe të zjarrefikësve që po japin gjithqka nga profesionalizmi i tyre. Jam shumë krenar për ndihmën dhe solidaritetin nga Kosova në Shqipëri në orët e fundit. Solidariteti dhe mbështetja masive tregon lidhjet e vëllazërore. Ne duhet të vazhdojmë dhe të sigurohemi që të gjitha familjet e prekura do të kenë së shpejti një çati për t'u rikthyer jetës normale. Ky është një mision kombëtar tani.



Thumane - Durrës, 27 nëntor 2019 – Momente të vështira në Thumane së bashku me FSK-në



VIZITË NË ZONAT E PREKURA TË TËRMETIT NË SHQIPËRI

THUMANE - DURRËS, 27 NËNTOR 2019

Në Durrës vizitova zonën e prekur nga tërmeti shkatërrues. Takova gjithashtu kryeministrin Edi Rama dhe i shpreha atij në emër të popullit të Kosovës ngushëllimet për vdekjen e civilëve. Unë e sigurova atë për mbështetjen institucionale dhe atë të qytetarëve të Kosovës. Do të punojmë ngushtë në kapacitete institucionale për të ndihmuar komunitetin.



Thumane - Durrës, 27 nëntor 2019 – Prononcim për media së bashku me kryeministrin shqiptar, Edi Rama



VIZITË NË ZONAT E PREKURA TË TËRMETIT NË SHQIPËRI, TAKIM ME PJESTARËT E FSK-SË

THUMANE - DURRËS, 27 NËNTOR 2019

Ishte një nder i madh kur shihja ushtarët e Forcave të Sigurisë së Kosovës që ofronin ndihmë shpëtimi në zonat e prekura nga tërmeti shkatërrues në Shqipëri. FSK-ja është një ushtri profesionale dhe e përkushtuar për të ofruar mbrojtje dhe ndihme për njerëzit në Kosovë dhe jashtë saj. FSK-ja si forcë është e gatshme të jetë anëtare e NATO-s dhe ka arritur standardet më të larta të NATO-s që e bëjnë atë të gatshëm për misione ndërkombëtare. Djema ju e keni bërë krenar tërë kombin.



Thumane - Durrës, 27 Nëntor 2019 – Shtrengim duarsh me pjestarët e FSK-së që ofronin ndihmë shpëtimi në zonat e prekura nga tërmeti



NDERIM ME TITULLIN “AMBASADOR TË VULLNETIT TË MIRË TË KOSOVËS”, PËR MAJLINDA KELMENDIN DHE DRITON KUKA

PRISHTINË, 28 NËNTOR 2019

Kosova përgjatë këtyre njëmbëdhjetë viteve shtet u identifikua në botë me shumë figura të sportit, kulturës e shkencës, si ambasadorët më të mirë të saj. Por, puna e Trajnerit të Xhudos, z.Driton Kuka, dhe kampiones Olimpike të Xhudos, znj.Majlinda Kelmendi, që kanë bërë për imazhin e Kosovës është e paarritshme nga të tjerët. Për këtë kontribut sot në këtë ditë të veçantë për kombin tonë nderova të dy me titullin “Ambasador të Vullnetit të Mirë të Kosovës”. Titulli që iu dha Kukës dhe Kelmendit, duhet të inkurajojë të gjithë sportistët kosovarë, të cilët duhet ta konsiderojnë rrugën e tyre si një mundësi të promovimit të vlerave të sportit, kulturës, dhe trashëgimisë tonë.




Prishtinë, 28 nëntor 2019 – Momenti kur nderova me titullin “Ambasador të Vullnetit të Mirë të Kosovës”, Majlinda Kelmendin dhe Driton Kuka



1 MILION EURO NGA FONDACIONI “BEHGJET PACOLLI” PËR TË PREKURIT NGA TERMETI NË SHQIPËRI

PRISHTINË, 28 NËNTOR 2019

Unë u trondita kur pashë dëmet në jetën e njeriut dhe në infrastrukturë që tërmeti shkatërrues po lë pas në Shqipëri. Kjo kërkon solidaritet dhe mbështetje për të siguruar që qytetarët e prekur mund të kthehen shpejt në jetën normale. Kemi vendosur së bashku me familjen time (ne djemtë e Isa dhe Ruhan Pacollit) që të dhurojmë #1milion Euro për rindërtimin e zonave të prekura nga tërmeti. Ky donacion do të shkojë në funksion të rindërtimit dhe bashkë me Qeverinë e Shqipërisë do të menaxhohet në mënyrë transparente dhe të sigurt. Kjo është më e pakta që unë dhe familja ime mund të bëjmë për Shqipërinë tonë të dashur. Mbështetja ime për vëllazerit tonë do të jetë e vazhdueshme dhe shpresoj së shpejti ata të kthehen në normalitet. Unë pres po ashtu që në menyrë të organizuar të pranoj edhe qindra familje këtu në Prishtinë.



Thumane - Durrës, 28 Nëntor 2019 – Pamje të ndërtesave shumëkatëshe të goditura nga Tërmeti



PËRURIMI I KONSULLATËS SË PËRGJITHSHME TË KOSOVËS NË DUSSELDORF

DUSSELDORF, 29 NËNTOR 2019

I lumtur që në Dusseldorf kemi përuruar Konsullatën e Përgjithshme të Kosovës me qëllim forcimin e marrëdhënieve të Kosovës me Gjermaninë, ofrimin e shërbimeve më të mira dhe efektive konsullore për diasporën tonë që jeton në zonën përreth Dusseldorfit në NRW dhe të promovojë marrëdhënie ekonomike dhe tregtare me ekonominë më të madhe në Evropë. Jam i lumtur që gjatë mandatit tim rrjeti diplomatik dhe konsullor i Kosovës është zgjeruar dhe ne jemi më afër diasporës sonë.



Dusseldorf, 29 nëntor 2019 – Gjatë fjalës sime para të pranishmëve me rastin e përurimit të Konsullatë së Përgjithshme të Kosovës



NË TAKIM ME AMBASADORET E VENDEVE TË QUINTIT DHE TË BASHKIMIT EVROPIAN

PRISHTINË, 2 DHJETOR 2019

Kam pritur në takim Ambasadorët e vendeve të Quintit dhe të Bashkimit Evropian në Kosovë. Në këtë takim kam diskutuar për prioritetet e politikës së jashtme të Kosovës dhe veçmas përkushtimin tonë për koordinim të ngushtë me të gjitha shtetet partnere në agjendën ndërkombëtare. Kam siguruar ambasadorët se në mesin e prioriteteve kryesore është vendosmëria për të përdorur politikën e jashtme të Kosovës jo vetëm për të zgjeruar dhe ushtruar sovranitetin por edhe për qëllime të politikës së brendshme sikurse janë rritja e investimeve të huaja direkte në Kosovë. Unë shpreha protestën dhe shqetësimin tonë për fushatën e ndyrë diplomatike dhe propagandistike të Serbisë. E bëra shumë të qartë se njohja e Kosovës dhe anëtarësimi i saj në organizata ndërkombëtare është faktori më i rëndësishëm për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Kjo është një vijë e kuqe për Kosovën dhe për Serbinë më mirë që më shpejt sesa më vonë të pranojnë realitetin për të mirë të së ardhmes së saj dhe të të gjithë rajonit.



Prishtinë, 2 dhjetor 2019 – Në takim me Ambasadorët e vendeve të Quintit



NË CEREMONINË E DEKRETIMIT TË TRUPAVE TË FSK-SË NGA PRESIDENTI SHQIPTAR, ILIR META

PRISHTINË, 4 DHJETOR 2019

Presidenti i Republikës së Shqipërisë Zoti Ilir Meta dekoroi trupat e Republikës së Kosovës, të cilët morën pjesë në operacionet e kërkimit dhe shpëtimit në Shqipëri. Ceremonia e dekorimit u zhvillua në Kazermën Adem Jashari në Prishtinë. U dekoruan trupat e FSK-së, trupat speciale të policisë së Kosovës, minatorët e Trepçes dhe minierës Artana në Marec, njësitë zjarrfikëse të Kosovës, njësia e zjarrfikësve të Therandës dhe Qenin njësitit K9 të FSK. Ndhëm krenar më atë që Kosova po bën për Shqipërinë.



Prishtinë, 4 dhjetor 2019 – Krenar me djemt dhe vajzat e FSK-së për profesionalizmin që treguan gjatë termetit që goditi Shqipërinë.



Prishtinë, 4 dhjetor 2019 – Krenar me djemt dhe vajzat e FSK-së për profesionalizmin që treguan gjatë termetit që goditi Shqipërinë.